



**HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)**

E VËRTETA E JETËS SË KËSAJ BOTE

*Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër
vetëm se një përjetim e mashtrim.*

*S'ka dyshim se bota tjetër është
më e dobishmja për ata që ruhen.*

A nuk logjikoni?

(En'am: 32)



Ne besojmë se E vërteta e jetës së kësaj bote na ofron një shpjegim sa i përket natyrës reale të jetës së njeriut. Është një jetë e shkurtë dhe mashtruese në të cilën dëshirat e kësaj bote duken magjepsëse dhe premtuese, por e vërteta qëndron ndryshe. Ky libër do t'ju mundësojë që të perceptoni jetën e juaj dhe të gjitha realitetet e saj, dhe t'ju ndihmojë që t'i rishqyrtoni qëllimet tuaja jetësore, nëse doni.

Allahu i urdhëron besimtarët që të këshillojnë të tjerët për këto fakte, dhe i thërret ata që të jetojnë vetëm që të plotësojnë dëshirën e Tij, ashtu siç thotë Ai në këtë ajet:

Premtimi i All-llahut është e sigurt, pra të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote... (Lukman: 33)



RRETH AUTORIT

Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



E VËRTETA E JETËS SË KËSAJ BOTE

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)




PËR AUTORIN

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimeve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrenjëjt e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.



Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeya kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

PËR LEXUESIN

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfituar nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjeluar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.

www.harunyahya.com/albanian


www.en.harunyahya.TV

E VËRTETA E JETËS SË KËSAJ BOTE

Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër vetëm se një përjetim e mashtrim. S'ka dyshim se bota tjetër është më e dobishmja për ata që ruhen. A nuk logjikoni?

(En'am: 32)

**HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)**



PËRMBAJTJA

HYRJE...9

JETA E KËSAJ BOTE...14

DOBËSIA E NJERIUT...34

DHËNIA PAS TË MIRAVE TË KËSAJ BOTE...64

FATKEQËSITË DHE RREZIQET NATYRORE...81

CIVILIZIMET E VJETRA...103

*VENDBANIMI I VËRTETË I NJERIUT:
AHIRET...117*

ESENCA E VËRTETË E MATERIES...141

*RELATIVITETI I KOHËS DHE
REALITIVITETI I FATIT...177*

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT...190

SHËNIMET...214

HYRJE



jo grua është në të shtatëdhjetat. A keni menduar ndonjëherë se si dikush në moshën e saj do ta vlerësonte jetën e vet? Nëse do të përkujtonte diçka nga jetën e saj, sigurisht se do të ishte "një jetë sa qel e mbyll sytë".

Ajo sigurisht do të vërejë se jeta e saj nuk ka qenë edhe aq "e gjatë" siç ka ëndërruar deri sa ka qenë e re. Bile ndoshta kurrë nuk ia ka marrë mendja se një ditë ajo do të plakët aq shumë. Por tani, ajo është e habitur nga fakti se i ka 70 vjet prapa. Më përpara, ajo ndoshta as që ka menduar se rinia dhe dëshirat e saja do të kalojnë aq shpejt.

Nëse do të pyetesh që të tregojë për jetën e saj, rikujtimet e saj do të zgjasnin vetëm 5-6 orë tregim. Kjo është e tëra që ka mbetur nga siç thotë ajo ishte "jetë e gjatë 70 vjeçe".

Mendja e njeriut, të rraskapitur nga mosha, është e kapluar me shumë pyetje. Këto në të vërtetë janë pyetje të rëndësishme e për t'i shqyrtuar dhe për t'iu dhënë përgjigjen e vërtetë është qenësore të kuptohen të gjitha aspektet e jetës: "cili është qëllimi i kësaj jete që kalon aq shpejt? Pse duhet të mbetem pozitiv me të gjitha problemet e lidhura me moshën? Çfarë do të sjell e ardhmja?"

Përgjigjejet e mundshme të këtyre pyetjeve ndahen në dy kategorive të mëdha: në ato nga njerëzit që e besojnë Allahun dhe në ato nga jobesimtarët që nuk besojnë në Atë.

Dikush që nuk e beson Allahun do të mund të thoshte, “ E kam kaluar jetën time duke u marrë me kërkime të kota. I kam lënë 70 vjet prapa, por me ta thënë të drejtën, ende nuk e kam të qartë se për çfarë kam jetuar. Kur isha fëmijë, prindërit e mi kanë qenë qendra e jetës sime. Tërë lumturinë dhe kënaqësinë e kam gjetur në dashurinë e tyre. Më vonë, si e re, iu kam përkushtuar burrit dhe fëmijëve të mi. Gjatë asaj kohe, i kam vendosur para vetes shumë caqe për veten. Pas një kohe të caktuar ato caqe dhe qëllime i kisha arritur, dhe secila prej tyre ka qenë e përkohshme. Kur përjetoja suksesin, vazhdoja me arritjen e caqeve tjera dhe aq shumë më preokuponin sa që nuk kam menduar për kuptimin e vërtetë të jetës. Tani në të shtatëdhjetat, në qetësinë e pleqërisë, mundohem të gjej se çka ka qenë qëllimi i ditëve të mia të kaluara. A thua kam jetuar për njerëzit që i kam vetëm si mjegull në mendjen time? Për prindërit e mi? Për burrin tim që ka vdekur qëmoti? Apo për fëmijët të cilët i shoh shumë rrallë që tani i kanë familjet e veta? Jam e hutuar. E vetmja e vërtetë që tani e ndiej është afrimi i vdekjes. Së shpejti do të vdes dhe do mbetem një kujtim i zbehtë në kujtimet e njerëzve. Çfarë do të ndodhë pasandaj? Me të vërtetë nuk kam ide. Vetëm mendimi për të është i frikshëm!”

Me siguri ekziston arsyeja pse ajo ka rënë në gjendje aq të pashpresë. Kjo thjeshtë është për shkak se ajo nuk mund ta kuptojë se gjithësia, të gjitha qeniet e gjalla dhe qeniet njerëzore kanë qëllime të paracaktuara për t'i plotësuar në jetë. Këto qëllime ekzistojnë për faktin se çdo gjë është e krijuar. Personi inteligjent vëren se plani, dizajni dhe mençuria ekziston në çdo detaj të botës pafundësisht të larmishme. Kjo e tërheqë atë në njohjen e Krijuesit. Ai më tutje konkludon se, meqë të gjitha qeniet e gjalla nuk janë pasoja të ndonjë procesi të rastësishëm dhe të paparamenduar, të gjitha shërbejnë për qëllime të rëndësishme. Në Kur'an, në udhëzuesin e fundit të shpallur për të udhëzuar në rrugë e drejtë për humanizmin që ka mbijetuar si autentik, Allahu pandërprerë na përkujton qëllimin e jetës sonë, që ne tentojmë ta harrojmë, dhe e prandaj na thërret që të kemi mendjen dhe vetëdijen e pastër.

Ai është i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë dite (fazave), e Arshi

(Froni) i Tij kishte qenë (më parë) mbi ujë, që t'ju sprovovë, se cili prej jush është më vepërmirë... (Hud: 7)

Ky ajet na jep kuptimin e plotë për qëllimin e jetës së besimtarëve. Ata e dinë se jeta është vendi ku ata provohen dhe sprovohen nga Krijuesi i tyre. Prandaj, ata shpresojnë se do të jenë të suksesshëm në këtë testim dhe se do të fitojnë vendin në parajsë dhe njëkohësisht edhe kënaqësinë e Allahut.

Sidoqoftë, për hir të qartësisë, duhet pasur parasysh një pikë të rëndësishme: ata që besojnë në “ekzistencën” e Allahut medoemos nuk kanë besim të vërtetë; ata nuk e vendosin besimin e tyre në Allah. Sot, shumë njerëz pranojnë se gjithësia është krijuar nga Allahu; por, ata pak e kuptojnë efektin e këtij fakti në jetën e tyre. Prandaj, ata nuk e bëjnë jetën ashtu siç do të duhej. Ajo që këta njerëz në përgjithësi e vlerësojnë si të vërtetë është se Allahu fillimisht krijoi gjithësinë por, siç besojnë ata, Ai e la gjithësinë të ekzistojë në mënyrë të pavarur.

Allahu, në Kur'an, tregon për këtë keqkuptim në ajetet vijuese:

Nëse ti i pyet ata: Kush i krijoi qiejt e tokën? Me siguri do të thonë: “All-llahu!” Thuaj: “All-llahut i qoftë lavdërimi!” Por shumica e tyre nuk dinë. (Lukman: 25)

Po nëse ti i pyet: Kush i krijoi ata, me siguri do të thonë: “All-llahu!” E si pra, i kthejnë shpinën? (Az-Zuhur:87)

Për shkak të këtij keqkuptimi, njerëzit nuk mund ta lidhin jetën e tyre me faktin se ata kanë Krijuesin. Kjo është arsyeja themelore pse çdo individ i zhvillon principet e tij/saj dhe vlerat morale të formuara brenda kulturës, bashkësisë dhe familjes së veçantë. Këto principe në të vërtetë shërbejnë si “udhërrëfyes jete” deri në vdekje. Njerëzit që mbështeten në vlerat e veta gjithmonë gjejnë ngushëllim në dëshirat e paramenduara se për çdo vepër të gabuar do të marrin dënim të përkohshëm në ferr. Përsiatjet e njëjta sugjerojnë se jeta e amshueshme në parajsë do të pasojë pas periodës së dënimit. Ky mentalitet padashur të largon nga frika e dënimit të rëndë në fund të jetës. Disa tjerë, nga ana tjetër, bile as që iu bien ndërmend kjo gjë. Ata thjeshtë janë të shkujdesur për botën e ardhshme dhe “mundohen ta shfrytëzojnë jetën e tyre sa më mirë”.

Mirëpo, thënia lartë është e pavërtetë dhe e vërteta është në kundërshtim me atë se çfarë ata mendojnë. Ata që shtihen se gjoja nuk janë të vetëdijshëm

për ekzistencën e Allahut do të bien në dëshpërim të thellë. Në Kur'an, këta njerëz janë përshkruar me karakteristika si vijon:

Edhe atë që dinë nga jeta e kësaj bote, është dije e cekët, por ndaj jetës së përjetshme (ndaj Ahiretit) ata janë plotësisht të verbëruar (të pa interesuar).

(Rum: 7)

Sigurisht, këta njerëz pak nga kuptojnë qëllimin dhe fytyrën e vërtetë të kësaj bote, dhe asnjëherë nuk mendojnë se jeta në këtë botë nuk është e përhershme.

Janë disa fraza që zakonisht përdorin njerëzit sa i përket kohës së shkurtë të jetës: “Shfrytëzoje jetën derisa të zgjatë”, “jeta është e shkurtë”, “kurrkush nuk ka jetuar përgjithmonë” janë fraza që çdoherë referohen në definimin e natyrës së kësaj bote. Sidoqoftë, këto fraza përmbajnë kuptimin se njerëzit janë të lidhur ndaj të kësaj jete më shumë sesa ndaj asaj të ardhshme. Kjo reflekton qëndrimin e përgjithshëm të njerëzve për jetën dhe vdekjen. Të kesh aq dhembshuri për jetën, derisa bisedat për vdekjen gjithmonë ndërpriten me mahi apo duke ndërruar temën e bisedës duke u munduar që të lehtësohet serioziteti i temës. Këto ndërhyrje e kanë gjithmonë një qëllim dhe përpjekje ashtu që të zvogëlohet tema aq e rëndësishme në një temë të parëndësishme.

Vdekja sigurisht që është temë e rëndë për t'u menduar. Mund të ndodhë që një person deri në këtë moment të jetës së tij të jetë pavetëdijshëm për domethënien e këtij realiteti. Por, tani që ka rastin ta kuptojë rëndësinë e saj, duhet që të rishikoj jetën dhe pritjet e tij. Kurrë nuk është vonë që të pendohesh tek Allahu, si dhe të orientoj veprat dhe mënyrën e jetës në nënshtrim ndaj vullnetit të Allahut. Jeta është e shkurtë; ndërsa shpirti i njeriut është i përhershëm. Gjatë kësaj periudhe të shkurtë, njeriu nuk duhet të lejoj që të jetë nën kontrollin e kënaqësive të përkohshme. Njeriu duhet që t'i rezistoj joshjes dhe të largohet nga të gjithat që e forcojnë lidhjen (dashurinë) për këtë botë. Natyrisht që është e pamend shpërfillja e botës së ardhshme vetëm për hir të kënaqësive të përkohshme të kësaj jete.

Megjithatë, jobesimtarët që nuk mund të kuptojnë këtë fakt kalojnë jetën e tyre së koti duke harruar Allahun. Gjithashtu, ata e dinë se është e pamundur që të realizohen këto dëshira. Njerëzit e tillë gjithmonë janë të pakënaqur dhe kërkojnë edhe më tepër se që tani kanë. Kërkesa dhe dëshira e tyre janë të pafund. Sidoqoftë, bota nuk është vend i përshtatshëm ku plotësohen këto dëshira.

Në këtë botë asgjë nuk është e përjetshme. Koha punon kundër asaj që është e mirë dhe asaj që është e re. Vetura e re nuk del nga moda më shpejt sesa modeli tjetër të dizajnohet, prodhohet dhe të shitet. Njësoj, dikush mund të lakmojë në vilat madhështore ose shtëpitë luksoze me më shumë dhoma sesa banor dhe me pajisje të arta shtëpiake, që i ka parë njëherë, e humb interesimin ndaj shtëpisë së vet dhe nuk mund të mos i ketë zili.

Një kërkim i pafund për më të reja e më të mira, duke mos i dhënë rëndësi asaj që e ka arritur, duke kundërshtuar të vjetrën dhe duke shpresuar vetëm në të renë: këta janë rrathët vicioz që njerëzit i kanë përjetuar kudo gjatë historisë. Por njeriu inteligjent do të duhej që të ndalej dhe të pyes veten për një moment: pse ai ndjek ambiciet e përkohshme dhe a ka arritur ndonjëherë ndonjë gjë nga këto kërkime? Përfundimisht, ai duhet të nxjerrë konkluzionin se “ekziston një problem radikal nga kjo pikëpamje.” Sidoqoftë, njerëzit, duke iu munguar ky lloj arsytimi, vazhdojnë të ndjekin ëndrrat që vështirë se do t'i arrijë.

Askush, sidoqoftë, nuk e di madje se çfarë do të ndodhë në disa orët e ardhshme: në çdo moment mund të pësojë dikush aksident, mund të lëndohet rëndë apo të mbetet invalid. Përveç kësaj, koha fluturon duke u numëruar drejt vdekjes. Çdo ditë e afron ditën e paracaktuar më afër. Vdekja sigurisht zhduk të gjitha ambiciet, lakminë dhe dëshirat e kësaj bote. Nën dhe, nuk mbizotëron as pasuria e as statuti. Secila pasuri, me të cilën kemi qenë koprrac, përfshirë edhe trupin, do të zhduket dhe kalbet në tokë. Qoftë i varfër apo i pasur, i bukur apo i shëmtuar, një ditë do të mbështjellët në qefin të thjeshtë.

Ne besojmë se *E vërteta e jetës së kësaj bote* na ofron një shpjegim sa i përket natyrës reale të jetës së njeriut. Është një jetë e shkurtë dhe mashtruese në të cilën dëshirat e kësaj bote duken magjepsëse dhe premtuese, por e vërteta qëndron ndryshe. Ky libër do t'ju mundësojë që të perceptoni jetën e juaj dhe të gjitha realitetet e saj, dhe t'ju ndihmojë që t'i rishqyrtoni qëllimet tuaja jetësore, nëse doni.

Allahu i urdhëron besimtarët që të këshillojnë të tjerët për këto fakte, dhe i thërret ata që të jetojnë vetëm që të plotësojnë dëshirën e Tij, ashtu siç thotë Ai në këtë ajet:

Premtimi i All-llahut është e sigurt, pra të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote... (Lukman: 33)

JETA E KËSAJ BOTE



niversi ynë është i rregulluar në mënyrë të përsosur. Yje dhe galaktika të panumërta lëvizin nëpër orbitat e tyre në një harmoni të plotë. Galaktikat që përbëhen gati prej 300 miliardë yjeve lëvizin njëra pranë tjetrës dhe për çudi të të gjithëve, gjatë këtij kalimi gjigant nuk ndodhë asnjë përplasje.

Rregulli tillë nuk mund t'i përshkruhet rastësisë. Bile, shpejtësitë e objekteve në univers janë përtej kufijve të imagjinatës së njeriut. Dimensionet fizike të hapësirës janë të shumë të mëdha kur i krahasojmë me matjet që i bëjmë në tokë. Yjet dhe planetët, me masa prej bilionë e trilionë tonelata, e galaktikat, me madhësi që mund të llogariten vetëm përmes formulave matematikore, të gjitha këto lëvizin në rrugët tyre të caktuara në hapësirë me shpejtësi të pabesueshme.

Për shembull, toka sillet rreth boshtit të vet ashtu që një pikat në sipërfaqe e saj lëvizin me një shpejtësi mesatare prej rreth 1,670 km/h. Shpejtësia mesatare lineare e tokës rreth diellit është 108,000 km/h. Këto shifra, sidoqoftë, kanë të bëjnë vetëm me tokën. Ne hasim në shifra edhe shumë më të mëdha kur t'i shqyrtojmë dimensionet përtej sistemit diellor. Në univers, siç sistemet rriten në madhësi, edhe shpejtësitë rritet. Sistemi diellor rrotullohet rreth qendrës së galaktikës me shpejtësi prej 720,000 km/h. Shpejtësia e vetë Rrugës së Qumështit, që përmban rreth 200 bilion yje, është 950,000 km/h. Kjo lëvizje e vazhdueshme është e pakonceptueshme. Toka, së bashku me sistemin diellor, çdo vit lëviz për 500 milion km larg vendit ku ka qenë para një viti.

Ekziston një ekuilibër i jashtëzakonshëm brenda kësaj lëvizje dinamike dhe zbulon se jeta në tokë është e bazuar në një balancim shumë delikat. Një ndryshim i vogël, qoftë edhe milimetrik në orbitën e trupave qiellorë mund të shkaktojë pasoja shumë serioze. Disa mund të jenë aq të dëmshme saqë jeta në tokë do të bëhej e pamundur. Në sistemet e tilla ku ekziston ekuilibri i madh si dhe shpejtësi marramendëse, në çdo kohë mund të ndodhin aksidente gjigante. Mirëpo, fakti që ne jetojmë jetën normale në planetin tonë bën që ne të harrojmë për rreziqet që ekzistojnë në univers. Rregulli i tanishëm i universit me gati numër të parëndësishëm të përplasjeve për të cilat ne dimë, thjeshtë na bën që të mendojmë se neve na rrethon një mjedis i përsosur, i qëndrueshëm dhe i sigurt.

Njerëzit nuk mendojnë shumë për çështje të tilla. Kjo është pse ata kurrë nuk shohin rrjetin e jashtëzakonshëm të kushteve të ndërlydhura mes veti që e bën jetën e mundur në tokë e as që e kuptojnë ata se njohja e qëllimit të vërtetë të jetës së tyre është aq e rëndësishme. Ata jetojnë madje pa e pyetur veten se si ky ekuilibër i pafund e delikat e ka zanafillën.

Megjithatë, njeriut i është dhënë mundësia për të menduar. Njeriu pa meditar në mënyrë të vetëdijshme dhe të mençur për ambientin që e rrethon, kurrë nuk do të mund ta shoh realitetin apo të ketë ide më të vogël pse është krijuar kjo botë dhe kush është ai që bën këtë rregull të madh të lëviz me aq rimë të përkryer.

Dikush që i rreh në mendje këto çështje dhe e kupton rëndësinë e tyre do të përballët me faktin e pashmangshëm: universi në të cilën jetojmë është e krijuar nga Krijuesi, ekzistenca dhe cilësitë e të Tij janë të shfaqura në çdo gjë që ekziston. Toka, një pikë e imtë në univers, është krijuar që të shërbejë për një qëllim të rëndësishëm. Asgjë nuk ndodhë pa qëllim të caktuar në rrjedhën e jetës sonë. Krijuesi, duke i shfaqur cilësitë e Tij, fuqinë e Tij dhe urtësinë nëpër univers, nuk e ka lënë njeriun të vetmuar por e ka vendosur atë me qëllim të rëndësishëm.

Arsyeja pse njeriu ekziston në tokë është treguar hollësisht nga Allahu në Kur'an:

Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmiri. Ai është ngadhënjyesi, mëkatëfalësi. (Al Mulk: 2)
Ne e krijuam prej ujit të bashkë-dyzuar për të sprovuar atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë. (Al Insan: 2)

Në Kur'an, Allahu më tutje e bën të qartë se asgjë nuk është pa qëllim:

Ne nuk e krijuam qiellin, tokën e çdo gjë çka mes tyre shkel e shko (pa qëllim të caktuar). Sikur të kishim dashur të zbavitemi dhe sikur të donim ta bënim atë, Ne do të zbaviteshim në kompetencën Tonë, por Ne nuk bëmë atë. (Enbia: 16-17)


Fshehtësia e Botës

Allahu thekson qëllimin e njeriut në ajetin vijues:

Gjithçka që është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t'i provuar ata, se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë. (Kahf:7)

Duke bërë këtë, Allahu pret nga njeriu gjatë tërë jetës që të mbetet shërbëtor i devotshëm i Tij. Me fjalë tjera, bota është vend, ku ata që i frikësohen Allahut dhe ata që janë jo falënderues dallojnë nga njëri tjetri. E mira dhe e keqja, e përsosura dhe e meta janë pranë njëra tjetrës në këtë "rregullim". Njeriu sprovohet në shumë mënyra. Në fund, besimtarët do të veçohen nga jobesimtarët dhe do të fitojnë parajsën. Në Kur'an kjo përshkruhet kështu:

Duke e shikuar tokën nga gjithësia, çdokush që mendon të jetë suprem sigurisht se do t'a shoh vetën si një pikë të vogël në këtë botë.



Duke menduar se ata kanë një status dhe vend të dalluar në këtë botë, njerëzit shpeshherë marrin veten dhe mënyrën e jetës së tyre të ndryshme nga të tjerët. Sidoqoftë, pa marrë parasysh se a është i pasur apo i varfër, i ri apo i vjetër, i arsimuar apo analfabet, njeriu zen një hapsirë të parëndësishme në gjithësinë e pafund, në oqeanin e miliarda yjeve.

A menduan njerëzit të thonë: “Ne kemi besuar, e të mos vihen në sprovë?” Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që All-llahu gjithqysh do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën do t'i dallojë dhe gënjeshtarët. (Ankebut:2-3)


Në mënyrë që të kuptohet esenca e kësaj sprove, njeriu duhet që të ketë njohuri të thellë për Krijuesin e tij, ekzistenca dhe cilësitë e të Cilit shfaqen në çdo gjë që ekziston. Ai është Krijuesi, Poseduesi i fuqisë, dënorësi dhe mençurësi së pafund.

Ai është All-llahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të tij janë emrat më të bukur. Atë (All-llahun) e madhëron çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënjyesi, i urti! (Hashr:24)

Allahu e krijoi njeriun nga balta, duke e pajisur atë me shumë tipare, dhe i dhuroi shumë mirësi. Askush nuk mëson vetvetiu si të sheh, si të dëgjoj, si të ec apo si të marr frymë. Bile, këto sisteme komplekse janë të vendosura në trupin e tij në mitër para se ai të lind, atëherë kur ai nuk ka asnjë mundësi që të perceptoj botën e jashtme.

Pasi i janë dhënë të gjitha këto tipare, ajo që pritet nga njeriu është që

Pamja tregon pozitën e tokës në sistemin diellor, pozitën e sistemit diellor në Rrugën e Qumshtit dhe përfundimisht, pozitën e galaktikës sonë në univers.



të bëhet shërbëtor i Allahut. Mirëpo, siç Allahu thotë qartë në Kur'an, shumica e njerëzve janë "keqberës" dhe "jo falënderues" ndaj Krijuesit të tyre, për shkak se ata refuzojnë nënshtrimin ndaj Allahut. Ata supozojnë se jeta është e gjatë dhe se ata kanë fuqi personale që të mbijetojnë.

Kjo është arsyeja pse qëllimi i tyre është që të "shfrytëzojnë jetën deri në fund". Ata e harrojnë vdekjen dhe ahiretin. Ata përpiqen që të kënaqen në jetë dhe që të arrijnë standarde më të mira jetësore. Allahu shpjegon lidhjen e tyre ndaj kësaj jete në ajetin vijues:

Vërtet, ata (idhujtarët) e duan shumë këtë jetë dhe e zënë asgjë ditën e rëndë që i pret. (Insan:27)

Jobesimtarët përpiqen që të shijojnë të gjitha kënaqësitë e kësaj bote. Por, siç sugjeron ajeti, jeta kalon shumë shpejt. Kjo është pika vendimtare që shumica e njerëzve harrojnë ta përkujtojnë.

Të marrim një shembull për të qartësuar më shumë temën në fjalë.

Disa sekonda apo disa orë?

Paramendo një pushim tipik: pas shumë muajve të punës së zellshme, i ke dy javë pushim dhe keni arritur në pushimorën tuaj të preferuar pas tetë orëve vozitje të lodhshme. Korridori është i stërmbushur me mysafirë si ju. Bile i vëren fytyrat e njohura dhe i përhëndetë ata. Koha është e ngrohtë dhe nuk dëshiron që ta humbasësh asnjë minutë të kënaqësisë nën diell dhe detin e qetë, kështu që pa humbur kohë, e gjen dhomën tënde, vesh kostumet e larjes dhe vrapon për në plazh. Më në fund, arrin tek uji i pastër si loti, por papritmas të befason një zë: "Zgjuhu, do të vonohesh për në punë!"

Këto fjali të duken të pakuptimta. Për një çast, nuk e kupton se çfarë është duke ndodhur; aty është një mungesë ndërlihdjeje e pakuptueshme ndërmjet asaj që sheh dhe dëgjon. Kur i hap sytë dhe e sheh veten në dhomën e fjetjes, e vërteta është se e gjitha ka qenë ëndërr dhe që iu ka mahnitur shumë. Nuk mund ta përmbash veten duke e shprehur mahnitjen: "Kam vozitur tetë orë për të arritur atje. Megjithëse sot përjashta është ftohtë acar, e ndjeva ngrohtësinë e diellit në ëndërr. I ndjeva edhe stërpikat e ujit në fytyrën time."

Tetë orë rrugë gjer tek vend pushimi, koha që ke pritur në korridor,

shkurtimisht, çdo gjë që ka të bëjë me pushimin tënd në të vërtetë ishte një ëndërr prej disa sekondash. Megjithëse nuk dallohej nga jeta reale, çfarë keni përjetuar në mënyrë të vërtetë ishte vetëm se një ëndërr.

Kjo sugjeron se ne do të mund të zgjohemi nga jetë në tokë sikur që zgjohemi nga ëndrra. Pastaj, jobesimtarët do të shprehen në të njëjtën mënyrë habie. Gjatë jetës së tyre, ata nuk kanë mundur ta lirojnë veten nga keq perceptimi se jeta e tyre do të jetë e gjatë. Sidoqoftë, në kohën kur ata do të ringjallen, do të kuptojnë se periudha kohore që duket të ketë qenë jeta prej 60 apo 70 vjetësh ishte thjesht sikur një kohëzgjatje prej disa sekonda. Allahu tregon për këtë gjë në Kur'an:

Ai thotë: “E sa vjet keni kaluar në tokë?” Ata thonë: “Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës, pyeti ata që dinë numërimin Ai thotë: “Mirë e keni, sikur ta dinit njëmend pak keni qëndruar!”(Mu'minun:112-114)

Qoftë dhjetë apo njëqind vjeç, njeriu eventualisht do të kuptojë kohën e shkurtë të jetës së tij siç tregon ajeti më lartë. Kjo është sikur në rastin kur njeriu që zgjohet nga ëndrra duke iu zhdukur të gjitha pamjet e pushimit të bukur dhe të gjatë, papritur duke kuptuar se kjo ka qenë vetëm një ëndërr prej disa sekondash. Në të njëjtën mënyrë, shkurtësia e jetës do të godasë njeriun kur të gjitha tjerat për jetë e tij harrohen. Në ajetin vijues të Kur'anit Allahu kujdesshëm tërheq vëmendjen në këtë fakt:

E ditën kur të bëhet kiameti (ditën e gjykimit), kriminelët betohen se nuk qëndruan (në dynja) gjatë, por vetëm një çast të shkurtër. Kështu kanë qenë ata që i bishtëruan të së vërtetës. (Rrum:55)

Të gjithë e kanë kohën e caktuar, sikur për ata që jetojnë disa orë apo disa ditë, e sikur për ata që jetojnë për 70 vjet... Diçka që është e kufizuar do të përfundojë një ditë. Të jetë tetëdhjetë apo njëqind vjeç, çdo ditë njeriu i afrohet ditës së paracaktuar. Njeriu, në të vërtetë, e përjeton këtë fakt gjatë tërë jetës së tij. Pa marrë parasysh planet e projektuara që ai planifikon për vete, një ditë ai do të arrijë atë kohë specifike kur ai do të përfundojë qëllimin e tij. Çdo synim apo gjë e çmuar e menduar si pikë kthyesë në jetën e ndonjërit, shumë shpejt del se ka qenë vetëm fantazi e përkohshme.

Paramendoni një djalosh, p.sh., i cili sapo ka hyrë në shkollën e mesme. Natyrisht, ai mezi pret ditën që do të diplomojë. Ai shpreson në atë me

padurim të papërmbajtur. Shumë shpejt do ta sheh veten duke u regjistruar në fakultet. Në këtë etapë të jetës së tij, atij as që i bien ndërmend vitet e gjata në shkollën e mesme. Ai tashmë ka tjera gjëra që e preokupojnë; ai dëshiron që t'i shfrytëzojë maksimalisht këto vite të çmueshme që ta lehtësojë frikën e tij për të ardhmen. Kështu që, ai bën plane të shumta. Jo shumë gjatë, e ai është i zënë me përgatitjen e martesës së tij, një rast i veçantë që e pret me padurim. Sidoqoftë koha kalon më shpejt se sa ai ka prituri dhe ai lë prapa vete shumë vite dhe përnjëherë e gjen veten si një njeri që kujdeset për familjen. Me kohë ai bëhet gjysh, një plak i vjetër me shëndet që vazhdimisht i dobësohet, ai si nëpër mjegull i përkujton ngjarjet që i jepnin kënaqësi sa ishte i ri. Kujtimet e zymta zbehen edhe më tej. Shqetësimet që e mundonin si të ri më nuk i interesojnë. Vetëm disa pamje të jetës së tij i shpalosen para syve. Koha e paracaktuar afrohet. Koha e mbetur është shumë e kufizuar; disa vite, disa muaj apo ndoshta edhe vetëm disa ditë. Tregim klasik i njeri, pa përjashtime, përfundon me shërbimin e funeralit, ku marrin pjesë anëtarët e familjes së ngushtë, miqtë e afërt si dhe farefisi. E vërteta është se askush nuk është imun ndaj këtij përfundimi.

Megjithatë, që nga fillimi i historisë, Allahu e ka njoftuar mësuar njeriun për natyrën e përkohshme të kësaj bote dhe e ka përshkruar jetën e ahiretit si vendbanim të vërtetë dhe përhershëm të tij. Shumë detaje që kanë të bëjnë me parajsën dhe ferrin përshkruhen në shpalljet e Allahut. Pavarësisht nga ky fakt, njeriu tenton të harrojë këtë të vërtetë thelbësore dhe mundohet që të gjitha përpjekjet e veta t'i investojë në këtë jetë, edhe pse është e shkurtë dhe e përkohshme. Mirëpo vetëm ata që supozojnë një qasje racionale ndaj jetës janë të ftuar që të kthjellësojnë mendjet dhe vetëdijet e tyre dhe të kuptojnë se kjo jetë nuk e vlen aspak në krahasim me jetën e përhershme. Për këtë arsye synimi kryesor i njeriut është që të fitojë parajsën, vend i përhershëm i bujarisë dhe bollëkut të Allahut. Kërkimi i kënaqësisë së Allahut me besim të vërtetë është mënyra e vetme që të fitohet ahireti. Mirëpo, ata që tentojnë të mos mendojnë për fundin e pashmangshëm të kësaj bote, dhe që jetojnë duke qëndruar me atë qëndrim sigurisht që meritojnë dënim të përhershëm.

Allahu në Kur'an tregon për fundin e tmerrshëm që do të përjetojnë këta njerëz:

(Përkujto) Ditën kur i tubojnë ata, (atyre u duket) sikur nuk qëndruan (në dynja) vetëm një moment të ditës, atëherë njihen mes vete. E, vërtetë, kanë dështuar ata që nuk besuan këtë prezencë para All-llahut, kanë refuzuar udhën e drejtë. (Junus: 45)

Ti (Muhamed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta, sepse ditën kur do ta përjetojnë atë (dënimin) që u është premtuar, atyre u duket sikur nuk kanë jetuar vetëm se në një moment të shkurtër të ditës. Kumesë e mjaftueshme! A mos shkatërrohet kush, pos popullit të shfrenuar. (Ahkaf: 35)

Ambicie të shfrenuara

Më herët në këtë libër, kemi përmendur se koha që një njeri i zakonshëm e kalon në këtë botë është e shkurtë “sa qel e mbyll sytë”. Sidoqoftë, pa marrë parasysh se çfarë posedon njeriu në jetë, ai nuk do ta arrijë kënaqësinë e vërtetë përderisa ai nuk beson në Allahun dhe përmend Allahun pa pushuar.

Që nga koha kur ai fillon të bëhet i rritur ai lakmon pasurinë, fuqinë ose statusin. Mirëpo, për çudi, ai ka burime të kufizuara për të plotësuar këto dëshira; nuk ka shans që t'i posedoj të gjitha që i dëshiron. As pasuria, as suksesi apo ndonjë përparim, sidoqoftë, nuk do t'i qetësojë ambiciet e tij. Pa marrë parasysh statusin social apo gjininë, jetët e njerëzve shumë shpesh janë të kufizuara në vetëm 6 apo 7 dekada. Me mbarimin e kësaj periudhe, vdekja i bën të gjitha kënaqësitë e kësaj bote, gjëra të pakuptimta.

Ai që është i prirë për dëshira të shfrenuara gjithmonë e gjen vetën të sëmurë “me pakënaqësi”. Në secilën fazë të jetës, kjo pakënaqësia është çdoherë e pranishme, ndërsa shkaqet ndryshojnë varësisht nga koha dhe kushtet. Dëshira për të plotësuar këto dëshira mund t'i bëj disa njerëz të llastohen gati në çdo gjë. Ai mund të jetë aq i angazhuar ndaj dëshirave të tij sa që është i gatshëm që të përballoj çdo pasojë, bile edhe nëse do të thotë humbjen e familjes së ngushtë apo të jetë i dëbuar. Ndonjëherë me kohë ai e arrin cakun e vet, por “magjia” zhduket. Ai humb interesimin në qëllimin e tij të arritur. Për më tepër, duke qenë i pakënaqur me këtë arritje, ai menjëherë fillon që të kërkojë një synim apo cak tjetër dhe bën

çfarëdo që është e mundur që të arrijë cakun derisa ta arrijë atë.

Posedimi i ambicieve të shfrenuara është karakteristikë tipike e një jobesimtar. Kjo veçori mbetet me të deri sa të vdes. Kurrë nuk ndihet i kënaqur me atë që ka. Kjo është për shkak se ai thjesht i dëshiron të gjitha për lakminë vetjake të tij e jo që të fitojë kënaqësinë e Allahut. Në të njëjtën mënyrë, të gjitha që njerëzit i posedojnë dhe përpiqen që t'i kenë është arsye për lëvdatë, e njerëzit bëhen të shkujdesur nga kufizimet që i ka vënë Allahu. Sigurisht, Allahu nuk do të lejojë dikë që është aq i pabindur ndaj Tij që të ketë qetësi shpirtërore në këtë botë. Allahu thotë në ajetin Kur'anor:

“Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen.” (Rra'd:28)

Bota mashtruese

Shembuj të panumërt të krijimit të përsosur e rrethojnë njeriun kudo në botë: pamje të mahnitshme, miliona lloje bimësh të ndryshme, qielli i kaltër, retë e rënda me shi, apo trupi i njeriut – një organizëm i përsosur përplot me sisteme komplekse. Të gjitha këto janë shembuj mahnitës të krijimit, mendimi për këto jep perceptim të thellë.

Shikimi i fluturës duke shfaqur krahët e saj, modele të mrekullueshme e të ndërlikuara me çka edhe dallohet, është një përjetim që kurrë nuk harrohet. Puplat e kokës së një zogu, aq të imëta e të shkëlqyera që duken sikurse një copë kadife e zezë, apo ngjyrat tërheqëse e aroma e luleve janë të mahnitshme për shpirtin e njeriut.

Çdonjërit, gati pa përjashtim, i pëlqen fytyra e bukur. Shtëpitë luksoze, orendi prej ari dhe veturat luksoze për disa njerëz janë pasuritë më të dashura. Njeriu dëshiron shumë gjëra tjera në jetë, por bukuria e çdo gjëje që posedojmë është e paracaktuar që të zhduken në kohë.

Pema gradualisht priset dhe më në fund kalbet që nga çasti kur është këputur nga dega. Aroma e luleve mbush dhomat tona vetëm për periudhë të kufizuar. Së shpejti, ngjyrat fillojnë t'u zbehen dhe vyshken. Fytyra më e bukur rrudhet pas disa dekadave: efekti i vjetëve në lëkurë dhe zbardhja e flokëve bën që ajo fytyrë e bukur mos të dallohet shumë nga fytyrat e

tjera të njerëzve të plakur. Nuk mbetet asnjë shenjë nga lëkura e shëndoshë dhe faqet e kuqe të një tinejxheri pasi të kalojnë vitet. Ndërtesat duhet të rinovohen; veturat dalin nga moda, bile çka është edhe më keq, ndryshken. Shkurtimisht, çdo gjë që na rrethon i nënshtrohet shkatërrimit të kohës. Kjo duket të jetë për disa si “një proces natyror”. Mirëpo, bartë një porosi të qartë: “asgjë nuk është immune ndaj efektit të kohës.”


Mbi të gjitha, çdo bimë, kafshë dhe qenie njerëzore në botë – me fjalë tjera, çdo qenie e gjallë – është e vdekshme. Fakti se popullsia botërore nuk pakësohet gjatë shekujve – për shkak të lindjeve – nuk duhet të na bëjë që të mos e përfillim faktin e vdekjes.

Sidoqoftë si pasion i shfrenuar, magjia e posedimit dhe pasurisë ndikon shumë në njeriun. Etja për të posedim padashur e rrëmben atë. Mirëpo, një gjë duhet kuptuar: Allahu është i vetmi Posedues i çdo gjëje. Qeniet e gjalla jetojnë aq sa Ai dëshiron dhe vdesin kur Ai e përcakton vdekjen e tyre.

Allahu e thërret njeriun që ta mendoj për këtë në ajetin vijues:

Shembulli i jetës së kësaj bote është si i një shiu që e kemi zbritur nga qielli, e me anën e të cilit gërshetohen bimët e tokës (mbijnë dhe shpeshetohen të gjitha llojet) prej nga hanë njerëzit e kafshët deri kur toka të ketë marrë stolinë e vet dhe të jetë zbukuruar (me bimë, pemë e behar), e banorët e saj të mendojnë se janë të zotët e saj, e asaj i vjen urdhri ynë, natën ose ditën, Ne e bëjmë atë (të mbjellat) të korrur sikurse të mos ekzistonte dje. Kështu Ne u sqarojmë faktet njerëzve që mendojnë. (Junus: 24)

Në këtë ajet, është treguar se çdo gjë në këtë botë që mendohet të jetë e këndshme dhe e bukur një ditë do të humb bukurinë e vet. Bile, do të zhduken krejtësisht nga faqja e dheut. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme për ta menduar, meqë Allahu na informon se Ai jep shembuj të tillë “për ata që mendojnë”. Nga njeriu si qenie inteligjente pritet që të mendojë dhe të marrë mësim nga ngjarjet dhe më në fund që t'i vë synimet e arsyeshme për jetën e tij. “Të menduarit” dhe “të kuptuarit” janë veçori unike të njeriut; dhe pa këto veçori, njeriu humb tiparet e veta dalluese dhe bëhet edhe më i ultë se kafshët. Edhe kafshët bëjnë jetë që ngjason në disa aspekte me jetën e njeriut: marrin frymë, shtohen dhe një ditë vdesin. Kafshët kurrë nuk mendojnë pse dhe si janë lindur, apo se një ditë do të vdesin. Është shumë e natyreshme që ato nuk angazhohen në përpjekjen për



Në Kur'an, në shpalljen e fundit origjinale që ka mbijetuar dhe që është për njerëzimin si udhëtrëgues drejt rrugës së vërtetë, Allahu vazhdimisht n'a e përkujton natyrën e përkohshme të kësaj jete, duke n'a ftuar që të kthjellim mendjen dhe ndërgjegjen. Në të vërtetë, kudo që jemi, të gjithë jemi të ndieshëm ndaj efekteve shkatërrimtare të kësaj bote, një fenomen vetë-shpejgues për ata njerëz që analizojnë jetën dhe ngjarjet përreth. Kjo është gjithashtu e vërtetë edhe për të gjitha ngashnjimet përreth nesh. Secila nga pamjet e kësaj faqjeje është një dëshmi e këtij fakti. Në çdo skaj të botës, pa marrë parasysh sa është impulsive, do t'i ekspozohet dëmtimit të pashmangshëm pas disa dekadave, e bile ndonjëherë edhe për periudha edhe më të shkurta se sa që dikush mund të pret.



Çdo gjë në tokë i është destinuar zhdukjes. Kjo është natyra e vërtetë e jetës së kësaj bote...

të kuptuar e qëllimin e vërtetë të kësaj jete; ato nuk pritet të mendojnë për qëllimin e krijimit të tyre apo për Krijuesin.


Mirëpo, njeriu është përgjegjës ndaj Allahut për të ngritur vetëdijen për Allahun duke menduar dhe duke qenë i ndërgjegjshëm ndaj urdhrave të Tij. Më tutje, nga ai pritet që të kuptojë se kjo botë ekziston vetëm për një kohë të caktuar. Ata që me të vërtetë i kuptojnë këto fakte do të kërkojnë udhëzimin dhe ndriçimin e mendjes nga Allahu duke u angazhuar në vepra të mira.

Përndryshe, njeriu do të ballafaqohet me vuajtje në të dy botët, në këtë dhe në ahiret. Ai bëhet i pasur, por kurrë i lumtur. Bukuria dhe fama zakonisht sjellin më shumë fatkeqësi sesa jetë të lumtur. Një njeri i popullarizuar, p.sh. i cili një ditë gjendet në lajkat e admiruesve të vet, më vonë lufton me disa problemet shëndetësore, dhe një ditë vdes i vetmuar në një dhomë të vogël hoteli, duke mos u kujdesur askush për të.

Shembuj Kur'anor për mashtrimet e botës

Allahu pandërprerë thekson në Kur'an se kjo është vetëm “një botë ku të gjitha kënaqësitë janë të gjykuara të zhduken”. Allahu tregon tregime





Shembulli i jetës së kësaj bote është si i një shiu që e kemi zbritur nga qielli, e me anën e të cilit gërshtohen bimët e tokës (mbijnë dhe shpeshohen të gjitha llojet) prej nga hanë njerëzit e kafshët deri kur toka të ketë marrë stolinë e vet dhe të jetë zbukuruar (me bimë, pemë e behar), e banorët e saj të mendojnë se janë të zotët e saj, e asaj i vjen urdhri Ynë, natën ose ditën, Ne e bëjmë atë (të mbjellat) të korrur sikurse të mos ekzistonte dje. Kështu Ne ua sqarojmë faktet njerëzve që mendojnë.

(Junus:24)

për shoqëritë, burra e femra nga e kaluara që janë kënaqur në pasuritë, famën ose statusin social të tyre, se kanë pasur përfundime të tmerrshme. Kjo pikërisht u ka ndodhur dy njerëzve, siç tregohet në suren Kehf:

E ti sillu atyre (që kërkuan t'i largosh varfanjakët) si shembull dy njerëz; njërit prej tyre i dhamë dy kopshte (vreshta) nga rrushi dhe ato i rrethuam me hurma, e në mes atyre dyjave bimë tjera.

Të dy kopshtet jepnin frutat e veta pa munguar prej tyre asgjë, e në mesin e tyre bëmë të rrjedhë një lumë.

Ai kishte edhe pasuri tjetër. E ai atij shokut të vet (që ishte besimtar) itha: - duke iu krenuar atij - “Unë kam pasuri më shumë se ti e, kam edhe krah më të fortë!”

Dhe ai hyri në kopshtin e vet (e me besimtarin për dore), po duke qenë dëmtues i vetës (duke mos besuar dhe duke u krenuar) tha: “Unë nuk mendoj se zhduket kjo kurrë!”

Dhe nuk besoj se do të ndodhë kiameti, (dita e gjykimit), por nëse bëhet që të kthehem te Zoti im, padyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo.

Atij ai shoku i vet (besimtari) i tha - duke e polemizuar atë -: “A e mohove Atë që të krijoi ty nga dheu, pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të plotë?”

“Por për mua, Ai All-llahu është Zoti im, e Zotit tim unë nuk i bëj shok askë!”

E pse ti kur hyre në kopshtin tënd nuk the: “Ma shaell llah, la kuvete il-la bil lah” - (Allahu çka do bëhet, s'ka fuqi pa ndihmën e Tij). Nëse ti më sheh mua se unë kam më pak prej teje edhe pasuri edhe fëmijë (krah më të dobët).

Po unë shpresoj se Zoti im do të më japë edhe më të mirë nga kopshti yt, e këtij tëndit t'i shkaktojë fatkeqësi nga qielli e të gdhijë tokë e lëmuar (e zhveshur).

Ose të gdhijë uji i shterur, e ti kurrsesi nuk mund ta kërkosësh atë!”

Dhe vërtet, u shkatërruan frutat e tij, e ai filloi të rrahë shuplakët për atë që kishte shpenzuar në të, e ajo ishte rrënuar në kulmet e saj dhe thoshte: “O i mjeri unë, të mos i kisha bërë Zotit tim askë shok!”

E nuk pati krah (grup), përveç All-llahut të vërtetë që t'i ndihmojë atij dhe nuk mundi ta pengojë.

Në atë vend ndihma është vetëm e All-llahut të vërtetë. Ai është shpërblyesi më i mirë dh te Ai është përfundimi më i mirë.

E ti (Muhammed) paraqitu atyre shembullin e kësaj bote që është si një ujë (shí) që Ne e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshtohet sa që përzihet mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send.

Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë. (Kehf: 32-46)

Mburrja e dikujt me pasurinë e vet e bën atë qesharak. Ky është ligj i pandryshuar i Allahut. Pasuria dhe pushteti janë dhuratë nga Allahu dhe në çdo moment mund të merren. Tregimi për “pronaret e kopshtit” që është treguar në Kur’an është një shembull tjetër në lidhje me këtë:

Ne i sprovuam ata (mekasit) sikurse i kemi pas sprovuar pronarët e kopshtit. Kur u betuan se do të vjelin atë herët në agim. E nuk thanë (kur u betuan): “Në dashtë All-llahu - inshall-llah!” E, sa qenë ata fjetur, atë (kopshtin) e goditi një bela nga Zoti yt.

Dhe ai gdhii si të ishte i vjelë.

Ata në mëngjes thërritnin njëri-tjetrin. Ngrihuni herët te prodhimet e tuaja, nëse doni t'i vilni! Dhe ata vajtën duke pëshpëritur në mes vete (të mos i dëgjojnë kush). Të mos lejojnë të afrohet sot në të asnjë i varfër. E kur e panë atë, thanë: “S’ka dyshim, ne kemi humbur (rrugën)”. Jo, (ne nuk kemi humbur rrugën) por paskemi mbetur pa të! Ai me maturi prej tyre tha: “A nuk ju thashë përse nuk e përmendni Zotin?” Atëherë ata thanë: “I pafajshëm është Zoti ynë, ne ishim të padrejtë” Dhe u kthyen e po e qortojnë njëri-tjetrin. Thanë: “Të mjerët ne, vërtet ne ishim jashtë rrugës!” Shpresohet se Zoti ynë do na zëvendësojë me ndonjë edhe më të mirë se ai; ne vetëm te Zoti ynë mbajmë shpresën.



Ja, kështu do të jenë dënimi (i mekasve), ndërsa dënimi i botës tjetër do të jetë shumë më i ashpër, sikur të jenë që e kuptojnë. (Kalem:17-33)

Syri i kujdesshëm menjëherë e vëren nga këto ajete se në këtë tregim Allahu nuk jep shembuj nga jeta e ateistëve. Këta që përmenden këtu janë pikërisht ata që besojnë në Allahun por zemrat e tyre janë bërë të ftohta ndaj përkujtimit të Allahut dhe të cilët janë jo-falënderuese ndaj Krijuesit të tyre. Ata bëhen kryelartë në atë çfarë Allahu iu ka dhënë si dhuratë, dhe krejtësisht kanë harruar se këto dhurata janë vetëm burime që të përdorën



E ti (Muhammed) paraqitjau atyre shembullin e kësaj bote që është si një ujë (shi) që Ne e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshtohet saqë përzihet mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send. (Kehf:45)





në mënyrën e Tij. Në mënyrë tipike, ata pohojnë ekzistencën dhe fuqinë e Allahut; por zemrat e tyre janë të mbushura me krenari, ambicie dhe egoizëm.

Tregimi i Karunit, njërit prej popullit të Musait a.s., në Kur'an rrëfëhet si shembull tipik i karakterit të pasanikut të kësaj bote. Që të dy, Karuni dhe ata që vrapojnë pas statusit dhe pasurisë së tij janë të ashtuquajtur besimtarë që largohen nga feja e tyre për shkak të pasurive e kështu humbin jetën e bekuar e të përhershme, humbja e tyre është humbje e përhershme:

Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai shtypte atë popull ngase Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri sa që një grup i fuqishëm mezi bartin çelësat e (pasurisë së) tij, e kur populli i vet i tha: “Mos u kreno aq fortë sepse All-llahu nuk i do të shfrenuarit!” Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se All-llahu nuk i do çrregulluesit. Ai (Karuni) tha: “Më është dhënë vetëm në saje të dijes sime!” Po a nuk e di ai se All-llahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë sish që ishin edhe më të fuqishëm e më tëi pasur se ai, po mëkatarët kriminelë as që do të pyeten për fajet e tyre (meqë All-llahu e di). Ai (Karuni) doli para popullit të vet me stolinë e vet, e ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: “Ah, të kishim pasur edhe ne si i është dhënë Karunit, vërtet ai është fatbardhë!” E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: “Të mjerët ju, shpërblimi i All-llahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë, po atë nuk mund ta arrijë kush përveç durimtarëve!” Po Ne atë dhe pallatin e tij i shafuam në tokë dhe, veç All-llahut nuk pati që ta mbrojë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet. E ata që dje lakmuan të ishin në vendin e tij, filluan të thonë: “A nuk shihni se All-llahu me të vërtetë i jep begati e komoditet atij që do nga robërit e vet, e edhe ia mungon atë atij që do, e sikur All-llahu të mos bënte mëshirë ndaj nesh, do të na sharronte në tokë edhe neve; sa habi, se si jobesimtarët nuk gjejnë shpëtim!” Atë, vend të përjetshëm (Xhennetin) u kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë, e përfundim i këndshëm u takon atyre që i frikësohen All-llahut. Kush sjell me vete punë të mirë, atij do t'i takojë



shpërblimi edhe më i madh, ndërsa ai që paraqitet me punë të këqija, do t'i jepet dënim vetëm aq sa e ka merituar. (Kasas:76-84)

Vepra më e shëmtuar e Karunit ishte që ta shoh veten si të veçantë dhe të pavarur nga Allahu. Në të vërtetë, siç sugjeronë edhe ajeti, ai nuk e ka mohuar ekzistencën e Allahut, por thjesht ka menduar se ai- për shkak të veçorive të veta superiore – meritoi fuqinë dhe pasurinë që atij i dhuroi Allahu. Sidoqoftë, të gjithë njerëzit në botë janë shërbëtorë të Allahut dhe pasuria e tyre nuk iu është dhënë atyre vetëm pse ata e meritojnë. Të gjithat që i jepen njeriut janë dhuratë nga Allahu. Nëse ai është i vetëdijshëm për këtë fakt, ai kurrë nuk do të ishte jo-falënderues dhe i prishur ndaj Krijuesit të vet për shkak të pasurisë që ka. Ai vetëm do të ndihet falënderues dhe do të shfaqë mirënjohjen e tij me sjelljet e tij të mira ndaj Allahut. Sigurisht kjo është mënyra më e mirë dhe më e ndershme që të tregohet mirënjohja e dikujt ndaj Allahut. Nga ana tjetër, Karuni dhe ata që kanë aspirata të bëhen sikur ai, i kuptojnë veprat e liga që ata i bëjnë vetëm kur ndeshen me fatkeqësi. Pas të gjitha të këqijave që bien mbi ta, nëse ende vazhdojnë me të njëjtin avaz ndaj Allahut, ata janë plotësisht të shkatërruar. Fundi i tyre do të jetë i pashmangshëm: ferri (xhehenemi), një vend i lig në të cilin do të mbesin përgjithmonë!

Ju njerëz dine se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga All-llahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues. (Hadid:20)

DOBËSIA E NJERIUT

Allahu e krijoi njeriun në formën më të kompletuar dhe e pajisi atë me karakteristika superiore. Superioriteti i tij mbi të gjitha krijesat – që paraqitet me anë aftësive unike intelektuale të të menduarit dhe të të kuptuarit, dhe gatishmërinë e tij për të mësuar dhe për të zhvilluar kultura – është çështje e padiskutueshme.

A keni menduar ndonjëherë pse pavarësisht nga të gjitha këto karakteristika superiore ka trup aq të brishtë, që është i lëndueshëm ndaj kërcënimit të jashtëm dhe të brendshëm? Pse i është ekspozuar ndaj sulmeve të mikrobeve apo baktereve, që janë shumë të vogla sa që nuk duken me sy të lirë? Pse ai çdo ditë duhet të harxhojë një pjesë të caktuar të kohës për ta mbajtur veten të pastër? Pse atij i nevojitet kujdesi trupor? Dhe pse ai plaket me kalimin e kohës?

Njerëzit mendojnë se këto nevoja janë fenomene natyrore. Por, nevojë për kujdes si njeri shërben për një qëllim të veçantë. Secili detaj i nevojave të njeriut është i krijuar veçanërisht. Ajeti “... **njeriu është (krijuar i dobët) i paaftë**” (Nisa:28) dukshëm tregon për këtë fakt.

Nevojat e paskajshme të njeriut janë krijuar me qëllim që ta bëjnë atë të kuptojë se ai është shërbëtor i Allahut dhe se kjo jetë është banesë e përkohshme e tij.

Njeriu nuk ka kurrfarë ndikimi në vendin dhe datën e lindjes së tij. Gjithashtu, ai kurrë nuk e di se si dhe kur do të vdes. Bile, të gjitha përpjekjet e tij për të eliminuar faktorët që ndikojnë negativisht në jetën e tij janë të kota dhe të pashpresa.

Njeriu me të vërtetë ka natyrë të brishtë që i nevojitet përkujdesje e madhe për të mbijetuar. Ai është i pambrojtur dhe i pafuqishëm përballë incidenteve të paparashikuara që ndodhin në botë. Në të njëjtën mënyrë është i ekspozuar rreziqeve të paparashikuar të shëndetit, pa marrë parasysh a është banor i civilizimit të lartë apo i ndonjë fshati të largët malor dhe të pazhvilluar. Shumë lehtë mund të ndodhë që njeriu mund të has në ndonjë sëmundje të pashërueshme apo vdekjeprurëse. Në çdo kohë, mund të ndodh një aksident që i shkakton dëmtime trupore edhe ndokujt që është i fuqishëm apo ndokujt me trup të hatashëm. Pos kësaj, kjo mund t'iu ndodhë të gjithë njerëzve pa dallim statusi, kategorie apo race, etj., dhe atë pa asnjë përjashtim. Jeta e ndonjë njeriu të famshëm me miliona simpatizues apo e ndonjë bariu të thjeshtë mund të ndryshojë një ditë nga ndonjë incident i papritur.

Trupi i njeriut është një organizëm i dobët i përbërë nga eshtrat dhe mishi me peshë mesatare prej 70-80 kg. Vetëm lëkura e brishtë e mbron atë. Padyshim, kjo lëkurë e ndjeshme shumë lehtë mund të lëndohet dhe mavijohet. Ajo mund të pëlcasë dhe të thahet nëse i ekspozohet një kohë të gjatë erës apo diellit. Në mënyrë që mos i “dorëzohet” kushteve natyrore njeriu duhet çdo herë që të kujdeset ndaj efekteve të ambientit.

Megjithëse njeriu është i pajisur me sisteme të mahnitshme trupore, “materialet” si- mishi, muskujt, eshtrat, indet nervore, sistemi kardiovaskular dhe dhjami – janë të prira për prishje. Nëse njeriu do të ishte nga materiali tjetër, dmth. jo nga mishi dhe dhjami, nga një material që nuk i lejon trupat e huaj që të hyjnë në organizëm, si mikrobet apo bakteret, atëherë nuk do të kishte rast që të sëmurej. Sidoqoftë, mishi është “substancia” më e brishtë; priset dhe hahet nga krimbat nëse qëndron për një kohë në temperaturën e dhomës.

Si përkujtues i vazhdueshëm i Allahut, njeriu shpesh i ndien nevojat themelore të trupit të tij. P.sh nëse i ekspozohet motit të ftohtë, ai e rrezikon shëndetin; sistemi i imunitetit gradualisht “bie në kolaps”. Në rast të tillë, trupi i tij mund që mos ta mbajë temperaturën konstante të trupit (370C) që është fundamentale për shëndetin mirë¹. Zemra e tij ngadalëson të rrahurat, enët e gjakut tkurren dhe rritet shtypja e gjakut. Trupi fillon të dridhet me qëllim të arritjes së ngrohtësisë. Temperatura e trupit më e

zvogëluar se 35⁰C shoqërohet me zvogëlim të pulsit dhe tkurrje të enëve të gjakut në duar, këmbë dhe gishta, shenja për gjendje kërcënuese për jetë². Me këtë temperaturë njeriu mund të jetë edhe i çorientuar dhe vazhdimit flenë. Funkcionet mentale ngadalësohen. Një ulje e lehtë e temperaturës së trupit mund të shkaktojë pasoja të tilla, por ekspozimi më i gjatë në mot të lig, ku temperatura e trupit mund të bie nën 33⁰C, shkakton humbjen e vetëdijes. Në 24⁰C, sistemi i frymëmarrjes pushon së funksionuari. Truri dëmtohet në 20⁰C dhe në fund zemra ndalet në 19⁰C duke sjellë përfundimin e pashmangshëm: vdekjen.

Ky është vetëm një nga shembujt që do të përmenden në vazhdim të këtij libri. Qëllimi i tregimit të këtyre shembujve është tërheqja e vëmendjes se, për shkak të faktorëve të ndryshëm që rrezikojnë qenien e tij, njeriu gjithmonë do të dështojë në gjetjen e kënaqësive të thella në mënyrën e tij të jetës. Qëllimi është që të përkujtojmë lexuesin se njeriu duhet që të largohet lidhjes së verbër ndaj jetës dhe të ndalet nga vrapimi pas ëndrrave gjatë tërë jetës së tij, ndërsa në vend të kësaj, të ketë në mendje gjithmonë Allahun dhe jetën e vërtetë, ahiretin.

Kjo është parajsja e përjetshme që i është premtuar njeriut. Meqë lexuesit do të kenë rastin që të shohin në faqet vijuese, parajsja është vend i përsosmërisë. Në parajsë, njeriu do të jetë plotësisht i izoluar nga të gjitha dobësitë fizike dhe defektet që e rrethojnë në tokë. Çdo gjë që dëshiron do të jetë e pranishme. Bile, lodhja, etja, rrsakapitja, uria dhe lëndimi nuk ekzistojnë në parajsë.

Duke iu ndihmuar njerëzve që të kuptojnë natyrën reale dhe si rrjedhim të kenë kuptim më të thellë të superioritetit të pafund të Krijuesit është një qëllim tjetër i këtij libri. Përveç kësaj, kuptimi se njeriu ka nevojë për udhëzimin e Allahut me siguri i shkon çdo kujt për shtati. Allahu këtë e thotë në ajetin e mëposhtëm:

O ju njerëz, ju keni nevojë për All-llahun e All-llahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i falënderuari. (Fatir:15)

Kërkesat trupore

Njeriu është i ekspozuar ndaj shumë rreziqeve fizike. Mbajtja e trupit dhe ambientit pastër dhe përkujdesja për to janë barrë e rëndë gjatë jetës

me të cilat njeriu gjithmonë duhet të jetë i zënë ashtu që të minimizohen reziqet shëndetësore. Ajo që është edhe më e mundimshme është se koha e harxhuar për detyra të tilla është e konsiderueshme. Shpesh hasim hulumtime që janë kryer për të kuptuar se sa kohë shpenzohet për t'u rruar, pastrim të trupit, kujdes ndaj flokëve, kujdesi për lëkurë, manikyr etj. Rezultatet e këtyre hulumtimeve kanë qenë befases, e paraqesin se sa kohë të çmuar harxhohet për këto detyra të përditshme.

Gjatë jetës sonë, takojmë shumë njerëz. Në shtëpi, zyrë, në rrugë apo në shtëpi të mallrave, ne shohim shumë njerëz të veshur mirë në mënyrën e tyre më të mirë. Ata janë njerëz me fytyra të rruara, flokë dhe trup të pastër, këmisha të hekurosura, dhe këpucë të lustruara mirë. Sidoqoftë, kujdesi i tillë kërkon kohë dhe punë.

Menjëherë pas zgjimit nga gjumi në mëngjes e deri në kohën për të shkuar në gjumë, njeriu duhet që të kalojë rutina të panumërta që të mbahet i freskët dhe i pastër. Sapo të zgjohemi, vendi i parë që shkojmë është banja; gjatë natës goja merr erë dhe shije të pakëndshme nga përhapja e bakteleve në gojë, gjë që na detyron që menjëherë t'i pastrojmë dhëmbët. Mirëpo, për të qenë i gatshëm për ditën e re, gjerat esenciale nuk kufizohen në pastrimin e dhëmbëve. E as pastrimi i fytyrës dhe duarve nuk mjafton. Gjatë ditës, flokët bëhen të yndyrshme dhe trupi bëhet i papastër. Natën, gjatë ndonjë ëndrre nuk do të kemi mundësi që të mos djersitemi. Si mënyrë e vetme që t'i heqim qafe këto erëra të pakëndshme dhe djersën, ndihet nevoja e urgjente për të pastrimin e trupin. Përndryshe, nuk do të ishte e këndshme të shkohet në punë me flokë të yndyrshme dhe me erë të keqe nga trupi.

Diapazoni i materialeve që përdorën që të mbahet trupi i pastër ashtu që të takohemi pa problem me të tjerët është për befasi shumë i gjerë. Kjo është, padyshim, provë e mjaftueshme për nevojat e pafundme trupore. Përpos ujit dhe sapunit, neve na nevojiten elemente të shumta të domosdoshme që të pastrojmë trupin, si: shampon, kondicioner, pastën e dhëmbëve, pasta e dhëmbëve, shkopinj me majë pambuku, pudër për trup, krem për fytyrë, losione; dhe lista vazhdon. Ndryshe nga këto elemente, ekzistojnë edhe qindra prodhime tjera që zhvillohen nëpër laboratorë që të përmirësohet kujdesi trupor.

Si për kujdesin ndaj trupit, secili duhet të harxhojë një kohë të

konsiderueshme për pastrimin e rrobave, shtëpisë dhe mjedisit. Padyshim, nuk mund të mbahet trupi i pastër në ambientin e papastër.

Shkurtimisht, një pjesë të konsiderueshme të jetës sonë e kalojmë vetëm e vetëm për nevoja trupore. Përpos kësaj, na nevojiten edhe shumë materie kimike për këtë qëllim. Allahu e ka krijuar njeriun me shumë dobësi, bile Ai gjithashtu bën që këto dobësi të zhduken përkohësisht dhe kështu të mbetet në gjendje të mirë duke i bërë që njerëzit të jenë të pavetëdijshëm për këto dobësi. Përveç kësaj, njeriu është i pajisur me inteligjencë të mjaftueshme ashtu që të gjejnë edhe mënyrat më të mira për të fshehur këtë “dobësi”. Nëse e anashkalojmë aplikimin e këtyre metodave për të qenë të pastër dhe të freskët, shumë shpejt mundemi që të bëhemi të neveritshëm.

Përveç kësaj, njeriu nuk mund të mbetet i pastër për një kohë të gjatë. Pas disa orësh, nuk mbetet asgjë nga freskia që jep një dush; ne vetëm mundemi të mbetemi të pastër për një kohë relativisht të shkurtë. Ne duhet që të bëjmë dush së paku një herë në ditë. Në të njëjtën mënyrë, duhet që rregullisht t'i pastrojmë edhe dhëmbët, pasi bakteret shumë shpejt shumohen në gojë si në gjendjen e mëparshme. Një grua që kalon orë të tëra para pasqyrës vetëm për të vendosur grimin mbi fytyrë, kur zgjohet të nesërmen në mëngjes, nuk i mbetet asgjë nga grimin. Për më tepër, nëse nuk e largon grimin në mënyrë të duhur, fytyra e saj mund të duket edhe më e shëmtuar nga mbetjet e kozmetikës. Burri duhet të rruhet çdo mëngjes për të pasur fytyrën e pastër.

Është me rëndësi që të kuptohet se të gjitha këto nevoja janë të krijuara për një qëllim specifik. Një shembull e bën këtë çështje të qartë: kur rritet temperatura e trupit, djersitemi. Era që e përcjell djersitjen është shqetësuese. Ky është proces i pashmangshëm për çdonjërin në këtë botë. Sidoqoftë, po të mos ishte kjo nevojë! P.sh., bimët nuk djersiten. Trëndafil kurrë nuk kundërmon edhe pse jeton në dhé, ushqehet me pleh dhe gjendet në rrethinë të ndytë dhe me pluhur. Në të gjitha këto kushte, ka një aromë të këndshme. Ne nuk duhet as të theksojmë se nuk i nevojitet ndonjë kujdes trupor! Sidoqoftë, pa marrë parasysh se çfarë preparate kozmetike vendosen në lëkurë, vetëm disa njerëz mund të arrijnë aromë të tillë të vazhdueshme.

Përveç të gjitha nevojave të trupit për higjienë, edhe ushqimi është kusht thelbësor për shëndet. Është një baraspeshë e ndjeshme e proteinave, karbohidrateve, sheqernave, vitaminave dhe mineraleve tjera të ndryshme qenësore për trupin e njeriut. Posa të dëmtohet kjo baraspeshë, mund të shkaktohen dëmtime serioze në sistemet trupore: sistemi i imunitetit e humb aftësitë e veta mbrojtëse, duke e lënë trupin të dobët dhe të ekspozuar ndaj sëmundjes. Prandaj, duhet pasur kujdes të njëjtë i për kujdesin trupor ashtu edhe për ushqim.

Një nevojë edhe më thelbësor për jetën, natyrisht, është uji. Njeriu mund të mbijetojë pa ushqim për një kohë të caktuar, por vetëm disa ditë pa ujë do të përballej me pasoja fatale. Të gjitha funksionet kimike të trupit bëhen me ndihmën e ujit; pra uji është faktor i domosdoshëm për jetën e njeriut.

Njeriu nga shembujt e lartpërmendur shumë lehtë mund t'i vërejë dobësinë e trupit të vet. Por prapë shtrohet pyetja: a jemi të gjithë të vetëdijshëm se këto janë dobësi? Nga ana tjetër, a mendojmë që këto janë veti “natyrale” meqë njerëzit në tërë botën kanë dobësi të tilla? Sidoqoftë, duhet pasur në mendje se Allahu ka mundur që të krijojë njeriun të përsosur dhe pa asnjërin nga këto dobësi. Secili njeri ka mundur të jetë i pastër sikurse aroma e trëndafililit. Megjithatë, mësimet e nxjerra nga gjendja e tillë eventualisht shpijnë na mençuri, duke na thirrur që të qartësojmë mendjet dhe vetëdijen; e njeriu, duke i parë dobësitë e tij në praninë e Allahut, duhet të kuptojë arsyen e krijimit të tij dhe të mundohet që të jetojë një jetë të ndershme si shërbëtor i Allahut.

Pesëmbëdhjetë vite pa “vetëdije”

Çdokush duhet të kalojë një kohë të caktuar ditore për fjetje. Pa marrë parasysh se sa ka punuar ose sa është përpjekur që të mënjanojë atë, është e paevitueshme se njeriu do të flejë dhe të qëndrojë në shtrat së paku një të katërtën e jetës së tij. Kështu që brenda një dite njeriu është i vetëdijshëm vetëm 18 orë; dhe pjesën tjetër të kohës – minimum 6 orë mesatarisht në ditë- i kalon në pavetëdije të plotë. Kur të vlerësohet nga ky këndvështrim, vijmë deri tek fakti: se një e katërta e 60 viteve kalohen në pavetëdije të plotë.

A kemi ndonjë alternativë tjetër ndaj gjumit? Çfarë do t'i ndodhë ndonjërit nëse do të thoshte, "Nuk dua të flejë?"

Së pari, sytë e tij bëhen të kuq dhe ngjyra e lëkurës zbehet. Dhe nëse vazhdohet me pagjumësi, si rezultat vjen humbja e vetëdijes.

Mbyllja e syve dhe paaftësia për tu përqendruar janë fazat e para të gjumit. Ky është një proces i paevitueshëm, pa marrë parasysh a është njeriun i bukur apo i shëmtuar, i pasur apo i varfër, të gjithë e përjetojnë procesin e njëjtë.

Ngjashëm me vdekjen, para gjumit, trupi fillon të bëhet i pandjeshëm ndaj botës së jashtme dhe nuk i përgjigjet asnjë ndikimi. Shqisat që ishin të jashtëzakonisht të mprehta më përpara fillojnë të dobësohen. Ndërkohë, perceptimet ndryshojnë. Trupi i zvogëlon të gjitha funksionet në minimum, duke shkuar në çorientim në kohë e vend dhe zvogëlon lëvizjet trupore. Kjo gjendje është, në njëfarë mënyre, formë tjetër e vdekjes, që definohet si gjendje kur shpirti lëshon trupin. Në të vërtetë, gjatë gjumit trupi është i shtrirë në shtrat ku shpirti përjeton krejtësisht jetë tjetër në vende krejtësisht tjera. Në ëndërr, njeriu mund të shoh veten në plazh nën diellin e ngrohtë, pa e kuptuar se gjendet i shtrirë në krevat. Edhe vdekja ka pamje të njëjtë nga jashtë: ajo ndan shpirtin nga trupi që e ka përdorur në këtë botë dhe e dërgon atë në botën tjetër dhe në trup tjetër. Për këtë arsye, Allahu në Kur'an, shpalljen e vetme që ka mbetur autentike, i udhëzon njerëzinë në rrugë të drejtë, vazhdimisht na përkujton për ngjashmërinë e gjumit me vdekjen.

Ai është që ju vë në gjumë natën dhe e di çka vepruat ditën, pastaj ju ngjall-zgjon në të (ditën) për deri në afatin e caktuar (vdekje). Pastaj do të ktheheni e do t'ju njoftojë me atë që keni pas vepruar. (Enam:60)

All-llahu i merr shpirtat kur është momenti i vdekjes së tyre (i vdekjes së trupave të tyre), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur, e atij që i është caktuar vdekja e mban (nuk e kthen), e atë tjetrin (që nuk i është caktuar vdekja, por është në gjumë), e lëshon (të kthehet) deri në afatin e caktuar. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon. (Zumer;42)

I izoluar në tërësi nga funksioni i shqisave, me fjalë tjera, "në alivanosje të vdekur", njeriu kalon një të tretën e jetës së vet në gjumë. Sidoqoftë, ai pak mendon për këtë fakt, duke mos e kuptuar kurrë se ai i len pas të

gjitha ato që janë menduar si të rëndësishme në këtë botë. Një shembull i rëndësishëm, shuma të mëdha të të hollave të humbura në burza apo një problem i vogël personal, shkurtimisht çdo gjë që duket të jetë e një rëndësie të veçantë shuhet kur të njeriu bie në gjumë. Kjo thjeshtë dmth. të mos ketë asnjë marrëdhënie me botën.

Të gjithë shembujt që u treguan deri më tani japin një pikturë të qartë mbi shkurtësinë e jetës dhe sasinë e madhe të kohës që duhet shpenzuar në punë “të detyrueshme” ditore. Kur koha që kalohet në punë “të detyrueshme” ditore zbritet, njeriu kupton pamjaftueshmërinë e momenteve që mbesin për të ashtuquajturat kënaqësitë e jetës. Në prapavështrim, njeriu çuditet pa masë me kohën që e kalon në ushqim, kujdes trupor, gjumë, apo duke punuar që t'i sigurojë vetes standard më të lartë jetese.

Llogaritë e kohës së kaluar në punët rutine që nevojiten për mbijetesë janë, pa dyshim, gjëra që duhet vrarë mendjen për to. Siç u tha më parë, së paku 15-20 vjet të një jete 60-vitesh kalohen në gjumë. Sidoqoftë, 5-10 vitet e para të jetës kalojnë në fëmijëri të 40-45 viteve të mbetura, një periudhë tjetër që shpenzohet gjithashtu në gjendje gati të pavetëdijshme. Me fjalë tjera, një njeri 60 vjeçar do të kalojë ndoshta gjysmën e jetës pa vetëdije. Sa i përket pjesës tjetër të jetës, janë të njohura shumë statistika. Këto shifra, p.sh, përfshijnë kohën e kaluar gjatë përgatitjes së ushqimit, gjatë ngrënies, gjatë dushit apo koha e kaluar në tollovitë në trafik. Kjo listë mund të zgjerohet edhe më tej. Në përfundim, çfarë mbetet nga jeta “e gjatë” janë vetëm 3-4 vite. Çfarë është rëndësia e kësaj jete kaq të shkurtë në krahasim me jetën e përhershme?

Tamam tek kjo pikë ekziston një humnerë e madhe në mes të atyre që janë besimtarë dhe jobesimtarët. Jobesimtarët, duke besuar vetëm në jetën e kësaj bote, mundohen që atë ta shfrytëzojnë maksimalisht. Por janë përpjekje të kota: kjo botë është e shkurtë dhe e krijuar me “dobësi”. Për më tepër, pasi jobesimtari nuk beson në Allahun, ai jeton një jetë plot probleme, me plot brenga dhe frikë.

Ata të cilët besojnë, nga ana tjetër, jetojnë jetën duke përkujtuar Allahun dhe praninë e Tij në çdo moment, gjatë të gjitha preokupimeve të vogla apo problematike të përkujdesjes trupore, ngrënies, pirjes, qëndrimit në

këmbë, qëndrimin ulur, gjumit, kërkimit të idares etj., Ata i kalojnë jetët e tyre vetëm që të fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe në atë mënyrë jetojnë një jetë të rehatshme, të izoluar tërësisht nga frika dhe hidhërimet e kësaj bote. Si përfundim, ata fitojnë parajsën, një vend i lumturisë së përhershme. Në të njëjtën mënyrë, qëllimi përfundimtar i jetës është kumtuar në ajetin që vijon:

Atyre që patën frikë nga (dënimi) All-llahu, u thuhet: “Ç’është ajo që shpalli Zoti juaj?” Ata thoshin: “Shpalli çdo të mirë!” Ata që bënë vepra të mira, edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshmëve. Është Xhenneti i Adn-it, ku do të hyjnë, nën të rrjedhin lumenj, aty kanë çka të dëshirojnë, ashtu i shpërblen All-llahu të ruajturit. (Nahl: 30-31)

Sëmundja dhe fatkeqësitë

Edhe sëmundja e përkujtojnë njeriun se sa i dobët është ai. Trupi, edhe pse shumë i mbrojtur kundër të gjitha llojeve të kërcënimeve nga jashtë, seriozisht ndikohet nga viruset e thjeshtë, agjentë të padukshëm që shkaktojnë sëmundje. Ky proces duket i paarsyeshëm, pasi Allahu e ka pajisur trupin me sisteme shumë komplete, posaçërisht sistemin e imunitetit që mund të përshkruhet si “armatë fitimtare” kundër armiqve të vet. Sidoqoftë, përkundër forcës dhe mbrojtjes së trupit, njerëzit shpesh sëmurën. Ata shumë pak mendojnë për faktin se janë të pajisur me aq sisteme të shkëlqyeshme. Allahu ka mundur që mos t’i lejojë këta agjentë që shkaktojnë sëmundje të shkaktojnë vuajtje. Viruset, mikrobet dhe bakteret kanë mundur që kurrë mos të na dëmtojnë trupin tonë, apo këta “armiq” të vegjël nuk kishin ekzistuar ndonjëherë. Sidoqoftë, ende edhe sot, çdokush mund të jetë objekt i sëmundjeve serioze që vijnë nga shkaqet e pakuptimta. P.sh., vetëm një virus mund të hyj në trup nëpërmes një prerje të lehtë në lëkurë dhe për një kohë të shkurtë të shpërndahet nëpër tërë trupin, duke marrë nën kontroll organet vitale. Edhe përkundër teknologjisë së lartë, një grip i thjeshtë mund të kërcënojë jetën e një numri të madh njerëzish. Shpesh historia ka qenë dëshmitare e rasteve të gripit që ka ndryshuar edhe strukturën demografike të ndonjë vendi. P.sh., më 1918, 25 milion njerëz kanë vdekur nga gripin. Ngjashëm, më 1995, një epidemi

ka marrë jetën e 30 mijë njerëzve, ku humbjet më të mëdha ka pasur Gjermania.

Edhe sot rreziku vazhdon: një virus mund të godet çdo kohë dhe mund të jetë kërcënues për jetën e çdokujt, apo ndonjë sëmundje e rrallë mund të rishfaqet prapë pas gati 20 vjetësh. Të pranuarit e këtyre fatkeqësive si natyrale dhe mos mendimi për to do të ishte një gabim serioz. Allahu iu dërgon njerëzve sëmundje për qëllim të veçantë. Në këtë mënyrë ata që janë arrogantë mund të gjejnë rastin që të kuptojnë shtrirjen e fuqisë së tyre të vërtetë. Përveç kësaj, kjo është mënyrë e mirë që të kuptohet natyra e vërtetë e kësaj jete.

Përpos sëmundjeve, aksidentet paraqesin kërcënim serioz për njeriun. Çdo ditë gazetatat kanë tituj të shumtë lidhur me fatkeqësitë e komunikacionit. Edhe aksidentet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të lajmeve televizive dhe të radios. Përkundër faktit se jemi të njohur me aksidentet, neve kurrë nuk na bie ndërmend se në çdo moment mund të përballemi me aksident. Ekzistojnë mijëra faktorë rreth nesh që mundën lehtë të na e ndërrojnë rrjedhën e jetës sonë. Ndonjëri mund të humb balancimin dhe të rrëzohet në mes të rrugës, për shembull. Gjakderdhja në tru apo thyerja e këmbës mund të ndodhin në një aksident të tillë të zakonshëm, apo duke ngrënë darkë, nga hala e peshkut në fyt ndonjërit mund të mbytet. Shkaqet mund të duken të thjeshta, por çdo ditë me mijëra njerëz në botë përjetojnë aksidente siç janë këto që vështirë imagjinohen.

Këto fakte duhet na bëjnë të kuptojmë kotësinë e përkushtimit ndaj kësaj bote dhe të konkludojmë se çdo gjë që na është dhënë është një e mirë e përkohshme për të na sprovuar në këtë botë. Është e pakuptueshme se si qenia njerëzore, ende është e paaftë që të luftojë një virus të padukshëm, guxon që të shfaq arrogancë ndaj Krijuesit të tij të Plotfuqishëm.

Padyshim, Allahu është Ai që e ka krijuar njeriun dhe Ai është i Vetmi që mund ta mbrojë atë nga të gjitha rreziqet. Në këtë aspekt, aksidentet dhe sëmundjet na tregojnë se kush jemi. Pa marrë parasysh se sa i fuqishëm dikush mund të mendojë se është, përpos me vullnetin e Allahut, askush nuk mund të parandalojë asnjë sëmundje të mos ngjajë. Allahu i krijon të gjitha sëmundjet dhe situatat tjera për të përkujtuar njeriun për dobësitë e njeriut.

Kjo botë është vend sprove për njeriun. Çdokush mban përgjegjësinë për përpjekjet e veta që të fitojë kënaqësinë e Tij. Në fund të këtij testi, ata që kanë pasur njohuri të qartë unitare për Allahun pa i përshkruar Atij shok dhe nënshtrimin të urdhrave dhe ndalesave të Tij do të banojnë përgjithmonë në parajsë. Ata që nuk e ndërrojnë arrogancën e tyre dhe preferojnë këtë botë dhe dëshirat e tyre atëherë ata do të humbin jetën e përhershme të gëzimit e të lehtësive dhe si këmbim do të kenë vuajtjen e përjetshme dhe kurrë nuk do të jenë të lirë nga problemet, dobësitë dhe dhimbjet në këtë si dhe në botën tjetër.

Pasojat e sëmundjeve dhe fatkeqësive

Siç është thënë më parë, sëmundja dhe aksidentet janë ngjarje me të cilat Allahu e sprovon njeriun. Besimtari që përballet me ndodhi të tillë menjëherë i kthehet Allahut, duke u lutur dhe duke kërkuar strehim tek Ai. Ai është mirë i njoftuar se asgjë dhe askush përpos Allahut nuk mund ta shpëtojë atë nga pikëllimi. Gjithashtu ai është i vetëdijshëm se durimi, devotshmëria dhe besimi i tij në Allahun janë hedhur në sprovë. Në Kur'an, profeti Ibrahim (a.s.) lavdërohet për qëndrimin e tij shembullor. Lutja e tij e sinqertë është ajo që duhet përsëritet nga të gjithë besimtarët. Kështu tregohet në Kur'an:

“... Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pijë, Dhe kur të sëmurem Ai më shëron, Ai më bën të vdesë e mandej më ngjall.” (Shu'ara:79-81)

Profeti Ejub (a.s.), nga ana tjetër, ka vënë një shembull të mirë për të gjithë besimtarët meqë ai vetëm ka kërkuar durim nga Allahu kur u përball me sëmundje të rëndë:

**Përkujto edhe robin tonë Ejubin, kur me lutje iu drejtua Zotit të vet:
“Djali më ka goditur me mundim e dhembje!” (Sad:41)**

Fatkeqësitë e tilla forcojnë besnikërinë e besimtarëve ndaj Krijuesit të tyre dhe i përforcon ata në pjekuri. Kjo është arsyeja pse secila vuajtje është “fat”. Jobsimtarët, nga ana tjetër, i kuptojnë të gjitha llojet e aksidenteve dhe sëmundjeve si “fatkeqësi”. Duke mos e kuptuar se çdo gjë është krijuar me qëllim të veçantë dhe se durimi i shfaqur gjatë problemeve do të shpërblehet në ahiret, jobsimtarët bien në pikëllim të madh. Në të vërtetë, meqë në sistemin e bazuar në mohimin e ekzistencës së Allahut

njerëzit përvetësojnë pikëpamje materialiste, atyre që nuk besojnë sëmundjet dhe aksidentet u sjellin pikëllime shtesë. Vlerat morale dhe pikëvështrimet e shoqërisë materialiste diktojnë se pas aksidentit ose sëmundjes çfarë ata kryesisht përjetojnë është vetëm humbje e papritur e “shokëve” të ngushtë edhe nëse ata nuk kanë vdekur. Qëndrimi i tillë merret thjeshtë meqë ata mendojnë se me qenë shok me dikë apo kujdesi ndaj të vuajturit është problem. Pa marrë parasysh se sa dashuri dhe kujdes ai ka dhënë “ në ditët e veta”, posa të sëmuret ndonjëri - i dergjuri për shembull- apo i paafti, e tërë dashuria e ndjerë për të humbet. Një arsye tjetër që i bën njerëzit të ndërrojnë është humbja e pamjes apo e aftësive të caktuara. Kjo pritet nga një shoqëri materialiste, pasi në shoqërinë e tillë, njerëzit i vlerësojnë të tjerët sipas vetive të tyre fizike. Si pasojë, kur shfaqen defektet fizike, edhe vlera e atij personit humbet.

Për shembull, gruaja apo i afërmi i ndonjë personi me të meta fizike, menjëherë fillon të ankohet për vështirësitë e kujdesit ndaj personit të paaftë. Zakonisht ata ankohen se sa të pafat janë. Shumica e tyre thonë se ata ende janë shumë të rinj e janë duke u përballuar me fatkeqësi të tillë, çfarë nuk e kanë merituar. Kjo është vetëm një vetë-arsyetim pse ai ose ajo nuk i kushton kujdes të duhur të afërmit të vet të me të meta. Disa, nga ana tjetër, i ndihmojnë të paaftin apo pacientin nga frika se dikush mund të thotë diçka nëse i lënë vetëm. Thashethemet, që zakonisht lehtë



Gusha



Herpesi



Urtikaria

Sëmundjet, sikur ato që janë të ilustruara këtu, shpesh janë provë nga Allahu. Fatkeqësitë e tilla janë raste të rralla për besimtarët që të shfaqin durimin dhe devotshmërinë ndaj Allahut. Sidoqoftë, ata që e kufijtë e të menduarit i kanë brenda kësaj bote vështirë që e kuptojnë këtë fshehtësi esenciale.

përhapen, thjeshtë i largon nga sjellja e tillë. Në kohët e të tilla të fatkeqësive premtimet e dhëna për besnikëri gjatë ditëve të lumtura papritmas zëvendsohen me ndjenja vetjake, egoiste.

Fatkeqësitë e tilla nuk duhet që të na befasojnë në shoqërinë ku disa forma të sjelljes, siç është besnikëria, shfaqen vetëm kur ekziston përfitimi nga ta. Padyshim, në një shoqëri ku është vendosur mirë kriteri materialist dhe çfarë është më e rëndësishme, ku njerëzit nuk i frikohen Allahut, është e pamundur që të pritet nga dikush të mbetet besnik ndaj dikujt tjetër pa çmim. Pas të gjithave, nuk mund të presim që dikush të jetë i sinqertë dhe i ndershëm ndaj të tjerëve nëse ai nuk beson se do të dënohet për dështim që nuk ka vepruar ashtu ose për shpërblimin që ka punuar. Sjellja e tillë në shoqërinë materialiste besohet të jetë sjellje “idiotësie”. Kjo është për shkak se nuk ka kuptim në tregimin e besnikërisë ndaj dikujt që kur vdes ndoshta pas disa dekadave, përgjithmonë pushon së ekzistuari. Duke konsideruar situatën në një sistem që të dy palët janë të bindura se do të jetojnë shkurtë e do të vdesin, mentaliteti i tillë është i arsyeshme. Pse, atëherë, të mos preferojnë mënyrën më të lehtë dhe më të përshtatshme për t’i bërë gjërat?

Sidoqoftë, faktet qëndrojnë ndryshe. Ata që besojnë në Allahun, të cilët, në praninë e Tij, janë të vetëdijshëm për dobësitë e tyre dhe i frikohen Atij, i vlerësojnë njerëzit tjerë në mënyrë siç Allahu dëshiron t’i vlerësojnë. Vetia më e çmuar e një personi që është në prani të Allahut është frika dhe respekti i tij, e kështu, sjelljet e tyre fisnike vijnë nga këto karakteristika. Nëse dikush i frikohet Allahut shfaq përsosmëri morale në këtë botë, ai do të arrijë përsosmërinë fizike dhe mentale për gjithë kohën. Duke ditur këtë fakt defektet fizike të kësaj bote e humbin tërë rëndësinë. Ky është premtim i Allahut dhënë besimtarëve. Kjo është edhe arsyeja themelore pse besimtarët shfaqin respekt dhe dhembshuri ndaj njeri tjetrit dhe konsideratë për personat me të meta fizike të njeri tjetrit, dhe demonstrojnë përkushtim të përgjeshme ndaj njëri tjetrit.

Ky hendek i madh në perceptim në mes të besimtarëve dhe jobesimtarëve si dhe gjendjet e ndryshme shpirtërore që ata përjetojnë është mjaft e rëndësishme. Kur zilia dhe zemërimi të largohen nga zemra e besimtarëve dhe zëvendësohen me qetësi dhe siguri; ndjenjat e zhgënjimit, pakënaqësisë dhe hidhërimit krijojnë gjendje të zymtë

shpirtërore për jobesimtarët. Kjo është sikur të ishte dënim nga shoqëria materialiste që i rrethon jobesimtarët, por në të vërtetë është një fatkeqësi nga Allahu për ata që nuk besojnë. Ata që supozojnë se nuk do të gjykohen për veprat e tyre të këqija, do të habiten në ditën e gjykimit kur veprat e tyre, egërsia, mosbesimi, dhe jo-besnikëria – do të gjykohen:

Të mos mendojnë ata që nuk besuan se afatin që u dhamë Ne atyre të jetojnë, është në dobi të tyre. Ne i lamë të jetojnë vetëm që shtojnë edhe më shumë mëkate, se ata i pret dënim nënçmues. (Ali-Imran:178)

Vitet e vonshme të jetës

Efektet shkatërruese të kalimit të vjetëve mund të vërehen edhe në trupin tonë. Me kalimin e vjetëve, trupi, gjëja më e vlershme që qenia njerëzore ka, kalon nëpër një proces të pakthyeshëm të shkatërrimit. Ndryshimet që trupi i njeriut përjeton gjatë jetës tregohen në Kur'an me sa vijon:

All-llahu është Ai që ju krijoi në gjendje të dobët, pastaj pas asaj dobësie ju dha fuqi, e pas fuqisë, dobësi e pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijsلمي, më i fuqishmi. (Rum:54)

Vitet e vonshme të jetës janë kohërat që më së shumti shpërfillen në planet e ardhmërisë së një të rrituri, përpos procesit shqetësues për kursimin për pleqëri. Në të vërtetë, duke qenë aq afër vdekjes, njerëzit ngurrojnë qasjen ndaj kësaj etape jetësore. Kur dikush dëshiron që të flasë për pleqëri, tjerët ndihen të brengosur dhe mundohen që të ndërrojnë këtë temë “të pakëndshme” sa më shpejt. Përditshmëria e jetës është mënyrë e mirë që t'i iket mendimit me vitet më të mjera të mundshme të jetës. Prandaj, shtyhet deri në kohën kur në mënyrë të pashmangshme përballet me pleqërinë. Padyshim, arsyeja kryesore për shmangie të tillë është supozimi se njeriu ka kohë të pakufishme deri sa të vjen vdekja. Ky moskuptim i rëndomtë sqarohet në Kur'an:

Por Ne u dhamë atyre dhe prindërve të tyre jetë të gjatë me kënaqësi (e ata u mashtruan)... (Enbija:44)

Ideja e gabuar shpesh dërgon në pikëllim të madh. Kjo është për shkak se, pa marrë parasysh moshën, e vetmja gjë që njeriu ka janë kujtimet e zbehta të ditëve të kaluara. Njeriu mezi kujton fëmijërinë. Është shumë vështirë bile të kujtohen gjërat nga dekada e kaluar. Ambiciet e mëdha të



një të riu, vendimet e rëndësishme, dhe caqet që ai i ka arritur, humbin rëndësinë e vet kur njëherë përjetohen dhe arrihen. Për këtë shkak tregimi për një jetë “të gjatë” është përpjekje e kotë.

Qoftë tinxher apo i rritur, kjo duhet nxis njeriun që të merr vendim të rëndësishëm për jetën e tij. P.sh, nëse je në të 40-tët dhe pret që të jetosh deri në vitet e mesme të 60-tave – çka nuk e ke të garantuar – 25 vjetët e mbetura do të kalojnë sigurisht shumë më shpejt sa 40 vjetët e kaluara. E njëjta gjë vlen edhe nëse jeta zgjatet për disa vjet, ato do të kalojnë bile, para se t'i vësh. Kjo është, sigurisht, përkujtues i përhershëm i natyrës së vërtetë të kësaj bote. Një ditë secili

shpirt në këtë botë do ta lë këtë botë dhe nuk do të ketë kthim prapa.

Prandaj, njeriu duhet që të lë anash paragjykimet e tij dhe të jetë më real sa i përket jetës së tij. Koha shumë shpejt kalon dhe secila ditë sjell dobësi të reja fizike e të menduar të dobët, se sa dinamizëm të freskët e figurë më të re. Shkurtimisht, plakja është manifestim i paaftësisë së njeriut që të kontrollojë trupin, jetën dhe fatin e tij. Efektet armiçësore të kohës në trup bëhen më të dukshme në këtë periudë. Allahu na informon për këtë në ajetin vijues:

All-llahu ju krijoi, pastaj Ai ua merr shpirtin. E ka prej jush që shtyhet deri në jetën më të vjetër, ashtu që të mos dijë asgjë nga çka ka ditur. All-llahu është më i dijsلمي, më i fuqishmi. (Nahl: 70)

Në mjekësi, perioda e pleqërisë së vonë emërohet edhe si “fëmijëria e dytë”. Prandaj, gjatë kësaj faze të jetës, njerëzit në moshë kanë nevojë për kujdes sikur fëmijët, pasi funksionet e tyre mentale dhe trupore kalojnë nëpër modifikime.

Gjatë plakjes së njeriut, karakteristikat shpirtërore dhe fizike që shfaqen në fëmijëri bëhen më të dukshme. Njerëzit e vjetër nuk mund të kryejnë shumë detyra ku lypset fuqia fizike. Ndryshimet në gjykim, të menduarit e dobët, vështirësi në të ecur, vështirësi në mbajtje të drejtpeshimit dhe bisedës, pengesat të ndryshme, të kujtuarit e dobët dhe humbje graduale

të memories, ndryshimet në disponim dhe sjellje janë vetëm disa nga simptomat e sëmurjeve që zakonisht vërehen në pleqëri.

Shkurtimisht, pas një kohe të caktuar, njerëzit shpesh kthehen sikurse në gjendjen e vartësisë fëmijërore si nga aspekti fizik ashtu edhe nga aspekti mendor.

Jeta fillon dhe mbaron sikur në gjendje fëmijërore. Ky nuk është proces i rastësishëm. Është e mundur që njeriu të mbetet i ri gjer në vdekje. Prandaj Allahu përkujton njeriun për natyrën e përkohshme të kësaj bote me keqësimin e cilësisë së jetës së tij në periodat e caktuara të jetës. Ky proces shërben si përkujtues i qartë se jeta kalon shumë shpejt. Allahu sqaron këtë çështje në ajetin e mëposhtëm:


O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë (mendoni krijimin tuaj që) Ne u krijuam ju prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej një sa kafshatë mishi, që është krijesë e formuluar ose e paformuluar, në mënyrë që t'ju sqarojmë. Ndërsa atë që e dëshirojmë Ne e përqendrojmë në mitër deri në një afat të caktuar, e mandej u nxjerrim foshnje dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj. Ka që dikush prej jush vdes herët, e dikush të jetojë deri në pleqëri të thellë, në mënyrë që të mos dijë asgjë nga dija që ka pasur. E ti e sheh tokën e thatë-të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të këndshme. (Haxhxh:5)

Problemet fizike të pleqërisë


Pa marrë parasysh se sa të holla keni apo sa i shëndetshëm jeni, çdokush do të përballet me problemet që kanë të bëjnë me pleqërinë, disa prej të cilave janë sqaruar më poshtë:

Lëkura është vërtetë faktor i rëndësishëm në vlerësimin se si dikush duket. Është një komponentë thelbësore e bukurisë. Kur largohet vetëm disa mm² të indit, njeriu vjen në përfundim të shpejtë që njerëzit e dobët shqetësohen. Kjo është vetëm për shkak se, lëkura përpos që ofron mbrojtje nga ambienti i jashtëm, gjithashtu siguron edhe pamje estetike dhe të këndshme të trupit. Kjo, padyshim, është funksion i rëndësishëm për lëkurë. Fundi i fundit, nëse dikush mendon se është i bukur, kjo është kryesisht për shkak të lëkurës, një copë indi lëkuror që është e rëndë 2 kg,

(Lartë) Jeanne Calment, femra më e vjetër franceze.



Ndërmjet këtyre dy fotografive ekziston një shekull i tërë. (Në mes) Naty Revuelta, në rini dhe pleqëri.



(Poshtë) Çdokush përjeton ndryshimet sikur në këto foto. Procesi i plakjes është dëshmia më e qartë se ne jemi duke jetuar në një botë të përkohshme. Njeriu lind, rritet plaket dhe vdes. Sidoqoftë, vetëm trupi përjeton këtë proces të pakthyeshëm. Shpirti, nga ana tjetër, jeton përgjithmonë.



mbulon trupin. Bile për çudinë e dikujt ky është organi i vetëm i cili dëmtohet dukshëm gjatë pleqërisë.

Kur njeriu mplantet, lëkura humb strukturën e vet elastike meqë proteinat strukturalë që e formojnë “skeletonin” e shtresave fundore të saj bëhen të ndjeshme dhe të dobëta. Kjo është arsyeja pse rrudhat dhe vijat, ankth për shumë njerëz, paraqiten në fytyrë. Funkcionimi i gjëndrave yndyrore në shtresën e sipërme të lëkurës zvogëlohet, duke krijuar thatësi akute. Me kohë, trupi i ekspozohet ndikimeve të jashtme pasi përshkueshmëria e lëkurës rritet. Si rezultat i këtij procesi, pleqtë lëngojnë seriozisht nga gjumi i çrregulluar, plagë sipërfaqësore dhe nga kruarja që quhet “kruarja e pleqërisë”. Në të njëjtën mënyrë, dëmtimet bëhen deri te shtresat e poshtme e lëkurës. Përtërirja e indeve të lëkurës dhe mekanizmat për këmbimin e substancave nuk funksionojnë aq sa duhet, duke bërë kështu një terren për zhvillimin e tumoreve.

Forca e eshtrave është gjithashtu e një rëndësie të madhe për trupin e njeriut. Përpjekjet që të arrihet qëndrim vertikal rrallë do të jetë i mundur tek pleqtë, çfarë është shumë e lehtë për të riun. Duke lëvizur me trup të

kërrusur, njeriu humb atë krenarinë dhe arrogancën, duke i dhënë një mesazh të fortë se nuk ka aftësi bile as trupin e vet ta ketë nën kontroll. Prandaj, kjo është gjithashtu një humbje për “pamjen dhe hijeshinë”.

Simptome e pleqërisë nuk janë vetëm këto. Pleqtë kanë afinitet që të humbin ndjenjat meqë qelizat nervore pushojnë së regjeneruari pas një kohe të caktuar. Pleqtë lëngojnë nga çorientimi hapësinor për shkak të dobësisë së syve në reagim ndaj intensitetit të dritës. Kjo është shumë e rëndësishme pasi tregon kufizimin e shikueshmërisë së syrit: theksueshmërisë së ngjyrave, pozitës së objekteve dhe madhësitë e tyre mjegullohen. Këto, pa dyshim, janë situata të vështira që pleqtë duhet t’iu përshtaten.



Kjo plakë e mban në dorë një fotografi të saj kur ka qenë e re.

Njeriu ka mund që kurrë të mos e përjetojë shkatërrimin fizik të pleqërisë: ai thjesht ka mund të forcohet dhe të bëhet më i shëndetshëm me kalimin e kohës. Pasi nuk njohim ndonjë rast të tillë, të jetuarit e një jete të gjatë ka mund të ofrojë mundësi të pashembullt për jetët e plotësuar personale dhe shoqërore. Koha ka mund të ketë përmirësuar kualitetin e jetës, duke e bërë më të hareshme se ndonjëherë. Mirëpo, sistemi i përcaktuar si i mirë për njerëzimin është i bazuar në rënien e kualitetit të jetës me kalimin e kohës.

Kjo është edhe një dëshmi për natyrën e përkohshme të kësaj bote. Allahu çdoherë na përkujton për këtë fakt në Kur'an dhe i urdhëron besimtarëve të mendojnë për të:

Shembulli i jetës së kësaj bote është si i një shiu që e kemi zbritur nga qielli, e me anën e të cilit gërshetohen bimët e tokës (mbijnë dhe shpeshetohen të gjitha llojet) prej nga hanë njerëzit e kafshët deri kur toka të ketë marrë stolinë e vet dhe të jetë zbukuruar (me bimë, pemë e behar), e banorët e saj të mendojnë se janë të zotët e saj, e asaj i vjen urdhri ynë, natën ose ditën, Ne e bëjmë atë (të mbjellat) të korrur sikurse të mos ekzistonte dje. Kështu Ne u sqarojmë faktet njerëzve që mendojnë. (Junus:24)

Pas një kohe të caktuar të jetës gjatë së cilës njeriu supozon se është fizikisht dhe mentalisht i fortë dhe e percepton tërë botën përmes pikëvështrimit të tij, ai papritmas kalon në një etapë ku humbë shumë gjëra që ai më parë kënaqej me to. Ky proces është i paevitueshëm dhe i pakthyeshëm. Kjo është vetëm për shkakun se Allahu e ka krijuar këtë botë si vend të përkohshëm për të jetuar në të dhe e bëri të papërsosur që të na shërbej si përkujtues të ahiretit.

Mësimet e nxjerra nga plakja e personave të famshëm

Plakja është e pashmangshme. Askush, pa përjashtim, nuk mund t'i ikë. Duke parë personat e famshëm se si plaken ka ndikim të madh tek ne, meqë dëmtimi i tyre fizik është i dukshëm. Duke qenë dëshmitar për plakjen e njerëzve të njohur për nga fama, pasuria dhe bukuria e tyre, sigurisht është përkujtues për shkurtësinë dhe të parëndësinë e kësaj jete.



Brigitte Bardot



Marlon Brando



Katharine Hepburn



Fred Astaire






Charlie Chapline



Jane Russel



Kirk Douglas



Audrey Hepburn





Alain Delon



Elisabeth Taylor



Tony Curtis



Lana Turner





Rita Hayworth



Frank Sinatra



Bette Davis



Çdo ditë mund të shihet ky fakt nga qindra shembuj përreth nesh. Një person inteligjent, i shëndoshë dhe i famshëm, dikur simbol i bukurisë ose suksesit, një ditë del në gazetë, revistë dhe në televizion me aftësi të kufizuara fizike ose mentale. Ky është përfundim i pothuaj të gjithëve. Sidoqoftë, njerëzit e popullarizuar kanë vend të posaçëm në mendjen tonë; mënyra se si ata plaken dhe humbin sharmin na e rëndon edhe më shumë mendjen. Në faqet në vijim, do të shihni fotografitë e disa njerëzve të popullarizuar. Secila foto është shenjë e qartë se pa marrë parasysh se sa je i ri, i bukur dhe i suksesshëm, pleqëria do të jetë fund i pashmangshëm.

Vdekja e njeriut

Jeta rrjedh sekondë pas sekonde. A jeni të vetëdijshëm se çdo ditë iu afron më afër vdekjes ose se vdekja është aq afër jush sa është afër të tjerëve?

Siç na është kumtuar në ajetin: **“Secili njeri do të shijojë vdekjen, e pastaj do të ktheheni te Ne.” (Ankebut: 57)**, secili që është shfaqur ndonjëherë në këtë botë është i përcaktuar që të vdes. Pa përjashtim të gjithë do të vdesin, çdonjëri. Sot, është vështirë që t’u biesh në gjurmë shumë njerëzve që kanë vdekur. Ata që tani janë gjallë dhe ata që ndonjëherë do të jetojnë do ta shijojnë vdekjen në ditën e caktuar. Pavarësisht nga ky fakt, njerëzit mundohen ta shohin vdekjen si një aksident i pamundur.

Paramendoje një foshnje që vetëm sa ka lindur dhe njeriun i cili është duke vdekur. Asnjëri as tjetri nuk kanë ndikim në procesin e lindjes apo të vdekjes. Vetëm Allahu ka fuqinë që të inspirojë frymën e lindjes dhe të vdekjes.

Të gjithë njerëzit do të jetojnë deri në ditën e caktuar e pastaj do të vdesin; Allahu në Kur’an jep shpjegim për qëndrimin e zakonshëm të treguar ndaj vdekjes në ajetin në vazhdim:

Thuaj: “S’ka dyshim se vdekja prej së cilës po ikni, ka për t’ju zënë, e mandej do të silleni te Ai që e di të padukshmen dhe të dukshmen, dhe atëherë Ai do t’ju njoftojë me atë që keni punuar”. (Xhuma:8)

Shumica e njerëzve i shmangen mendimit për vdekjen. Në vllgun e punëve të përditshme, njeriu zakonisht preokupohet me çështje krejtësisht

tjera: cilin fakultet ta regjistrojë, për cilën kompani të punojë, çfarë ngjyre të rrobave të vesh të nesërmen, çfarë të gatujë për darkë; të gjitha këto janë çështjet madhore që zakonisht i kemi në konsideratë. Jeta kuptohet si një proces rutinë për çështjet aq të vogla. Përpjekjet për të biseduar për vdekjen gjithmonë ndërpriten nga ata që trazohen nga dëgjimi për këtë çështje. Marrja me seriozitet e çështjes së vdekjes bëhet vetëm kur dikush plakët, dhe nuk e çan kokën më herët për këtë çështje aq të pakëndshme. Por duhet që të kemi në mendje se nuk e kemi jetën të garantuar as deri në orën e ardhshme. Çdo ditë njeriu është dëshmitar i vdekjes së njerëzve përreth tij por mendon pak për ditën që tjerët do të jenë dëshmitar të vdekjes së tij. Ai kurrë nuk supozon se përfundim i tillë është duke e pritur!

Megjithatë, kur vdekja vjen i gjithë realiteti i jetës “papritmas” zhduket. Nuk përmenden më as “ditët e lumtura”. Paramendo të gjithat që ke mundësi t’i bësh mu tani: të bëni me sy, lëvizni trupin, flisni, qeshni; të gjitha këto janë funksione trupore. E tani paramendo për gjendjen dhe formën e trupit tënd pas vdekjes.

Që nga frymëmarrja e fundit, do të bëhesh vetëm një “grumbull mishi”. Trupi yt, i qetë dhe i palëvizshëm, do të dërgohet në morg. Atje do të lahesh për herë të fundit. I mbështjellë në qefin, kufoma jote do të bartet për në varreza me arkivol. Kur trupi vendoset në varr, dheu do të mbulojë. Ky është fundi i tregimit tënd. Prej këtij momenti, ti bëhesh vetëm njëri nga emrat e shkruar në gurin prej mermeri.

Gjatë muajve ose viteve të para, varri yt do të vizitohet shpesh. Me kalimin e kohës, njerëzit vijnë më rrallë. Pas disa dekadave, askush më nuk do të vizitojë.

Ndërkohë, familja jote e ngushtë do të përjetojnë një aspekt tjetër të vdekjes suaj. Në shtëpi, dhoma dhe shtrati juaj do të jenë të zbrazët. Pas varrimit, ato sende që kanë mbetur do të mbesin në shtëpi: shumica e teshave, këpucëve, etj., do t’i dhurohen dikujt që kanë nevojë. Regjistri yt në komunë do të shlyhet apo do të arkivohet. Gjatë viteve të parë, dikush do të mbajë zi për ty. Sidoqoftë, koha punon kundër kujtimeve që ke lënë prapa. Pas 4-5 dekadave, do të mbesin vetëm disa që do të përkujtojnë. Do të vijnë gjeneratat e reja dhe askush nga gjenerata jote nuk do të jetë në botë. A do të përkujtohesh apo jo, çdo gjë do të jetë e pavlerë për ty.

Derisa kjo krejt ngjanë mbi tokë, kufoma nën dhé do të kalojë nëpër procesin e shpejtë të kalbjes. Menjëherë pasi të jesh vendosur në varr, procesi i shumimit të baktereve dhe insekteve do të fillojë për shkak të mungesës së oksigjenit. Gazrat e liruar nga këto organizma do të fryjnë trupin, duke filluar nga abdomeni, duke ndryshuar formën dhe dukjen e tij. Gjaku do të shpërthejë nga goja dhe hunda për shkak të shtypjes së gazrave në diafragmë. Me procedimin e kalbjes, qimet e trupit, thonjtë, shputat dhe shuplakat do të bien. Duke shoqëruar ndryshimin e jashtëm të trupit, organet e brendshme si mushkëritë, zemra dhe mëlçia gjithashtu do të kalben. Në ndërkohë, skenat më të tmerrshme do të ndodhin në abdomen, ku lëkura nuk mund të bartë shtypjen e gazrave dhe papritmas shpërthen, duke shpërndarë një erë shumë të keqe dhe të padurueshme. Duke filluar nga kafka, muskujt do të shpëputet nga vendet e tyre, lëkura dhe indet e buta do të shpërbëhen tërësisht. Truri do të kalbet dhe do të fillojë të duket si baltë. Ky proces do të vazhdojë derisa i tërë trupi do të mbetet vetëm skelet.

Nuk ka mundësi që prapë të kthehet jeta e vjetër. Mbledhja rreth tryezës në darkë me anëtarët e familjes, shoqërimi apo që prapë të kemi vend të mirë pune, është e pamundur.

Shkurtimisht, “grumbulli i mishit dhe eshtrave”, në të cilin kemi mundur të dallojmë fytyrat, do të përballet me një përfundim të shëmtuar. Nga ana tjetër, ti – apo më mirë të themi, shpirti yt – do të largohet nga trupi yt menjëherë pas frymëmarrjes së fundit. Mbetja jote – trupi yt – do të bëhet pjesë e dheut.

Po, por cila është arsyeja për të gjitha këto ngjarje?

Nëse Allahu do të kishte dëshiruar, trupi nuk do të kalbej në këtë mënyrë. Kjo mban në vete një porosi të brendshme shumë të rëndësishme.


Fundi i llahtarshëm që e pret njeriun duhet që ta mësojë atë se ai nuk është vetë trupi, por shpirt “i mbyllur” brenda në trup. Me fjalë tjera, njeriu duhet të mësojë se ai ka një ekzistencë përtej trupit të tij. Bile, njeriu duhet që të kuptojë vdekjen e trupit të tij që ai mundohet ta posedojë meqë ai dëshiron të mbetet përgjithmonë në këtë botë të përkohshme. Sidoqoftë ky trup, që e mendon se është shumë i rëndësishëm, do të kalbet dhe do të jetë ushqim i krimbave një ditë dhe më në fund do të mbetet vetëm një skelet. Ajo ditë mund të jetë shumë afër.



Menjëherë pas vdekjes



Jarga me gjak duke dalë nga goja dhe hunda



Para se të fillojë dezintegrimi i kufomës



Sytë nxihen pas vdekjes



Kufoma e djegur



Kufoma brenda në varr e konsumuar nga krimbat

*Kudo që të jeni vdekja do t'ju kapë,
po edhe në qofshi në pallate të fortifikuara!...
(Nisa:78)*

All-llahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët, pastaj pas asaj dobësie ju dha fuqi, e pas fuqisë, dobësi e pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijsihmi, më i fuqishmi. (Rum:54)

Përkundër këtyre fakteve, procesi mendor i njeriut ka prirje për nënvlerësim të asaj çfarë nuk do apo nuk i pëlqen. Ai bile ka prirje që të mohon ekzistimin e gjërave që ai përpiqet t'u largohet. Kjo tendencë më së shumti duket kur bëhet fjalë për vdekjen. Vetëm funerali apo vdekja e papritur e ndonjë anëtarit të familjes sjell këtë realitet në mend. Gati çdokush e sheh vdekjen shumë larg nga vetja. Supozimi është se ata që kanë vdekur në gjumë apo në ndonjë fatkeqësi janë njerëz tjerë dhe çfarë iu ka ndodhur atyre nuk do të na ndodhë edhe neve! Çdokush mendon se është shumë herët për të vdekur dhe gjithmonë ekzistojnë edhe shumë vite përpara që duhet jetuar.



Por sigurisht, njerëzit që kanë vdekur rrugës për në shkollë apo duke u ngutur që të arrijnë në një mbledhje afariste kanë pasur mendimin e njëjtë. Ata sigurisht kurrë nuk kanë menduar se lajmet e gazetave të nesërmen do të lajmërojnë për vdekjen e tyre. Është më se e sigurt se, derisa jeni duke i lexuar këta rreshta, ti ende nuk pret që do të vdesësh shpejt pasi t'i kesh kryer këto rreshta apo as që mendon për mundësinë që do të mund të ndodhte. Si duket mendon se është herët që të vdesësh sepse ke shumë gjëra për të plotësuar. Mirëpo, kjo është vetëm një shmangie e vdekjes dhe këto janë vetëm përpjekje të kota për t'i ikur:

Thuj: “Nëse ikët prej vdekjes ose prej mbyttjes, ikja nuk do t’ju bëjë dobi, sepse edhe atëherë nuk do të (shpëtoni) përjetoni vetëm për pak kohë”. (Ahzab:16)

Njeriu që është krijuar i vetmuar duhet të jetë i vetëdijshëm që edhe do të vdes i vetmuar. Por gjatë jetës, ai jeton gati i dhënë pas pasurisë. Qëllimi i vetëm i tij në jetë është që të ketë shumë e më shumë. Sidoqoftë, askush nuk mund që të marr me vete pasurinë e vet në varr. Trupi është i mbështjellë me qefin i cili është i bërë nga materiali më i lirë. Trupi vjen në këtë botë i vetmuar dhe largohet në të njëjtën mënyrë. Pasuria e vetme që njeriu mund të merr me vete kur të vdes është besimi apo mosbesimi i tij.

All-llahu është Ai që ju krijoi në gjendje të dobët, pastaj pas asaj dobësie ju dha fuqi, e pas fuqisë, dobësi e pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijsلمي, më i fuqishmi.





DHËNIA PAS TË MIRAVE TË KËSAJ BOTE



gatë jetës, kemi synime të caktuara që dëshirojmë të arrijmë: pasuri, bollëk, status më të mirë, si dhe grua dhe fëmijë. Këto janë mes caqeve më të zakonshme që i kanë gati të gjithë njerëzit. I gjithë planifikimi dhe përpjekjet janë të bëra me qëllim të arritjes së këtyre caqeve. Pavarësisht nga vetë fakti i padiskutueshëm se çdo gjë ka prirje për plakje dhe zhdukje, njerëzit nuk mundën që të përmbahen nga lidhshmëria që kanë ndaj sendeve. Vetura e re një ditë del nga moda; për shkaqe natyrale, feramat e pasura bëhen shterpë; një person i bukur me kohë humb bukurinë e vet. Mbi të gjitha, çdo njeri mbi këtë tokë vdes, duke i lënë të gjitha pas vetes. Përkundër këtyre fakteve të pakundërshtueshme, njeriu shfaq përkushtim të pashpjegueshme për pasuri.

Ata që kalojnë jetën e tyre me përkushtim të verbër pas të mirave të kësaj bote do të kuptojnë se ata e kanë kaluar tërë jetën e tyre pas iluzioneve. Ata do të kuptojnë situatën e tyre qesharake pasi të vdesin. Vetëm atëherë qëllimi përfundimtar i jetës, me qenë shërbëtor i Allahut, do të jetë i qartë për ta.

Allahu në Kur'an tregon për këtë "lidhshmëri të thellë" në ajetin si vijon:

Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po te All-llahu është e ardhmja më e mirë. (Ali-Imran:14)

Të gjitha çështjet e kësaj bote – pasuria, gratë, fëmijët dhe afarizmi – i mbajnë njerëzit shumë të zënë në këtë jetë. Sidoqoftë, nëse do të mund ta kuptonin fuqinë dhe mençurinë e Allahut, ata do ta kishin ditur se gjërat që u janë dhënë njerëzve janë vetëm mjete për të fituar kënaqësinë e Tij. Kështu, ata do të kuptonin se qëllimi kryesor i njeriut është që të jetë shërbëtor i Tij. Por, ata që nuk kanë besim të vërtetë në Allahun kanë vizion të paqartë dhe kuptim të mangët të ekzistimit të tyre për shkak të ambicieve për këtë botë. Ata presin gjëra të mëdha nga kjo jetë me të meta.

Është befasese se njeriu harron krejtësisht për ahiretin, që është vendbanim më i përsosur përfundimisht më superior për të, dhe ai është i kënaqur me këtë botë. Nëse dikush nuk e ka besimin e plotë, bile edhe ekzistimi i një “probabiliteti” të lehtë për botën e ahiretit duhet ta bëjë atë që, së paku, të mendojë me një qëndrim më të matur.

Besimtarët, nga ana tjetër, janë plotësisht të vetëdijshëm se kjo nuk është, në asnjë mënyrë, një “probabilitet”, por një realitet. Kjo është arsyeja pse jetët e tyre i shërbejnë qëllimit të çrrënjësjes së mundësisë së vogël për të shkuar në ferr; përpjekjet e tyre janë kryekëput për arritjen në parajsë. Ata e dinë qartë se dëshpërimi që do të ndiejnë në ahiret pas kalimit të jetës pas dëshirave të kota do të jetë i hidhur. Ata gjithashtu janë të vetëdijshëm se grumbullimi i pasurisë, siç është llogaria e tejmbushur bankare, veturat dhe shtëpitë luksoze, nuk do të pranohen si shkëmbim me dënimin e përjetshëm. Bile, asnjë familje apo shok i ngushtë nuk do të jenë të pranishëm që të shpëtojnë dikë nga mjerimi i përhershëm. Në të kundërtën, çdo shpirt do të përpiqet që të shpëtojë veten. Sidoqoftë përkundër tërë kësaj, shumica e njerëzve mendojnë se jeta nuk vazhdohet ahiret, dhe me zili e përqafojnë këtë botë. Allahu thotë në ajetin si vijon:

Juve u preokupoi përpjekja për shumimin (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës)! Derisa të mos i vizitoni varrezat (të bëheni banues të tyre - të vdisni). (Tekathur:1-2)

Lakmia pas pasurisë së kësaj bote është, padyshim, fshehtësia e sprovës. Allahu i krijon të gjitha gjërat që Ai i dhuron njeriut me një stërhollim të madh, e ato janë vetëm për një kohë të shkurtë. Kjo është vetëm për të bërë njeriun që të mendojë dhe të krahasojë gjërat që i janë dhënë në këtë botë me ato ahiret. Kjo është “fshehtësia” për të cilën po

flasim. Jeta në tokë me të vërtetë është madhështore; është tërheqëse dhe e shumëngjyrshme dhe kështu zbulon madhështinë e krijesave të Allahut. Që të jetohet një jetë e mirë dhe të kënaqesh në të, padyshim, është ajo çfarë njeriu dëshiron, dhe sigurisht, i lutet Allahut për këtë gjë. Por kjo nuk duhet të jetë qëllimi përfundimtar, pasi synime të tilla në jetë nuk janë më të rëndësishme se arritja e kënaqësisë së Allahut dhe parajsja. Prandaj, njeriu kurrë nuk duhet të harrojë qëllimin e tij kryesor, derisa kënaqet me të mirat e këtyre dhuratave. Për këtë çështje Allahu paralajmëron njeriun në ajetin e mëposhtëm:

Dhe çdo gjë që u është dhënë juve është kënaqësi dhe shije e kësaj bote, ndërsa ajo që është te All-llahu (thevabi) është shumë më e mirë dhe e përhershme, pra, a nuk mendoni? (Kasas: 60)

Kjo dashuri e madhe për gjërat e kësaj bote është njëra ndër arsytet pse njeriu harron ahiretin. Kjo është edhe një pikë që duhet mbajtur në mend: njeriu kurrë nuk e gjen lumturinë e vërtetë në asnjërin nga gjërat e kësaj bote që i lakmon në këtë botë apo të ndonjë pajisje që ai përpiqet të ketë. Kjo është kështu për shkak se dëshirat e pashtershme është shumë vështirë të plotësohen. Pa marrë parasysh se sa dikush ka, dëshirat egoiste kurrë nuk marrin fund. Në mënyrë tipike, gjithmonë kërkon më mirë dhe më tepër. Ky është shkaku pse njeriu nuk mund të gjej qetësi ose kënaqësi në këtë botë.

A ekziston pasuria e vërtetë në këtë botë?

Shumica e njerëzve supozojnë se mund ta kthejnë jetën e tyre në një jetë të përsosur kur të vendosin që ta bëjnë atë. Bile, ata thjeshtë supozojnë se arritja e cilësisë së lartë të jetës është e mundur duke pasur më shumë para, standarde më të mira të jetës, familje të lumtur, si dhe një status të shkëlqyeshëm në shoqëri. Por ata njerëz që i përkushtojnë tërë kohën për të siguruar gjërat e tilla, qartë janë duke bërë gabim. Së pari, ata vetëm përpiqen që të arrijnë paqe dhe lumturi në këtë botë dhe harrojnë ahiretin. Pavarësisht nga fakti se qëllimi i tyre është që të bëhen shërbëtorë të Allahut në këtë botë dhe të jenë falënderues për atë çfarë iu është dhuruar, ata kalojnë jetën në përmbushjen e dëshirave të tyre të kota.

Allahu e lajmëron njeriun për lakminë e parëndësishme dhe mashtruese të kësaj bote në Kur'an:

Ju njerëz dinie se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga All-llahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues. (Hadid:20)

Mosbesimi në ahiret apo të kuptuarit e tij si mundësi të largët është gabimi fundamental i shumë njerëzve. Ata besojnë se kurrë nuk do të humbin pasurinë e tyre. Krenaria bën që të largohen nga nënshtrimi ndaj Allahut dhe t'i kthejnë shpinën premtimit të Tij. Fundi i këtyre njerëzve tregohet si vijon:

Ata që nuk presin takimin Tonë, që janë të kënaqur me jetën e dynjasë dhe kanë gjetur prehje në të, dhe ata që janë indiferentë ndaj argumenteve tona. Vendi për të tillët është zjarri, për shkak të asaj që punuan. (Junus:7-8)

Historia ka qenë dëshmitare e shumë njerëzve të tillë. Mbretërit, perandorët dhe faraonët kanë menduar se mund të sigurojnë pavdekshmërinë përmes pasurisë së tyre përrallore; mendimi se ekziston diçka më e vlefshme sesa pasuria dhe fuqia kurrë nuk ju ka shkuar ndër mend. Kjo mendësi e cekët i ka devijuar këta njerëz, që ishin të mahnitur me pasurinë dhe fuqinë e tyre. Sidoqoftë, të gjithë këta jobsimitarë kanë përjetuar përfundim të tmerrshëm. Në Kur'an, Allahu na tregon për ta:

A mos mendojnë ata se me atë që jemi duke u dhënë atyre nga pasuria dhe fëmijët, nxitojmë t'u ofrojmë atyre të mirat? Jo, kurrsesi, por ata nuk janë kah e kuptojnë. (Mu'minun: 55-56)


Prandaj, mos të mahnitë (mos e shih të mirë) pasuria e tyre e as fëmijët e tyre, All-llahu do vetëm t'i dënojë me to në jetën e kësaj bote e t'ju nxjerrë shpirtat duke qenë ashtu qafira. (Teube:55)

Këta njerëz në të vërtetë shpërfillin pikën vendimtare. E gjithë pasuria dhe çdo gjë e konsideruar e rëndësishme, i takon Allahut. Allahu, Poseduesi i vërtetë i pasurisë, u shpërndanë pasurinë e Tij të pafundme atyre që Ai dëshiron. Si përgjigje, nga njeriu pritet që të tregojë falënderimin e tij ndaj Allahut dhe të bëhet shërbëtor besnik i Tij. Duhet mbajtur në mend se askush nuk mund t'i kufizojë pasurinë e atij që Allahu i ka dhuruar. Në të






Një vizatim në një monument të majëve në Honduras. (Poshtë) Gjendja e tanishme e të njejtit monument, dikur simbol i një civilizimi madhështor. Ky krahasim zbulon faktin habitës: asnjë madhështi nuk është imun ndaj shkatërrimit në këtë botë.







Këto janë disa nga lajmet e vendeve që po t'i rrëfejmë ty; disa prej tyre ekzistojnë ende, e disa janë shkatërruar. (Hud:100)

Vetëm një teatër ka shpëtuar nga metropoli i famshëm nga Roma e vjetër, që tani është zëvendësuar me një pamje krejtësisht tjetër. (Djathtas) Gjendja e tanishme e teatrit të njëjtë. Sot, nuk ka asnjë gjurmë se dikush ka jetuar aty në madhështi.

njëjtën mënyrë, nëse dikush është i privuar nga pasuria, askush përpos Allahut nuk mund ta mbështes. Kështu, Allahu i fut në sprovë njerëzit e vet. Sidoqoftë, ata që harrojnë Krijuesin e vet dhe ditën e gjykimit nuk i kushtojnë vëmendjen ajetit:

All-llahu i ofron furnizim me bollëk atij që do dhe ia kufizon (atij që do). Po ata (jobsimtarët) janë të gëzuar me jetën e kësaj bote. E jeta e kësaj bote ndaj botës tjetër nuk është tjetër vetëm se një përjetim (i shkurtër). (Rrad: 26)

A janë të rëndësishëm pasuria dhe statusi në këtë botë?

Shumica e njerëzve besojnë se jeta në mënyrë të përsosur paqësore mund të arrihet në këtë botë. Kjo mendësi sugjeron se njeriu mund të gjej lumturinë e vërtetë dhe të fitojë respekt nga të tjerët nëse bëhet i pasur. Mendësi e njëjtë besohet se kur të arrihet kjo, do të zgjasë deri në fund të

botës. Por, e vërteta qëndron ndryshe. Njeriu kurrë nuk do të mund të arrijë jetën e ëndrrave të veta duke harruar Krijuesin e vet dhe ditën e gjykimit. Për shkak se derisa ai të realizon një cak, ai mendon për caqe tjera. Nuk i mjafton që është duke fituar shumë, ai vazhdon me aktivitete të reja. Ai nuk kënaqet me banesën e re posa të shoh që fqinji i tij e ka shtëpinë më të dekoruar, apo ndryshe, për shkakun se e ka shtëpinë e dizajnuar me modelin nga viti i kaluar, e që më nuk është në modë, bën që ai ta ri-dekorojë. Psikologjia e jobsimtarëve shumë qartë shpjegohet në ajetin e ardhshëm:

Ti, më le Mua dhe atë që e krijova të vetmuar. Dhe bëra këtë pasuri të madhe. E bëra edhe me djem që i ka me vete. Dhe Unë i lash në dispozitim të gjitha mundësitë. E ai lakmon që t'i shtoj edhe më tepër. (Mudeththir: 11-15)

Personi me mendje të mprehtë dhe kuptim të pastër duhet të dijë se ata që kanë disa shtëpi me më shumë dhoma se sa banorë, vetura luksoze apo veshje përrallore janë të aftë që të përdorin vetëm një pjesë të pasurisë së tyre. Nëse e ke shtëpinë më të madhe në botë, a është e mundur që të kënaqesh me komfortin e secilës dhomë në të njëjtën kohë? Gjithashtu, nëse ke gardërobë të modës së fundit, sa tesha mund t'i veshës gjatë ditës? Pronari i një shtëpie me shumë dhoma, në kushtet e kohës dhe hapësirës mund të qëndrojë në një kohë vetëm në një dhomë. Nëse të ofrohen të gjitha gjellët e ndonjë kuzhine të njohur, barku juaj nuk mund t'i zë më shumë se disa nga ato gjellëza; dhe nëse mundohesh që të hash më shumë, rezultati do të jetë më shumë torturë sesa kënaqësi.

Lista do të mund të zgjatej edhe më tej, por fakti më i madh është se njeriu është i destinuar në një kohë të kufizuar të jetës në të cilën mund të shijoj luksin e pasurisë së tij. Njeriu shpejt shkon kah fundi i tij, sidoqoftë ai mezi e kupton këtë gjatë jetës së tij dhe mendon se pasuria e tij do t'i sjell atij lumturi të amshueshme, siç tregon ajeti:

E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm. (Humeze: 3)

Njeriu është i hipnotizuar me fuqinë e pasurisë së vet dhe kur përballet me fundin e tij në ditën e gjykimit, ai do të përpiqet t'i ikë dënimit duke e falur pasurinë e vet:

Edhe pse ata shihen ndërmjet vete (edhe njihen, por ikin prej njëri-

tjetrit). Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet dhe me vëllain e vet. Edhe me të afërmit e tij që ai te ata mbështetej. Edhe me krejt çka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar! Jo, kurrsesi, ajo (para) është Ledhdha - flaka (emër i Xhehennemit). (Me'arixh:11-15)

Sidoqoftë, disa njerëz janë të vetëdijshëm se pasuria, prosperiteti dhe fatin i mirë janë nën kontrollin e Allahut. Nga kjo, ata janë të vetëdijshëm se shkalla dhe statusi janë gjëra qesharake. Vetëm këta njerëz sinqerisht e kuptojnë se kjo pasuri nuk do t'i shpëtojë ata në ahiret. Prandaj, ata nuk jepen pas sendeve të vlefshme të kësaj bote. Shfaqja e arrogancës nuk është tipar që pret prej këtyre njerëzve aq modestë. Duke mos harruar kurrë ekzistencën e Allahut të Plotfuqishëm i bën ata që të jenë falënderues për çdo gjë që ai iu jep. Si përgjigje për sjellje të tillë, Allahu premtonte jetë të ndershme dhe të rehatshme për ta. Njerëzit që besojnë Allahun dhe të qenurit shërbëtorë të Allahut është qëllim përfundimtar i jetës së tyre, janë të vetëdijshëm se nga gjërat e kësaj bote mund të kenë përfitim vetëm një kohë të caktuar dhe se mallrat e kësaj bote janë të pavlefshme në krahasim me bollëkun e premtuar të përherëshëm. Pasuria kurrë nuk i bën këta njerëz të jepen pas kësaj bote. Bile në të kundërtën, ata i bëjnë më falënderues dhe më afër Allahut. Ata punojnë drejtësisht me çdokënd dhe çdo çështje, dhe mundohen, me çfarë Allahu iu ka dhënë, që të fitojnë kënaqësinë e Tij. Më me dëshirë se sa të kënaqen nga pasuria e kësaj bote, ata synojnë t'i arrijnë vlerat kur'anore që pritet nga ata, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se statuti dhe lëvdata janë të rëndësishëm në prani të Allahut. Profeti Sylejman na jep një shembull për të gjithë njerëzit si një besimtar i ndershëm duke shfaqur tipare të tilla në jetën e tij. Të poseduarit e një pasur pasurie të madhe dhe sovraniteti, Sylejmani qartë tregon pse e ka ndjekur këtë pasuri:

E ai tha: “Unë i dhashë përparësi dashurisë së kuajve, ndaj Zotit tim, derisa (dielli) u fsheh dhe perëndoi”. (Sad:32)

Dështimi që të kuptohet pse mallrat e kësaj bote janë krijuar në këtë botë shpien njerëzit të harrojnë se ata do të mund të përdorin pasuritë e kësaj bote vetëm për 60-70 vjet, nëse kanë aq jetë të paracaktuar, e atëherë do t'i lënë mbrapa shtëpitë, veturat dhe fëmijët e tyre. Ata nuk mendojnë

se do të varrosen të vetmuar. Gjatë gjithë jetës së tyre ata kanë vrapuar për pasuri në të cilën kurrë nuk do të kënaqen.

Sidoqoftë, ata që e konsiderojnë pasurinë si shpëtimtar dhe e neglizhojnë ekzistimin e Krijuesit të tyre do të vuajnë në të dy botët:

Është e vërtetë se atyre që nuk besuan nuk do t'u vlejë asgjë para All-llahut, as pasuria e as fëmijët e tyre. Ata vetë janë lëndë e zjarrit. (Ali Imran:10)

Kur'ani lajmëron fundin e tyre që demonstrojnë lakmi të pashuar ndaj pasurisë:

Që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet,

E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm!

Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai pa tjetër do të hidhet në Hutame,

E çka din ti se ç'është Hutame?

Është zjarri i All-llahut i ndezur fort.

Që depërton deri në loçkë të zemrës.

Ai i mbyll ata, ua zë frymën. Ata janë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme. (Humeze:2-9)

Pasuria e vërtetë u takon atyre besimtarëve që kurrë nuk kanë shfaqur interes personal në pasuritë e kësaj bote dhe që më të vërtetë besojnë se vetëm Allahu i jep të gjitha njeriut. Këta në të vërtetë janë njerëzit e pasur në këtë botë; ata nuk e kufizojnë jetën e tyre në vetëm 50-60 vjet. Besimtarët angazhohen në tregtinë më të mirë me arritjen e paraqsës në këmbim me jetën e kësaj bote. Ata preferojnë pasurinë e amshueshme në vend të asaj të përkohshme. Allahu na informon në lidhje me këtë në ajetin në vijim:

All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhennet. Luftojnë në rrugën e All-llahut, mbysin dhe mbyten. (All-llahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kur'an. E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra, gëzonju tregtisë që bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh. (Teube:111)

Mospërfillja e këtyre fakteve, ata që "kapen pas" kësaj jete së shpejti do të kuptojnë qartë se kush është në rrugë të vërtetë.

Martesa

Martesa konsiderohet si një pikë kthesë e rëndësishme në jetë. Secila vajzë apo djalë shpreson që të takojë personin e ëndrrave të veta. Bashkëshorti i mirë është synim madhor në jetë dhe të rinjtë janë gati të “indoktrinuar” me rëndësinë e gjetjes së atij të vërtetit. Sidoqoftë, marrëdhëniet mes mashkullit dhe femrës bazohen krejtësisht në terrenet e pathemelta të shoqërive injorante, gjegjësisht në shoqëritë ku njerëzit nuk e pranojnë mënyrën e jetës nga Kur’ani: “miqësitë” janë vetëm marrëdhënie romantike në të cilën të dy gjinitë kërkojnë kënaqësi emocionale. Por, martesat zakonisht bazohen në përfitimet të dyanshme materiale. Shumë femra mundohen që të gjejnë një “mashkull të suksesshëm” që mund të ofrojë standard të lartë jetese. Për këtë arsye, një vajzë e re shumë lehtë mund të pranojë që të jetë grua e përjetshme e dikujt për të cilin ajo nuk ndien dashuri. Nga ana tjetër, atë që mashkulli shpesh e kërkon në femër është “bukuria”.

Deri më tani përsiatja pas pikëvështrimit të një shoqërie injorante shpërfill faktin përfundimtar: të gjitha këto vlera materialiste janë të gjykuara në zhdukje; Allahu mund ta ndryshojë fatin e dikujt për një moment. Në të njëjtën mënyrë, nuk nevojiten më shumë se disa sekonda që të humbet bukuria; dhe si banorë qyteti, p.sh., udhëtimi për në punë dhe prapa në çdo kohë mund të pengohet me ndonjë aksident që mund të len vërraga të tmerrshme dhe permanente në fytyrë. Koha, ndërkohë, lë dëme të pakthyeshme në shëndetin, fuqinë dhe bukurinë tonë. Nën kushte aq të paparashikueshme, çfarë pasojash mund të ketë në një sistem që bazohet vetëm në vlerat materiale? P.sh., paramendo njeriun i cili martohet me një femër vetëm për shkak se e ka mahnitur me bukurinë e saj. Çfarë do të mendojë nëse fytyra e saj do të lëndohej keq në ndonjë aksident? A do ta lerë atë kur të fillojnë të shfaqen rrudhat në fytyrën e saj? Përgjigjet padyshim zbulojnë bazën e paarsyeshme të mendimit materialist.

Martesa bëhet e vlefshme kur planifikohet vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut. Përndryshe, ajo bëhet barrë në të dy botët. Nëse jo në këtë botë, njeriu përfundimisht do të kuptojë në ahiret, se kjo ka qenë mënyrë e gabuar për shpirtin njerëzor. Por, atëherë do të jetë shumë vonë; në ditën e gjykimit, ai do të ketë gruan e vet, me të cilën ka qenë shumë

i afërt në këtë botë, si pagesë për shpëtimin e vet. Llahtaria e asaj dite do t'i bëj të gjitha marrëdhëniet e kësaj bote të pakuptimta. Allahu na jep sqarim për marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes së ngushtë në ditën e gjykimit në ajetin në vijim:

Edhe pse ata shihen ndërmjet vete (edhe njihen, por ikin prej njëritjetrit). Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet dhe me vëllain e vet. Edhe me të afërmit e tij që ai te ata mbështetej. (Mearixh: 11-13)

Është evidente nga ajeti se njerëzit nuk do të jepen më pas grave, shokëve, vëllezërve dhe motrave në ditën e gjykimit. Në përpjekjet e tyre të kota që të shpëtojnë, secili do të jetë i gatshëm që të paguajë me familjen e vet të ngushtë apo të gjerë si pagesë për shpëtim personal. Bile, këta njerëz do të mallkojnë njeri tjetrin pasi ata nuk e kanë paralajmëruar për këtë fund të tmerrshëm. Në Kur'an, kështu tregohet rasti i Ebu Lehebit që meritoi dënimin e përjetshëm në ferr dhe gruas së tij:

Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra), E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur. (Mesed:1-5)

Tipi i martesës që është e pranueshme tek Allahu është, megjithatë, e bazuar në kritere krejtësisht të ndryshme. Ndryshe nga martesat e zakonshme në një shoqëri injorante, ku njerëzit janë mospërfillës ndaj fitimit të kënaqësisë së Allahut, si kriter nuk llogaritet paraja, fama apo bukuria por martesë me qëllim të fitimit të kënaqësisë së Allahut. Për besimtarët, kriteri i vetëm është takwa, apo me fjalë të tjera, “shmangia nga të gjitha që janë të ndaluara, pëmbushja e të gjithave që janë urdhëruar, si dhe frika nga Allahu”. Si pasojë, besimtari mund të martohet vetëm me dikë që shfaq besnikëri të thellë ndaj Allahut. Njerëzit e gjejnë paqen dhe lumturinë në kesi martesë. Ajeti në vijim flet për këtë gjë:

Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë. (Rum:21)

Duke qenë Takwa obligimi i vetëm, besimtarët sigurisht do të kenë jetë

të këndshme në ahiret. Pasi ata e përkujtojnë njeri tjetrin për punët e drejta dhe udhëzojnë njëri tjetrin për në parajsë gjatë jetës së tyre, ata do të mbetën miq të ngushtë për tërë amshimin. Marrëdhëniet e tyre përshkruhen në këtë ajet:

Besimtarët dhe besimtares janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqa, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë. (Teube:71)

Fëmijët

Ambicie madhore e njerëzimit është që të lënë pas djem që do ta mbajnë emrin e familjes në të ardhmen. Sidoqoftë, nëse nuk është synim për të fituar kënaqësinë e Allahut, kjo ambicie do të jetë largimi i njeriut nga rruga e Allahut. Njeriu sprovohet me fëmijët e tij; në këtë kuptim, ajo që pritet nga ai është t'i trajtoj ata ashtu që të fitojë kënaqësinë e Allahut.

S'ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, ndërsa ajo që është tek All-llahu, është shpërblim i madh. (Tegabun:15)

Në këtë ajet përdorimi i fjalës “sprovë” ka rëndësi shumë të madhe. Për shumë njerëz, posedimi i fëmijëve është njëra ndër synimet më të rëndësishme në jetë. Por në kuptimin kur'anor, besimtari dëshiron fëmijë vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut. Përndryshe, vetëm për të plotësuar dëshirën e vet për fëmijë, të pasurit fëmijë do të nënkuptonte vetëm përshkrim partneri Allahut. Shembulli i atyre që harrojnë qëllimin e tyre dhe i bëjnë fëmijët si “synimin përfundimtar të tyre” është dhënë në Kur'an:

Ai (All-llahu) është Ai që ju krijoi prej një vete, e prej saj për t'u qetësuar pranë saj. Kur e mbuloi ai (mashkulli) atë (gruan), ajo u ngarkua me një barrë të lehtë dhe ashtu vazhdoi me të, e kur u bë e rëndë, ata të dy lutën All-llahun, Zotin e tyre: “Nëse na jep një (fëmijë) të mirë, ata (pa të meta), ne do të jemi falënderues ndaj Teje”. Pasi që atyre të dyve ju dha (fëmijë) të mirë, ata (fëmijë e pasardhës) i përshkruan shokë në atë që iu dha. I pastër është All-llahu nga ajo që ia përshkruajnë. A i përshkruajnë shok atë çka nuk mund të krijojë asnjë send, e ata (idhujt) vetë janë të krijuar. (A'raf: 189-191)

Besimtarët kërkojnë fëmijë nga Allahu vetëm për kënaqësinë e Tij. Kur kanë kërkuar fëmija, profetët citohen në Kur'an se ata vetëm kanë pasur qëllim të fitojnë kënaqësinë e Allahut. Një shembull është me gruan e Imranit:

(Përkujtohu) Kur gruaja e Imranit pat thënë: “Zoti im, Unë këtë që është në barkun tim, vendosa ta kushtoj thjesht vetëm për shërbimin Tënd, pra pranoje këtë prej meje, vërtetë Ti je Ai që dëgjon e di!” (Ali-Imran: 35)

Lutja e profetit Ibrahim, gjithashtu është shembull për tërë besimtarët: **Zoti ynë, bëna neve dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tanë dhe falna neve, vërtetë Ti je që falë, je mëshirues!” (Bekare: 128)**

Në kuptimin e këtij ajeti, të pasurit fëmijë, nëse synohet pëlqimi i Allahut, është mënyrë e adhurimit të Allahut. Mirëpo, kur synimi i vërtetë është diçka tjetër pos bekimi nga Allahu, atëherë personi mund të ketë pasoja në të dy botët. Besimtarët i pranojnë fëmijët e tyre si individualë që iu janë besuar atyre nga Allahu. Prandaj, nuk e marrin si krenari personale në pamjen, suksesin apo inteligjencën e fëmijëve, duke e ditur se Allahu i ka dhënë ato tiparet atij fëmije. Krenaria e tillë është thjesht një akt i humbjes së rrugës.

Qasja q tillë ka pasoja të paracaktuara në ahiret. Në ditën e gjykimit, dikush mund të jetë i gatshëm që të paguaj me djemtë, gruan e vet apo anëtarët e familjes së ngushtë të tij si pagesë për shpëtim të përhershëm.

Dikush dëshiron që t'i shmanget dënimit të dhembshëm menjëherë i braktisë më të dashurit e tij. Por në ditën e gjykimit nuk do të ketë shpresë nga shmangia e dënimit të përhershëm me veprime të tilla.

Për njerëzit në shoqëritë injorante, fëmijët bëhen burim i shumë problemeve jo vetëm në ahiret por edhe



në këtë botë. Që nga lindja, rritja e fëmijës bëhet përgjegjësi e madhe për prindërit. Është një përjetim i vështirë për nënën shtatzënë. Së pari, në ditën kur e ka kuptuar se ka mbetur shtatzënë, ajo duhet ta ndërrojë komplet stilin e jetës. Ajo duhet të rishqyrtojë prioritetet. Në këtë aspekt nevojat për fëmijën në bark gjithmonë është e para; mënyra e ushqimit, gjumi, shkurtimisht, e tërë jeta e saj personale ndërron. Kah fundi i shtatzënisë, punët e përditshme dhe lëvizjet e thjeshta trupore bëhen më të vështira për nënën. Mirëpo, vështirësitë madhore fillojnë menjëherë pas lindjes. Nëna kalon tërë kohën e vet duke u kujdesur për fëmijën. Foshnja zakonisht i lejon nënës së vet shumë pak kohë për nevojat dhe detyrat e saja personale. Prandaj, nëna e shpreson kohën kur fëmija të rritet aq sa të kujdeset për vetveten. Ndërkohë, nëna nuk e heton se sa shpejt ka kaluar koha. Nëse e tërë është bërë për të fituar kënaqësinë e Allahut, kjo kohë do të konsiderohej si mënyrë adhurimi. Ndërsa për ata që jetojnë në shoqëri injorante, këto vite nuk janë asgjë tjetër përpos probleme të paarsyeshme.

Prindërit në një shoqëri injorante zakonisht ndiejnë zhgënjim gjatë rritjes së familjes së tyre. I rritur si anëtar i një shoqërie injorante, fëmija në përgjithësi zhvillohet në personalitet të përqendruar në vete. Nën udhëzimin e gabuar të shtytjeve dhe motiveve egoiste, ai tregon interesim në nevojat e prindërve vetëm kur i thuhet që të bëjë. Prindërit e tij, tashmë të vjetër dhe me probleme të pleqërisë, e kuptojnë këtë gjë, por vonë. Sidoqoftë në vitet e hershme të të qenurit prind, ata mendojnë se kur fëmijët e tyre rriten ata do të jenë mbështetja kryesore kur të plaken, por përkundër këtyre shpresave, ata bile mund të gjenden edhe në shtëpinë e pleqve.

Allahu në Kur'an i prezanton njeriut një plan-pune, ashtu që besimtarët të dinë se si të sillen me përgjegjësi ndaj prindërve të tyre. Allahu kërkon respekt dhe mëshirë ndaj prindërve, posaçërisht kur plaken:

Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre

krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”. (Isra: 23-24)

Siç kuptuam nga ajetet, rritja e një fëmije në dritën e vlerave kur'anore është punë e respektuar për besimtarët. Por, për jobesimtarët që i detyrojnë fëmijët e tyre që të pranojnë mendësinë e një shoqërie injorante, atëherë kjo është një përpjekje e kotë në të dy botët. Bile, besimtarët prapëseprapë do të fitojnë kënaqësinë e Allahut edhe nëse fëmijët e tyre nuk i pranojnë mësimet nga Kur'ani që ai iu ka dhënë. Prindërit mbajnë përgjegjësinë që fëmijëve të tyre të japin mësimet nga Kur'ani dhe t'i bindin që të besojnë në Allahun. Përpos Allahut, njerëzit nuk kanë mbrojtës apo ndihmëtar tjetër.

Ata që synojnë përfitimet e kësaj bote nga fëmijët e tyre nuk do të marrin kurrfarë ndihme as në këtë botë e as në tjetrën.

E kur të vijë ushthima (krisma e kiametit); Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, Prej nënës dhe prej babait të vet, Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet. (Abese: 33-37)

Siç u cek më parë, njeriu është krijuar vetëm të jetë shërbëtor i Allahut. Çdo gjë që e rrethon, gjatë tërë jetës së tij, ekziston vetëm për ta sprovuar. Pas vdekjes, njeriu do të gjykohet vetëm sipas veprave të tij. Si kundërpërgjigje për veprat e veta, ai do të shpërblehet me parajsë apo do të dënohet në ferr. Shkurtimisht, pasuria, bukuria ose djemtë nuk vlejnë, por takwa, “frika nga Allahu” është ajo që vlen.

Nuk është as pasuria juaj, e as fëmijët tuaj ajo që ju afron pranë Nesh, është vetëm besimi dhe veprat e mira; të tillët shpërblehen shumëfish për atë që vepruan dhe ata janë në dhoma të larta të shpëtuar. (Sebe': 37)

S'ka dyshim se atyre që nuk besuan, nuk do t'u bëjnë dobi ndaj (dënimit të) All-llahut as pasuria e as fëmijët e tyre. Ata janë banues të zjarrit dhe aty janë përgjithmonë. (Ali Imran: 116)

A nuk e di ti (o dëgjues) se All-llahu di çka ka në qiej dhe çka në tokë?! Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave e të mos jetë Ai i katërti; e as mes pesë vetave e të mos jetë Ai i gjashti, e as mes më pak vetave dhe as mes më shumë vetave, e të mos jetë Ai me ta, kudo që të jenë. Pastaj, në ditën e kiametit i njofton ata me atë që kanë punuar. All-llahu ka përshirë çdo send në dijen e vet. (Muxhadele: 17)

FATKEQËSITË DHE RREZIQET NATYRORE

Bota është gjithçka përpos e qetë dhe e palëvizshme. Të gjithë kemi pika të dobëta ndaj rreziqeve natyrore, si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Shirat meteorikë, asteroidet janë vetëm disa nga faktorët që shihen si rreziqe jashtëtokësore. Edhe pse toka duket mjaft kompakte, bërthama e saj përbëhet nga elementet e shkrira. Bile nuk do të jetë e ekzagjeruar shprehja për këtë pjesë të tokës, që mbetet e padukshme për ne, “bërthama e zjarrtë”. Gjithashtu ekziston edhe atmosfera që rrethon tokën, që është një “mbrojtës” nga kërcënimet e jashtme. Por, asnjë pjesë e tokës nuk është imune ndaj efekteve të fuqive atmosferike si shtrëngatat, stuhitë, apo tufanet.

Rreziqet natyrore mund të godasin çdo moment. Mund të shkaktojnë humbje të konsiderueshme të jetëve dhe pasurisë. Të njohura në përgjithësi si fatkeqësi “natyrore”, tërmetet, vetëtimat, vërshimet e shpejta, zjarret e egra globale, shiu acidik dhe dallgët jonormale kanë intensitete dhe efekte të ndryshme. E përbashkët për të gjitha është se për një çast mund të shkatërrojnë një qytet, me të gjithë banorët, deri në gërmadha. Më e rëndësishmja e kësaj është se asnjë njeri në botë nuk ka fuqi që t'i luftojë apo të parandalojë asnjërin nga këto rreziqe.

Shkatërrime të mëdha janë çfarë lënë pas katastrofat në tërë botën. Sidoqoftë, fatkeqësia çdoherë ka efektin vetëm në regjion të caktuar duke iu falënderuar drejtpeshimit delikat të natyrës e që është krijim i Allahut. Një mbrojtje e rëndësishme ekziston në botë për të gjitha qeniet e gjalla e

gjithashtu edhe për njeriun. Mundësia e ndonjë fatkeqësie shkatërruese natyrale është e fshehtë përkundër të gjitha mbrojtjeve. Allahu krijoi këto fatkeqësi që të tregojë se sa e pasigurt nganjëherë mund të jetë vendbanimi. Këto dukuri në natyrë janë përkujtues për tërë njerëzinë se nuk kemi asgjë në kontroll në këtë planet. Në të njëjtën mënyrë, çdo fatkeqësi shërben për të na përkujtuar dobësitë tona natyrore. Këto sigurisht janë paralajmërime për ata që vrasin mendjen për rëndësinë e këtyre ngjarjeve dhe marrin mësim nga përjetimet e të tjerëve.

Çfarë duhet tjetër të mësojë njeriu nga fatkeqësitë natyrore?

Bota është krijuar veçanërisht për njeriun. Arsyeja pse njeriu është krijuar është evident ashtu siç sugjeron ky ajet:

Ai është i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë dite (fazave), e Arshi (Froni) i Tij kishte qenë (më parë) mbi ujë, që t'ju sprovtojë, se cili prej jush është më vepërmirë. (Hud:7)

“Rregullimi” i kësaj “sprove” është mjaft i ndërlikuar, sidoqoftë, çdo ngjarje është komponentë e këtij rregullimi të sofistikuar. Bile, asnjëra nga këto dukuri natyrore nuk ngjanë rastësisht; të gjitha kanë shpjegime shkencore. P.sh., forca e gravitacionit të tokës shpjegon pse ne nuk humbasim në gjithësi; shiu bie kur avulli i ujit arrin nivel të caktuar të ngopjes. Shkaqet e njëjta vlejné edhe për vdekjen, aksidentet apo sëmundjet. Shkaqe të shumta mund të citohen pse vdes, sëmuret, apo ka përjeton aksident një njeri. Sidoqoftë, ajo që është me rëndësi nuk është numri i këtyre arsyeve por “siguria” e sistemit që i shkakton këto dhe pasojat pastaj. Një aspekt i veçantë i këtij sistemi është i rëndësishëm; secili incident shkaktohet në atë mënyrë që mendja e njeriut mund ta kuptojë plotësisht. Allahu e paralajmëron njeriun me anë të fatkeqësive natyrore. Tërmeti, p.sh., mbyt mijëra gra, fëmijë dhe të rinj dhe lëndon edhe shumë të tjerë. Ata që janë të shkujdesur nga paralajmërimet e Allahut mundohen t'i shpjegojnë incidentet e tilla si fenomene “natyrore” dhe pak e kuptojnë se Allahu i krijon këto për qëllim të veçantë. Të paramendojmë këtë: çfarë do të ndodhte nëse vetëm ata që janë fajtorë para Allahut të vdesin në tërmet? Në atë rast, kriteri i duhur për “sprovë” të njerëzimit nuk do të arrihej. Ja pse Allahu krijon secilin fenomen në rregullim “natyror”. Vetëm ata që janë të vetëdijshtëm mbi ekzistencën e Allahut dhe kanë kuptim të



Allahu krijoi fatkeqësitë natyrore me një qëllim. Ajo është mënyra në të cilën Ai demonstron se kjo botë është vend i përkohshëm në të cilin njerëzit vehen në "test".

plotë të krijimit të Tij e kuptojnë arsyen hyjnore pas këtyre shfaqjeve "natyrore".

Në ajetin, **"Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne, në shenjë sprove ju sprovovmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne (Enbija:35)**, Allahu thotë se Ai sprovon njeriun përmes ndodhive të mira dhe të këqija.

Se shumë njerëz dëmtohen nga fatkeqësitë është fshehtësia e sprovës. Njeriu gjithmonë duhet të ketë në mendje se Allahu është Gjykatës i Gjithëdijshëm "...e në mes tyre (njerëzve) kryhet gjykimi me drejtësi" (Zumer:75).

Të gjitha ndodhitë në jetën e njeriut në këtë botë janë pjesë e këtij testi. Ata që janë besimtarë të vërtetë e kuptojnë thelbin e kësaj fshehtësie. Kurdo që një fatkeqësie iu bie atyre, ata drejtohen vetëm te Allahu dhe pendohen. Ata janë shërbëtorë të Allahut dhe janë të vetëdijshëm për premtimin e Allahut:

Ne do t'ju sprovovmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po ti jepu myzhde durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: "Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!" Të tillët janë që të Zoti i tyre kanë bekime

**e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë.
(Bekare:155-157)**

Siç thuhet në ajet, të gjithë njerëzit, besimtarët dhe jobesimtarët, testohen në shumë mënyra: ndonjëherë me ndonjë fatkeqësi natyrore, herëve diçka ndodh në jetën tonë të përditshme, sëmundje apo aksident. Fatkeqësitë e tilla u ndodhin si personave ashtu edhe shoqërive dhe shkaktojnë humbje si në material ashtu edhe vuajtje shpirtërore. I pasuri mund të bankrotojë, vajza e bukur mund të lëndohet në fytyrë, apo i tërë qyteti mund të shkatërrohet deri në gërmadha nga tërmeti. Këto incidente janë tregues të qartë se si, në çdo çast, ngjarjet mund të ndryshojnë jetët tona.

Njerëzit duhet të jenë të aftë që të nxjerrin mësim nga këto ndodhi. Padyshim, Allahu nuk krijon diçka pa ndonjë qëllim; çdo fatkeqësi është përkujtues për njerëzit me qëllimin që t'i shpëtoj njerëzit nga zvetërimi në të cilën janë. Në Kur'an, Allahu thotë se pa lejen e Tij, asgjë nuk ndodhë:

Çfarëdo e keqe që ndodh (godet), nuk mund të jetë ndryshe, vetëm sipas caktimit të All-llahut, e kush i beson All-llahut, Ai ia udhëzon zemrën e tij; All-llahu është i gjithëdijshëm për çdo send. (Tegabun: 11) Askush nuk vdes pa vullnetin dhe lejen e All-llahut. Ai është shënim i afatit të caktuar. E kush e dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne atij ia japim, e kush e dëshiron shpërblimin e botes tjetër, edhe atij do t'ia japim atë, kurse mirënjohësit Ne do t'i shpërblejmë. (Ali Imran:145)

Një mësim tjetër që njeriu mund të nxjerrë nga fatkeqësitë, që e supozon veten të fortë në tokë, kupton se ai është i dobët dhe nuk ka fuqi që t'i bëj ballë fatkeqësive, e që mund të ndodhin çdo çast me vullnetin e Allahut. Njeriu nuk mund t'i ndihmoj as vetës e as dikujt tjetër. Me të vërtetë Allahu është i Gjithëfuqishëm. Kjo ceket në ajetin e mëposhtëm:

Nëse All-llahu të godet me ndonjë të keqe, s'ka kush që ta largojë atë pos Tij, e nëse të dhuron ndonjë të mirë, duhet ditur se Ai është i gjithëfuqishëm për çdo send. (En'am: 17)

Në këtë kapitull, do të jepen njohuri gjithëpërfshirëse për disa lloje të fatkeqësive që shkaktohen në tokë. Qëllimi është që të përkujtohen njerëzit se kjo botë nuk është vend që duhet kushtuar dashuri të verbër. Këto fatkeqësi theksojnë se sa në mënyrë të dëshpëruar na duhet

udhëzimi dhe ndihma nga Allahu. Ky dëshpërim është paraqitje e qartë se njerëzit janë të paafte para Allahut. Siç thuhet në ajetin; “...dhe përpos All-llahut, nuk keni as mbrojtës as ndihmëtar”. (Ankebut:22)

Tërmetet

Tërmetet janë njëra ndër forcat më shkatërruese në tokë. Humbjet më të mëdha të jetës së njerëzve ngjajnë gjatë tërmeteve. Hulumentimet zbulojnë se në çdo dy minuta diku sipërfaqja e tokës çahet. Sipas statistikave, toka dridhet me miliona herë gjatë vitit. Mesatarisht, intensiteti i 300.000 tërmeteve është i vogël; janë vetëm dridhje të pandjeshme dhe nuk shkaktojnë dëme fare. Njëzet prej tyre, nga ana tjetër, janë tërmete të fuqishme që tundin tokën. Meqë ato nuk godasin shpesh vende me popullsi të dendur, ato mbysin disa njerëz, apo asnjë, dhe shkaktojnë dëme të vogla ekonomike. Vetëm 5 nga këto tërmete i rrëzojnë ndërtesat.

Kjo informatë tregon se njerëzit nuk hasin shpesh në tërmete. Padyshim, kjo është mbrojtje speciale e Allahut kundër fatkeqësive për njerëzinë.

Në ditët e sotme, vetëm një qytet apo region bëhet vend i tërmetit shkatërrues. Por, me dëshirën e Allahut, tërmeti mund të kaplojë tërë planetin çdo çast. Ky lloj tërmeti mund të shuaj jetën mbi tokë. Struktura e tokës është mjaft e ndjeshme në tërmete; një lëvizje apo këputje e papritur e masës së madhe të shkëmbinjve në brendi të korës së tokës apo shtresës së lartë mund ta bëjë të pashmangshme katastrofën.

Tërmeti nuk ka të bëjë me llojin e dheut që i zgjeron efektet e valëve sizmike gjatë udhëtimit nëpër të. Tërmeti mund të ndodh edhe nëse nuk ekzistojnë kushtet për tërmet. Me dëshirën e Allahut, tërmeti mund të ndodh në çdo çast. Sidoqoftë, Allahu veçanërisht krijon pasiguri dhe jo-stabilitet në disa pjesë të tokës. Kjo është për të përkujtuar njerëzit se, në çdo çast, incident i papritur mund t'i sjell në rrezik jetët e tyre. Në Kur'an, Allahu i paralajmëron njerëzit për katastrofë të mundshme:

A mos janë të sigurt ata që përgatitën kurthe, se All-llahu nuk do t'i trandë ata me tokën, ose nuk do t'u vijë atyre dënimi kah nuk e mendojnë? Ose t'i rrëmbejë ata duke qenë në udhëtimet e tyre (për jetë e tregti), e ata nuk mund t'i shpëtojnë asaj. Ose do t'i kapë ata duke

qenë në panikë nga frika. Po, s'ka dyshim se Zoti juaj është i butë, i mëshirshëm (andaj nuk ua ngut dënimin). (Nahl: 45-47)

Kjo tërmete që lëkundin tokën vetëm disa sekonda mund të zgjasin me orë, bile edhe disa ditë. Derisa njerëzit fillojnë të marrin veten, mund të ndodhë menjëherë tjetri. Kjo sigurisht është lehtë për Allahun. Mirëpo, me mëshirën e Tij, Allahu e mbron njeriun e me fatkeqësitë si këto e përkujtojnë atë, në çdo kohë, se ai nuk ka kurrfarë kontrolli gjatë jetës së tij.

Në këtë pikë, do të ishte e dobishme të përkujtohet një tërmet i mëdha, që kanë ndodhur në shek. 20-të.

Teknologjia përjeton humbje: Kobe

Sot shkalla e përparuar e teknologjisë dhe shkencës inspiron njeriun me ndjenjën se ka kontroll mbi natyrën. Por, ata që janë të trullësuar nga nocion i tillë së shpejti do të ndiejnë zhgënjim. Teknologjia është një mjet i siguruar nga Allahu për t'i shërbyer njeriut dhe është nën kontroll të plotë të Tij. Ngjarjet e ndryshme tregojnë se edhe teknologjitë më të avancuara janë të paafta që të sundojnë natyrën.

P.sh., përkundër “teknologjisë tërmet-rezistuese” të zhvilluar nga shkencëtarët japonez, Kobe ra si viktimë e rrëshqitjes së gjerë të shkaktuar prej 20 sekondave të valëve të fuqishme të tërmetit gjatë vitit 1995. Strukturat më të forta rezistuese nga tërmeti në botë të ndërtuara që tu rezistojnë lëkundjeve intensive thjeshtë janë shembur gjatë tërmetit me fuqi prej 6.9 shkallësh. Gjatë tri dekadave të mëparshme, qeveria japoneze kishte investuar 40 miliardë dollarë në kërkime studimore që të zhvilloj sisteme paralajmëruese për tërmete. Sidoqoftë, këto përpjekje nuk kanë dhënë fare rezultate bindëse. Pasi jemi duke iu afruar fundit të mileniumit, shkencëtarët ende janë të paaftë që të shpikin sistemet ashtu që të paralajmërojnë dhe të zvogëlojnë efektet shkatërruese nga lëkundjet sizmike. Kobe ishte një shembull i kohëve të fundit, në mes shumë të tjerëve, duke demonstruar se sa i ndjeshëm është qyteti modern nga strukturat sizmike të papritura.

Qytetarët ishin të bindur se teknologjia moderne e zhvilluar që të parashikoj tërmetet e mëdha mund t'i shpëtojë ata nga shkatërrimi i plotë. Sidoqoftë, pas fatkeqësisë që e kishin bërë qytetin Kobe vetëm një



Kobe, qyteti i dytë për kah dendësia në Japoni si dhe porti më i rëndësishëm pas Tokios. Në 5:46 të mëngjesit të 17 janarit 1995, njëzet sekonda të disa dridhjeve shkaktuan dëme tmerruese. Vetëm

20 sekonda dhe çdo gjë që njerëzit patën fituar me mundim gjatë tërë jetës u shkatërrua.



grumbull mbeturinash, u bë e qartë se asnjë teknologji nuk është në dispozicion që të paralajmëroj njerëzit për rrezik. Është bërë e qartë se edhe të ashtuquajturat “struktura kundër tërmetit” nuk janë të qëndrueshme fare ndaj tërmetit që epiqendrën e ka pasur 15 km larg në juglindje të qendrës së qytetit në Kobe.

Regjioni i dëmtuar nga tërmeti ka përfshirë qytetet shumë të populluara të Kobës dhe Osakës. Për këtë shkak ka ndodhur dëmi tmerrues, duke lënë 5,200 njerëz të vdekur dhe 300,000 tjerë të lënduar. Dëmet e përgjithshme janë vlerësuar në 200 miliardë dollarë.³

Sigurisht nga fatkeqësia e tillë mund të nxirren mësim. Banorët e qyteteve, të mësuar të jetojnë këndshëm, papritmas ishin të përballuar me shumë çaste të vështira pas fatkeqësisë. Në gjendje shoku, ata nuk ishin në gjendje që të kuptojnë se si t’ia bëjnë më tutje,- e le më që të bëjnë plane për të ardhmen.

Tajfunet, uraganet, tornadot...

Tajfunet, uraganet, dhe tornadot janë fatkeqësi natyrore që njerëzit i përjetojnë shpesh. Këto fatkeqësi dhe pasojat e tyre marrin me vete me mijëra jetë gjatë vitit. Këto janë erëra shumë të forta, që mund tu shkaktojnë dëme të mëdha qyteteve, duke mbytur dhe lënduar banorët, shkuljen e mijëra drunjve, vërvitjen e shtëpizave, shtyllave telefonike bile edhe ndërtesave, kilometra më tutje.

Tajfunet e mëdha në veçanti mund të shkaktojnë ngritjen e papritur të valëve gjigante nga fundi i detit. Në këtë fenomen, stuhi të fuqishme shpërndajnë valë që kanë shpejtësi prej qindra km/h nëpër oqean në drejtim të brigjeve. Në këto raste, uji ngritet mbi tokën dhe shirat e rreptë shkaktojnë vërshime në regjionin e deltave.

Shndërrimi i erërave që zakonisht janë si puhiza të mesme në stuhi të fuqishme me aftësi që të lëvizin ndërtesa, padyshim na detyron që të kërkojmë fuqinë më të madhe që i bën këto gjëra të ndodhin. Përsiatja e njëjtë e debatuar në seksionin e tërmeteve vlen edhe për tajfunet, uraganet dhe tornadot: nëse Allahu do të dëshironte, njeriu shumë shpesh do të ndeshet me fatkeqësi të tilla natyrore. Derisa njerëzit fillojnë të marrin veten, mund të ndodhë menjëherë tjetri. Në Kur’an, Allahu e përkujton njeriun se erërat janë nën kontrollin e Tij:

A u garantuat ju prej Atij që është në qiell, që të mos ju shafit (të mos u lëshoj) toka kur të dridhet. A u garantuat ju prej Atij që është në qiell, që të mos lëshojë kundër jush ndonjë stuhi me rrebesh gurësh. E pra, do ta kuptoni se si është ndëshkimi Im! Edhe ata që ishin para tyre përgënjeshtrian, por çfarë ishte dënimi Im? (Mulk: 16-18)

Mirëpo, Allahu i mbron njerëzit nga rreziqet. Ai vetëm nganjëherë dërgon kundër tyre stuhi të ashpra. Kjo sigurisht është për të paralajmëruar njeriun. Qëllimi i paralajmërimit është që t'u tregohet atyre se qëllim përfundimtar në jetë është të qenurit shërbëtor i Allahut, dhe sa ata janë të paafte kundër fuqisë së Allahut dhe se do të gjykohen në ditën e gjykimit.

Vullkanet

Njëjtë sikur dridhjet apo tundjet e tokës të shkaktuar nga lëvizja apo këputja papritmas e masave të mëdha të shkëmbinjve brenda korës së tokës apo shtresës së lartë, shpërthimet vullkanike janë një formë tjetër e mahnitshme e fatkeqësive natyrore. Ekzistojnë rreth 1,500 vullkane aktive në botë; 5504 janë mbi sipërfaqen e tokës e tjerët janë nën oqeanë. Këto vullkane mund të shpërthejnë në çdo çast në mënyra jashtëzakonisht shkatërruese ashtu që askush nuk mund ta parashikojë. Kur të shpërthejnë, vullkanet mund të mbysin banorë të qyteteve përreth si dhe të shkatërrojnë të mbjellat duke i mbuluar arat me hi.

Disa shpërthime katastrofike që ndodhën në këtë shekull sikurse edhe më parë në histori kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në mendjen e njerëzve. Këto shpërthime kanë zhdukur nga harta shumë qytete dhe ka zhdukur shumë bashkësi.

Sigurisht nga shpërthimet vullkanike gjatë historisë mund të nxirren mësim. Maja e Vezuvit në Itali, p.sh., e ka varrosur qytetin romak Pompei, në të cilin njerëzit jetonin një jetë të shthurur, nën valët e llavës së nxehtë. Është i habitshëm fakti se 20,000 banorë të këtij qyteti të përparuar ishin asfiksuar më së shumti nga rrjedhat piroklastike që e kishte pushtuar qytetin me 24 gusht të vitit 79.

Sot, sidoqoftë, pasiviteti i vullkaneve mundet shpesh që të ndërpritet dhe mund të zgjohen papritur duke hedhur avull dhe hi me qindra metra lart në ajër. Ndërkohë, rrjedhat piroklastike i vërshojnë regjionet duke shkaktuar dëme në çfarëdo që hasin. Një efekt tjetër i dëmshëm i



Në shkurt të vitit 1988, një uragan kur goditi Floridën shkaktoi dëme të mëdha. Uragani demoloi ndërtesa dhe i hodhi automobilat për ndërtesa. (Fotoja vijuese dhe ajo e poshtme) Automobilat dhe shtëpitë shpërhapura nga uragani.





Një tornado që ishte aq e madhe saqë ka fshirë nga faqja e dheut shtëpitë dhe bëri të shndërrojë një qytet të tërë në rrënojë.




Në shkurt të vitit 1988, pas një uragani në Floridë, krijoi një grumbull motobarkash.

shpërthimeve janë retë e gazrave të dëmshme dhe hirit që bartet nga era në regionet e populluara. Këto erëra të tmerrshme, ndonjëherë edhe me shpejtësi prej 120 km/h, djegin çdo gjë dhe i mbulojnë qytetet sikurse një çadër kundër diellit.

Njëra ndër katastrofat më të mëdha ndodhi më 1833 kur Krakatau, në Indokinë, ka shpërthyer fuqishëm, duke prodhuar valë të zërit që është dëgjuar 4.000 km larg dhe duke krijuar cuname të larta deri 45 metra. Valët kanë bërë rrafsh me tokë 165 fshatra bregdetare dhe kanë mbytur 36,000 njerëz⁵.

Vullkanet mbahen në mend jo vetëm për shkak të numrit të madh të të vdekurve por edhe për shkak se ata shpërthejnë në mënyrë shkatërruese saqë nuk mund të parashikohet. Erupsioni i Nevado Del Riuz është një shembull. Në fillim ishte një erupsion me intensitet të vogël. Sa për krahasim, ishte vetëm sa 3% i erupsionit të majës St. Helens. Pas pasivitetit prej 150 vjetësh, Nevado Del Riuz shpërtheu më 1985 duke e shkrirë borën dhe akullin në majën e tij. Shumë shkatërrues ishte lava apo lumi i baltës, që rrodhi poshtë majës së vullkanit në luginën e lumit Lagunille, ashtu që 20,000 banorë të Armeros në Kolumbi u zhdukën nga faqja e dheut, ashtu që u varrosën në baltën e nxehtë deri sa ishin duke fjetur. Kjo ngjarje ishte fatkeqësia më e madhe nga vullkanet që nga fatkeqësia në Mount Pelee më 1902, i cili mori 30, 000 jetë me llavën e vet rrjedhëse në qytetin St Pierre.⁶

Allahu demonstroi se si njeriu papritmas mund të gjej vdekjen me anë të fatkeqësive të tilla dhe kështu e përkujton njeriun që të vras mendjen në



(Majtas) Një vullkan gjatë erupsionit.
(Poshtë) Autobusi në mes të llavës
përkujton shkatërrimin e Pompeit.



Duke e mbuluar tërë horizontin në qershor 1991, retë e dendura të mbushura me hi- një valë vdekjeprurëse pirolastike- duke u vjellur nga mali Mount Pinatubo në një ndër erupcionet më eksplozive të shek. të 20-të. (Poshtë) Banorët përreth Mount Pinatubo mbrohen me ombrella nga shiu prej hiri. (Majtas)



lidhje me qëllimin e ekzistimit të tij në tokë. Këto incidente dërgojnë “paralajmërim”. Ajo që pritet si përgjigje nga njeriu, i cili mund të mendoj për Krijuesin e vet të Gjithëfuqishëm, nuk është që të kënaqet dhe të çmendet pas të mirave të kësaj bote për 50-60 vite dhe të neglizhoj jetën e përhershme, ahiretin. Duhet që ta kemi në mendje se vdekja patjetër do të vijë një ditë dhe çdokush do të gjykohet në prani të Allahut:

...(ndëshkon kundërshtarët) Ditën kur toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt (në tjerë qiej), e ata (njerëzit) të gjithë dalin sheshazi para All-llahut, Një, Mbizotërues. (Ibrahim: 48)

Cunamet

Valët detare sizmike apo valët e baticës shkaktohen me ngritje apo rrëshqitje të papritur të fundit të detit apo gjatë erupsioneve vullkanike. Disa cuname mund të kenë efekte shkatërruese sikurse bombat atomike.


Vërshimet

Allahu sigurisht i krijon të gjitha këto fatkeqësi si “paralajmërim” për njerëzit. Ai është madhështor në fuqi dhe Ai ka fuqinë mbi të gjitha gjërat. Allahu e vërteton këtë në ajetin: **“Thuaj: “Ai ka fuqi (t’ju shpëtojë, por edhe) t’ju sjellë dënim prej së larti ose prej së poshti nën këmbët tuaja”. (En’am: 65)**. Ekzistimi i kaq shumë kërcënimeve fizike serioze nëpër botë padyshim nënvizon një realitet të rëndësishëm. Me fatkeqësi, për disa sekonda Allahu mund t’i merr çfarëdo që ia ka dhuruar njeriut. Katastrofat mund të godasin në çdo vend dhe në çdo kohë. Ky është një demonstrim i qartë se asnjë vend në botë nuk i ofron njeriut siguri të plotë. Allahu e cek këtë në ajetin në vazhdim:



A mos u siguruan banorët e fshatrave nga dënimi jonë kur ata ishin fjetur (natën)? A mos u siguruan banorët e fshatrave nga dënimi jonë para dite kur ata ishin duke luajtur? A mos u siguruan ata prej ndëshkimit të

Valët e mëdha të ujit (cunamet) ndonjë herë mund të asgjësojnë qytetet bregdetare.



Më 1997-1998, stuhia “El-Niño”shfryu tërbimin e vet mbi shumë qytete. Dëmi total në tërë botën u vlerësua në 20 miliardë dollarë. 8 (Lart) një qytet i prekur nga El-Niño. Edhe pse uji ka rëndësi të madhe, vërshimet shkatërruese mbetet gjithnjë edhe kërcnim. (Tutje) Një shtëpi e zhytur në ujë.

All-llahut? Nuk sigurohet kush prej frikës së ndëshkimit të All-llahut pos njerëzve të humbur. (A'raf: 97-99)

Uji, i dhënë njerëzve si dhuratë dhe lehtësim, ndonjëherë mundet që të shndërrohet në fatkeqësi me dëshirën e Allahut. Është e pakuptueshme që njeriu është dëshmitar i një apo dy vërshimeve në vit dhe ende nënvlerëson mundësinë që ai vetë të përjetoj të fatkeqësi të tillë.



Breshëri me një shpejtësi prej 160 km/h ka thyer xhamat e një veture në Tampa, Florida, gjatë një stuhie që ka shkatërrua pasuri me vlerë prej 25 milion dollarësh. 9 Pullazi i një shtëpie i shkatërruar nga kokrrat e breshërit.



Zjarret e mëdha të shkaktuar nga moskujdesja e njeriut mund të shkaktojnë humbje të mëdha.



Nga flaka e një zjarri të qëllimshëm në kanjonin e shkumbur mbi Laguna Beach, California përjetoi zjarrin më të rëndë në vitin 1993. Ky tmerr ka djegur 14,000 akër tokë dhe 441 shtëpi. Lagja “The Mystic Hills” është goditur më së rëndi, ku 286 shtëpi u bënë pluhur dhe hi.



Një mësimi nga historia: Titaniku

Historia përmban plot raste kur njerëzit janë mbështetur në zbulimet e mëdha teknologjike dhe duke nënvleftësuar krejtësisht fuqinë e Allahut. Kjo është pse shumë fatkeqësi janë shënuar në histori si mësimet të hidhura për çdokënd. Secila nga këto ngjarje është e rëndësishme në aspektin e përkujtimit nga ana e njeriut që as pasuria e as fuqia, shkenca apo teknologjia nuk kanë forcë që t'i rezistojnë dëshirës së Allahut.

Shembujt të shumtë të incidenteve të tilla mund të jepen. Më i njohuri është i famshmi Titaniku, një anije e madhe udhëtarësh me lartësi prej 55 m e lartë dhe 275 metra i gjatë, i cili është fundosur para gati 90 vitesh. Titaniku, e synuar që të jetë “ofendim ndaj natyrës”, ishte një projekt i madh që ka angazhuar një ekip të inxhinierëve dhe nja 5.000 njerëz. Gati çdokush ishte i bindur plotësisht se kjo anije kurrë nuk do të mund të fundosej. Anija ishte kryevepër teknologjike me shumë risi inxhinierike që ishte përparimi i madh në kohën e vet. Prandaj ata që mbështeteshin në forcën teknologjike të anijes nuk e kanë marrë në konsideratë një fakt të **rëndësishëm që është i cekur në ajetin: “... E urdhëri i All-llahut është vendim i kryer” (Ahzab: 38)** dhe secili herët a vonë do të ndeshet me fatin e vet. Kështu, një gabim i vogël bëri që anija të fundosej dhe teknologjia e avancuar nuk mundi ta shpëtojë Titanikun nga fundi i hidhur.

Nga ajo që kanë rrëfyer mbijetuesit e Titanikut, shumica e udhëtarëve janë vendosur në kuvertën e anijes që të luten kur e kanë vërejtur se anija do të fundosej. Në shumë kaptina të Kur'anit, është përsëritur tendenca e tillë e sjelljes njerëzore. Në kohën e turbullirave dhe rrezikut, njeriu lutet sinqerisht dhe kërkon ndihmë nga Krijuesi i vet. Por, kur çlirohet nga rreziku, ata prapë kthehen në jo-falënderues:

Zoti juaj është Ai që për ju mundësoi lundrimin e anijeve në det në mënyrë që të kërkonte nga të mirat e Tij. Vërtet, Ai është shumë mëshirues ndaj jush. E kur ju kap juve paniku (frika) në det, i humbni (nga kujtesa) ata që i lutni, u mbetet vetëm Ai (All-llahu), mirëpo pasi që Ai t'ju shpëtojë e të arrini në tokë, ia ktheni shpinën. Ashtu, njeriu është përbuzës. A mos jeni të sigurve që nuk do t'u shafitë në tokë ose nuk do t'ju lëshojë ndonjë shtrëngatë e ju nuk do të keni mbrojtës. A mos jeni të sigurt se Ai nuk do t'ju kthejë njëherë tjetër në det, e t'ju

lëshojë ndonjë furtunë të erës, e për shkak të mosbesimit tuaj t'ju fundosë, e pastaj nuk do të gjeni kush do të hakmerrej kundër Nesh për ju. (Isra: 66-69)

Dikush ndoshta kurrë nuk do të përjetojë fatkeqësi të tillë, por duhet mbajtur në mend, se në çdo kohë, dikush mund të sjellët deri në zero. Kështu, njeriu duhet çdoherë që të preokupojë veten me përkujtimin e Allahut meqë “ **... e tërë fuqia i takon Allahut...**” (Bekare: 165) Nga ana tjetër, kur godet katastrofa, dikush nuk do të ketë rastin që të ndërrojë qëndrimin e vet jo-falënderues ndaj Allahut dhe të pendohet. Vdekja mund të jetë shumë e papritur:

A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në tokë dhe çka krijoi All-llahu prej sendeve, e edhe në atë se ndoshta u është afruar afati i tyre i vdekjes. Atëherë, cilës bisedë pos kësaj (Kur'anit) do ti besojnë? (A'raf:185)

Pranë mëshirës së Allahut

Secilin prej tyre e kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet; disa prej tyre Ne i goditëm me furtunë plot rërë, disa i shkatërruam me krismë nga qielli, kurse disa të tjerë i sharruam në tokë dhe disa i përmbytëm në ujë. All-llahu nuk u bëri atyre ndonjë të padrejtë, por ata vetës së tyre i bënë padrejtë. (Ankebut: 40)

Për çfarë është folur deri më tani është synuar që të përkujtojmë ata që e harrojnë qëllimin e krijimit të tyre për një fakt të rëndësishëm: çdo gjë në botë ia ka borxh ekzistencën e vet Allahut, Krijuesit që ka krijuar tërë gjithësinë materiale. Me fjalë tjera, ekzistenca e çdo gjëje është si rezultat i aktivitetit të vullnetit të Allahut. Prandaj, asgjë nuk është ndaras dhe mënjanë Allahut. Kur'ani na tregon se asgjë nuk është larg kontrollit të Allahut: “**... All-llahu është mbizotërues i punës së vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve).**” (Jusuf:21)

Megjithatë, siç e bën të qartë Allahu në pjesën e dytë të ajetit, shumica e njerëzve nuk janë të vetëdijshëm për këtë. Ata mendojnë, gjatë jetës së vet, se atyre nuk do t'iu bie çfarëdo fatkeqësie, kurrë nuk mendojnë se edhe ata janë shumë të dobët ndaj secilës nga këto fatkeqësi. Ne mendojmë se përjetimet e “të tjerëve” janë shumë të tmerrshme dhe se “ne”



THE SHIP OF THE FUTURE IN THE MOST EXCITING
The Queen of the Ocean
TITANIC



The Greatest Ship and the Greatest Story of the World
 WHEEL SHIP LINE, P.O. Box 100, New York


Saturday, April 20th




TICKETS FOR SALE HERE

1st CLASS WATER LINE	\$34.
2nd CLASS WATER LINE	41.
3rd CLASS WATER LINE	44.
4th CLASS WATER LINE	45.





Disa mobile dhe gjësende që kanë qenë në Titanic. Së bashku me anijen, të gjitha këto pronësi ishin varrosur në thellësinë e oqeanit. Sot, shumë pak njerëz në botë përkujtojnë pronarët e këtyre sendeve.

do të jetojmë gjithmonë të sigurt. Lajmet për fatkeqësitë, aksidentet apo epidemitë sigurisht që na bëjnë të ndiejmë keqardhje për të vuajturit. Ne me të vërtetë e ndajmë dhimbjen e tyre; por, me rastin kur fatkeqësitë largohen pak nga kujtesa, ne bëhemi më pak të koncentruar dhe qëndrimi i tillë tregon se ka qenë interes i përkohshëm për ne. Si të kyçemi në problemet ditore apo ballafaqohemi me probleme personale, ne shpejt zhvillojmë një ndjenjë apatie dhe mbetemi indiferent ndaj atyre që kanë përjetuar fatkeqësinë.

Sidoqoftë, mendimi se çdo ditë jeta e dikujt do të jetë e njëjtë është me të meta. Kjo është evidente nga paralajmërimet e Allahut. Sigurisht, ata njerëz që i janë ekspozuar fatkeqësive të ndryshme nuk e kanë ditur se një rrezik natyrorë do të çrregullojë plotësisht jetën e tyre. Ata sigurisht e kanë filluar ditën si një ditë të zakonshme, duke menduar se do të jetë e ngjashme si ditët e përparshme. Mirëpo, doli të jetë një ditë plotësisht ndryshe. Me sa duket, kurrë nuk kanë menduar se, mu në atë ditë të caktuar do të bëhet ndryshim aq drastik në jetën e tyre, e që do t'ia u shndërrojë jetën e tyre në një luftë të rrezikshme. Në raste të tilla, jeta reduktohet në një thjeshtësi të dukshme. Sigurisht, kjo është mënyra se si Allahu i përkujton njerëzit se siguria në këtë botë është një mashtrim.

Mirëpo, shumica e njerëzve nuk e vrasin mendjen për këtë gjë. Ata harrojnë se jeta është e shkurtë dhe e përkohshme dhe nuk e përfillin faktin se ata do të jenë të gjykuar në prani të Allahut. Në këtë gjendje të pavëmendshmërisë, ata e kalojnë jetën pas dëshirave në vend që të jetojnë për kënaqësinë e Allahut.

Duke e shikuar nga ky pikëvështrim, telashet janë mëshirë e Allahut. Allahu demonstroi natyrën e vërtetë të kësaj bote dhe e inkurajoi njeriun që të përgatitet për jetën e ardhshme. Kjo është arsyeja pse thuhet se kur shkaktohet fatkeqësia në fakt është një rast i ofruar nga Allahu. Këto fatkeqësi i jepen njerëzve ashtu që ata ndoshta do të kërkojnë që të pendohen dhe të përmirësojnë sjelljet e tyre. Mësimet që duhet nxjerrë nga fatkeqësitë tregohen në ajetin e mëposhtëm:

A nuk e shohin ata se për çdo vit sprovohen një herë apo dy herë, e përsëri nuk pendohen e as nuk marrin mësim. (Teube: 126).

CIVILIZIMET E KALUARA

Sa shumë brezni kemi shkatërruar para tyre. A po vëreni ndonjë prej tyre, ose a po dëgjon zërin e ulët të tyre (nuk u ndihet zëri)? (Merjem: 98)

Njeriu është në këtë botë ekziston që të sprovohet. Gjatë historisë, porosi dhe shpallje të qarta të Allahut u janë komunikuar njerëzve përmes të dërguarve të Tij duke siguruar kështu udhërrëfyes për njerëzinë. Këta profetë dhe libra gjithmonë kanë ftuar njeriun në rrugën e vërtetë, rrugën e Allahut. Sot është në dispozicion, libri i fundit i Allahut, shpallja e vetme e pandryshueshme e Tij për njerëzinë: Kur'ani.

Në Kur'an, Allahu na informon se Ai u tregoi rrugën e vërtetë të gjithë njerëzve gjatë historisë së botës dhe i ka paralajmëruar ata përmes profetëve të Tij për ditën e gjykimit dhe ferrin. Mirëpo, shumica e njerëzve nuk i kanë pranuar profetët që iu kanë dërguar dhe kanë shfaqur armiqësi ndaj tyre. Për shkak të arrogancës së tyre, ata u përballën me tërbimin e Allahut dhe papritmas u zhdukën nga faqja e dheut. Kështu tregon edhe ajeti në vazhdim:

Edhe Adin, Themudin, banorët e Res-it dhe shumë gjenerata ndërmjet tyre (i shkatërruam). E secilit prej tyre u patëm sjellë argumente, por të gjithë i rrënuam. Ata (kurejshitët) kaluan buzë fshatit, i cili ishte gurëzuar me atë shiun (gurëzim prej së larti) e shëmtuar, po a nuk janë ata, të cilët e panë atë? Jo, nuk e vështruan, sepse ata ishin të tillë, të cilët nuk shpresonin në ringjallje. (Furkan:38-40)

Lajmet e popujve të mëparshëm, që përbëjnë një pjesë të madhe të

Kur'anit, sigurisht është njëra ndër çështjet e shpalljes për të cilën duhet vrarë mendjen. Mësimet që duhet nxjerrë nga përvoja e tyre jepet në ajetin në vazhdim:

A e vërejtën ata sa gjenerata para tyre i shkatërruam që Ne u patëm mundësuar atyre (komoditet) në tokë çfarë juve nuk ju mundësua; u patëm lëshuar nga qielli shi me bollëk dhe u patëm bërë që të rrjedhin lumenj ndër ta, e për shkak të mëkateve të tyre i shkatërruam dhe pas tyre sollëm (breza) tjerë. (En'am: 6)

Ajeti tjetër i drejtohet njeriut që vret mendjen, që kupton dhe që u vënë veshin paralajmërimeve është ky:

E sa e sa brezni para ty i kemi shkatërruar e që ishin më të fortë e më të shkathët se këta (idhujtarët kurejshitë). Ata brodhën andej e këndej nëpër tokë (për t'i ikur vdekjes). Por, a mos gjetën rrugëdalje? Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë me vëmendje, ka argumente. (Kaf: 36-37)

Allahu në Kur'an tregon se të gjitha këto raste të shkatërrimit duhet të jenë vërejtje për gjeneratat e ardhshme. Gati të gjitha shkatërrimet e njerëzve të lashtë që tregohen në Kur'an janë të identifikuar, duke iu falënderuar studimeve dhe zbulimeve arkeologjike. Por do të ishte gabim i madh që të shtjellohen vetëm qasjet historike apo shkencore deri sa të shqyrtohen gjurmët e këtyre rasteve në Kur'an. Siç përmendet edhe në ajetin vijues, secili nga këto incidente është vërejtje nga të cilat duhet nxjerr mësim:

Atë (shndërrimin e tyre) e bëmë masë ndëshkuese për ata që e përjetuan (me sy) dhe për brezat e ardhshëm, por edhe si këshillë për të devotshmit. (Bekare: 66)

Sidoqoftë, ne duhet pasur parasysh një fakt të rëndësishëm: ato bashkësi që nuk kanë dashur t'iu binden urdhrave të Allahut, nuk janë përballur me tërbimin e Allahut papritmas. Allahu u ka dërguar atyre profetë që t'i paralajmërojë ashtu që ata të pendohen për sjelljet e tyre dhe t'i dorëzohen Atij. Në Kur'an thuhet se të gjitha fatkeqësitë që i ndodhin njeriut janë përkujtim për dënimin e hidhur në ahiret:

Ne do t'u shijojmë atyre dënimin më të shpejtë (në dynja) para dënimit të madh (në Ahiret), ndoshta do të tërhiqen (prej të këqijave). (Sexhde: 21)

Shkatërrimi shpesh pasohej kur këto paralajmërimet nuk nxirrnin përgjigje në bashkësi dhe kur zvetënimi i tyre rritej. Të gjithë këta popuj ishin të dënuar nga zemërimi i Allahut. Ata u zhdukën nga faqet e historisë dhe ishin të zëvendësuar me gjenerata të reja. Këto bashkësi në të vërtetë kanë marrë përfitime nga mirësia e Allahut, kanë jetuar një jetë të përparuar, duke u kënaqur me të gjitha llojet e kënaqësive, por duke u kënaqur, kurrë nuk janë zënë me përkujtimin e Allahut. Ata kurrë nuk kanë menduar për faktin se çdo gjë në këtë botë është e dënuar që të zhduket. Ata e shijonin momentin dhe kurrë nuk mendonin për vdekjen dhe pas vdekjes. Për ata, diçka dhe gjithçka që kishte të bënte me jetën e kësaj bote dukej e përjetshme. Sidoqoftë, jeta e vërtetë e përhershme është pas vdekjes. Ata nuk kanë fituar asgjë nga ky perceptim i kësaj jete; mirëpo, historia përmban dëshmi të mjaftueshme të shkatërrimit të tyre të hidhur. Megjithatë kanë kaluar më shumë se një mijë vjet, kujtimet e tyre mbesin si vërejtje, duke i përkujtuar gjeneratat e tashme për fundin e atyre që janë larguar nga rruga e Krijuesit të tyre.

Themudët

Themudët janë njëri ndër ata popuj që janë zhdukur për shkak të paturpësisë së shfaqur ndaj shpalljes hyjnore dhe mosvërejtjes së paralajmërimeve të Allahut. Siç thuhet në Kur'an, Themudët ishin të njohur për prosperitetin dhe fuqinë e tyre dhe ishte një popull që ishte i shkëlqyeshëm në art.

Përkujtoni All-llahun kur Ai ju bëri sundues pas Adit, ju vendosi në tokë e ju në rrafshin e saj ndërtoni pallate, kurse në kodrina ngritni shtëpia, përkujtoni të mirat e All-llahut e mos u bëni shkatërrues në tokë. (A'raf:74)

Në një ajet tjetër, atmosfera shoqërore e themudëve është i ilustruar si vijon:

A jeni të sigurt se do të mbeteni në këtë që jeni (përgjithmonë)? Në kopshte e në burime. Edhe në të mbjella, e me hurma me frutat e tyre të freskët. Dhe ju me mjeshtëri po ndërtoni shtëpi nëpër kodra shkëmbore. (Shu'ara:146-149)


Të ngazëllyer në bollëk, themudët jetonin një jetë ekstravagante. Në

Kur'an, Allahu thotë se profeti Salih u ishte dërguar themudëve që t'i paralajmërojë. Profeti Salih ishte një person i njohur ndër themudët. Populli i tij, që nuk kishin pritur që ky të shpallte fenë e vërtetë, ishin të befashuar me thirrjen e tij që të lënë anash prapësinë në të cilën ishin. Një pjesë e vogël e popullit e përkrahën thirrjen e Salihut, por shumica nuk e pranuan çfarë ai thoshte. Në veçanti, udhëheqësit e popullit mohuan Salihun dhe ishin kundër tij. Ata u përpoqën që t'i lëndojnë dhe të bëjnë presion në ata që i besonin Salihut. Ata ishin zemëruar kundër Salihut pasi ai i thërriste ata që të adhurojnë Allahun. Ky zemërim nuk ishte veçori e themudëve: ata përsëritnin gabimin e bërë nga populli i Nuhit dhe Adit të bërë më përpara. Ja pse Kur'ani i referohet këtyre tre popujve si vijon:

A nuk jeni të njohur me lajmin (ndodhinë) e atyre që ishin para jush, si populli i Nuhut, i Adit, i Themudit e edhe i atyre që erdhën pas tyre, që nuk di kush për ta pos All-llahut. Atyre u patën ardhur të dërguarit

Historia e famshme e para 2000 vjetëve, ku themudët kishin themeluar një mbretëri me një popull tjetër arab, nabatinët. Sot, në Luginën Rum, e quajtur ndryshe edhe Lugina Petra, në Jordan, mund të shihen shembujt më të mirë të gdhendjes në gur të këtyre njerëzve. Gjithashtu edhe në Kur'an, themudët janë përmendur për mjeshtrinë e tyre në gurdhendje.





*"Përkujtoni kur Ai
ju bëri sundues pas
Adit, ju vendosi në
tokë e ju në
rrafshin e saj
ndërtoni pallate,
kurse në kodrina
ngreni shtëpia,
përkujtoni të mirat
e All-llahut e mos u
bëni shkatërrues në
tokë".*

(A'raf:74)

e vet me argumente, ata i vënin duart e tyre (në shenjë talljeje) në gojë të veta dhe thonin: “Ne e mohojmë atë me çka jeni të dërguar dhe ne dyshojmë shumë në atë që ju na thërrisni”. (Ibrahim: 9)

Themudët ishin të vendosur që të mbesin arrogantë dhe kurrë të mos e ndryshojnë qëndrimin ndaj profetit Salih, e bile kishin sajuar plane që ta mbysin atë. Salihu u tërhoqi vërejtjen duke iu thënë: **“A jeni të sigurt se do të mbeteni në këtë që jeni (përgjithmonë)?” (Shu’ara: 146-149).** Në të vërtetë, themudët vetëm sa e shtuan prapësinë e tyre duke mos qenë të vetëdijshëm për dënimin nga Allahu duke iu drejtuar profetit Salih me krenari dhe ngazëllim:

Ata e therrën devën dhe me kryelartësi shkelën dispozitën e Zotit të tyre dhe thanë: “O Salih, sillna atë me çka na u kërcënove, nëse je prej të dërguarve”. (Araf: 77)

Profeti Salih u tha atyre, me shpalljen e Allahut, se ata do të zhdukeshin për tri ditë.

Tri ditë më vonë, paralajmërimi i profetit Salih u bë i njëmend dhe populli i Themudit u zhduk.

Ndërsa ata që bënë zullum, i kapi (në ditën e katërt) krisma dhe gdhinë kufoma (të ngrira) në vendin e tyre. (gdhinë) Sikur të mos kishin qenë fare në të. Kuptoni pra, (populli) Themud e mohoi Zotin e vet. Mallkimi qoftë kundër Themudit! (Hud: 67-68)

Populli i Themudit e pagoi shumë shtrenjtë, duke u shkatërruar, për shkak se nuk u janë bindur profetit të tyre. Ndërtesat që i patën ndërtuar dhe puna artistike e tyre nuk i mbrojti ata nga dënimi. Populli i Themudit ishte shkatërruar me një dënim të ashpër, njëjtë sikurse të gjithë popujt tjerë që mohuan fenë para dhe pas tyre. Shkurtimisht, fundi i tyre erdhi sipas qëndrimit të tyre. Ata që mohuan ishin të shkatërruar plotësisht ndërsa ata që ishin të bindur morën shpëtimin e përjetshëm.

Populli i Sebës

Tregimi i popullit të Sebës (Shebës në Bibël) tregohet në Kur’an si vijon:

Populli Sebe pati një begati në vendbanimin e vet: kishin nga të dy anët kopshte, nga ana e djathtë (e luginës) dhe nga ana e majtë. Hani (u

thamë) nga begatitë e Zotit tuaj dhe falënderonju Atij: një territor i bukur dhe i lumtur, dhe Zot mëkatfalës. Po ata i kthyen shpinën (Allahut), e Ne e lëshuam kundër tyre rrjedhën e pendës dhe dy kopshtet e tyre i shndërruam në dy kopshte me fruta të hidhët, drunjtë thatë dhe diçka pak bari të egër. Atë dënim ua dhamë atyre për shkak se nuk besuan, e Ne nuk dënojmë, përveç mohuesit. (Se'ba: 15-17)

Siç tregohet në ajetet e mësipërme, populli i Sebës jetonte në një vend të shquar me kopshte dhe vreshta të bukura dhe të frytshme. Në një vend të tillë, ku standardet jetësore dhe rrethanat ishin aq të larta, krejt çfarë duhej të bënin ishte që të shprehnin falënderim Allahut. Por, siç thuhet në ajet, ata “i kthyen shpinën (Allahut)”. Pasi ata ishin të “kthyer“ plotësisht prosperitetit të tyre, ata i humbën të gjitha. Siç morëm vesh nga ajeti, vërshimi i Arimit shkatërroi tërë vendin.

Sumerët e lavdishëm

Sumeria ishte një bashkësi e qyteteve-shtete rreth lumenjve Tigër dhe Euftrat ku sot gjendet Iraku jugor. Sot, terreni që duhet përshkuar për në Irakun Jugor është kryesisht shkretinor. Shumica e tokës, përveç qyteteve, dhe regjionet që dikur kanë qenë të pyllëzuara, janë të mbuluara me rërë. Këto shkretëtira, dikur vendbanim i sumerëve, kanë qenë aty me mijëra vite. Vendi i tyre famshëm, që sot mund të hasim vetëm në libra, ishte aq vërtetë sa çdo civilizim bashkëkohor. Këta njerëz ishin të gjallë siç jemi ne



Penda e Ma'ribit ishte punuar me një teknologji shumë të avansuar. Pa marrë parasysh penda u shemb dhe “Përmbytja e Arimit” la të shkretë popullin e Sebës dhe tokën e tyre.

sot, dhe kanë krijuar kryeveprat arkitektonike. Në këtë kuptim, qytetet madhështore të ngritura nga sumerët janë pjesë e trashëgimisë kulturore të ditës së sotme.

Në mesin e asaj çfarë ka mbijetuar nga kultura sumeriane, kemi informata vetëm për zhvillimin e një funerali të mbajtur për Puabin, njërën ndër mbretëreshat e tyre. Përshtypjet nga ky ceremonial madhështor mund të gjenden nga burimet e ndryshme dhe tregojnë se si trupi i vdekur i



Mbretëresha Puabi mund të jetë e varrosur me një pasuri të pamasë, por as ajo nuk e shpëtoi trupin e saj që të shndërrohet në skelet të vetëm.

mbretëreshës ishte stolitur në mënyrë të jashtëzakonshme. Kufoma e saj ishte veshur me rroba të zbukuruar me rruaza të argjendit, arit dhe gurëve të çmuar si dhe me një xhufkë me margaritarë. Në kokën e saj ishte paruka e dekoruar me kurorë të praruar me fleta të arta. Gjithashtu, edhe një sasi e madhe ari ishte vendosur në varr.⁷

Shkurtimisht, mbretëresha Puabi, emër i shquar në historinë sumeriane, ishte varrosur me një thesar të mrekullueshëm. Sipas të dhënave, kjo pasuri e pazakonshme ishin bartur deri në varrezën e saj nga një kortezh rojesh dhe shërbyesish. Mbretëresha Puabi mund të jetë varrosur së bashku me thesar, por as kjo nuk e ka shpëtuar atë që të reduktohet deri në skelet.

Sikurse të gjithë njerëzit e mbretërisë së saj, prej të cilëve ajo ndoshta ka ndier neveri pasi kanë qenë të varfër, trupi i saj është kalbur nën dhe duke u shndërruar në një masë të prishur nga bakteret. Ky është sigurisht një shembull i rëndësishëm që tregon se edhe të pasurit dhe pasuria e kësaj bote nuk janë mjete që të shpëtojnë nga fundi shkatërrimtar.

Minoanët

Toka dhe deti mund të qëndrojnë relativisht qetë me shekuj. Pastaj, trazohen papritmas duke shkaktuar kataklizëm. Ndoshta asnjë ngjarje nuk e përshkruan tmerrin aq qartë sa fatkeqësia e Therës së lashtë. Çfarë ka ndodhur atje mund të përshkruhet si shpërthimi më eksploziv i vullkanit në histori. Duke u ngritur nga deti Egjë para nja 3,500 vjetësh, vullkani i lartë prej një kilometri ka formuar ishullin prej 12 km të gjerë. Atje u ngrit një civilizim madhështor diku rreth 100 km në jug të ishullit të Kretës. Në kulmin e vet, ndoshta 30.000 njerëz banonin në Akrotiri, qyteti kryesor i Therës, në të cilin ishin ngritur pallate me vizatime në mur (freska) nga të cilat largoheshin dhe vinin anije të ngarkuara me mallra për tregti. Derisa studiuesit nuk janë të sigurt për datën e saktë – vlerësuar në diapazonin prej 1470-1628 PER – ata e kanë të njohur renditjen e ngjarjeve. Lëkundje të lehta të tokës të pasuara me tërmet të fort, dhe një eksplozim saqë zëri i është dëgjuar shumë larg, deri në Skandinavi, Gjirin Persik si dhe në shkëmbin e Gjibraltarit.⁸ Valë të mëdha janë ngritur dhe kanë goditur Amnisin, limanin e Knosit. Sot, vetëm gërmadhat kanë mbetur nga pallatet e famshëm.

Civilizimin i Minoanit, njëra ndër civilizimet më të rëndësishme të asaj kohe, sigurisht as që e kanë pritur një përfundim aq të ashpër. Ata njerëz që mburreshin me pasurinë dhe pronën e tyre humben të gjitha që i kishin. Allahu, në Kur'an, nënvizon se fundet e ashpra të civilizimeve të lashta mund të reflektohen tek shoqëritë bashkëkohore:

A nuk e kanë të qartë ata (mekasit) se sa nga popujt para tyre i shkatërroam, që nëpër ato vendbanime të tyre janë kah kalojnë? Është e vërtetë se në ato (vende të shkatërruara) ka fakte, se nuk janë duke dëgjuar me vëmendje? (Sexhde: 26)

Shkatërrimi i Pompejit

Mbeturinat nga Pompeji, për historianët janë dëshmi të qarta për jetën e shthurur që kishte mbretëruar atje. Bile edhe rrugët e Pompejit, si simbol i degjenerimit të Perandorisë Romake, tregojnë për kënaqësitë dhe gëzimet që u bënin në këtë qytet: dikur rrugët e gjalla të vijëzuara me mejhane, klube të natës dhe bordele, ende mund të vërehen edhe pas shkatërrimit duke e paraqitur kështu jetën e tyre të përditshme.

Këtu, në dheun e pasuruar me hi vullkanik, dikur ishin fermtat e begatshme, vreshtat e bollshme dhe vila luksoze. E ndërtuar mes shpateve të Vezuvit dhe detit, Pompei ishte pushimorja më e preferuar e romakëve të pasur që iknin nga zagushia e kryeqytetit. Sidoqoftë, Pompei ka qenë dëshmitar i njërit ndër shpërthimet më të tmerrshme vullkanike, duke e fshirë qytetin nga faqja e dheut. Sot, ajo çfarë ka mbetur nga banorët e qytetit- asfiksimi nga avujt helmues të Vezuvit derisa ata ishin duke bërë punët e përditshme si zakonisht – shumë qartë portretizon detajet që e karakterizonin mënyrën e jetës së romakëve. Fatkeqësia që goditi Pompejin, së bashku me Herkulanin, gjatë një dite vere, tamam në kohën kur regjioni ishte i mbushur përplot me romakë të pasur duke i kaluar pushimet në vilat e tyre të famshme.

Ishte data 24 gusht të vitit 79 të erës së re. Hulumtimet në vend zbulojnë se erupsioni është zhvilluar në disa etapa. Para erupsionit, vendi është dridhur disa herë. Gjëmime të forta dhe të tmerrshme nga larg, shoqëruan këto dridhja. Së pari, Vezuvi vulli një rrëke të avullit dhe hirit. “Pastaj kjo

re u ngjit mbi atmosferë duke bartur me vete shkëmbinjtë të copëtuar nga gryka e vullkanit dhe miliona tonelata, shtuf të ngrirë. Erërat i bartnin retë me hi drejt Pompejit, ku filluan të bien “gurë të vogël”. Derisa tymi mbulonte diellin në tërë qytetin, shtufa dhe hiri filluan që të rigojnë mbi Pompej, duke rënë nga 6 inça në orë”.⁹


Herkulani ishte më afër Vezuvit; shumica e banorëve ikën nga qyteti të tmerruar nga vala e madhe piroklastike që lëvizte me shpejtësi të madhe në drejtim të tyre. Ata të cilët nuk e lëshuan qytetin menjëherë, nuk jetuan aq gjatë sa që të pendohen për vonesën e tyre. Vala piroklastike me të arritur Herkulanin mbyti ata që ngurruan, derisa rrjedha piroklastike e ngadalshme gllabëronte qytetin, duke i varrosur. Gërmimet arkeologjike afër Pompejit, nga ana tjetër, tregojnë se shumica e banorëve kishin ngurruar që të lëshojnë qytetin. Ata mendonin se nuk do të jenë në rrezik pasi Pompeji nuk ishte afër kraterit të vullkanit. Për këtë arsye, shumica e banorëve të Pompejit nuk i lëshuan shtëpitë e tyre dhe përkundrazi ata ikën brenda nëpër shtëpitë dhe dyqanet e tyre, duke shpresuar se fatkeqësia së shpejti do të kalojë. Ata të gjithë u zhdukën para se të kuptojnë se ishte shumë vonë për ta. Për vetëm një ditë, Pompei dhe Herkulani së bashku me gjashtë fshatrat përreth, u fshinë nga harta. Kur’ani tregon për këtë ngjarje ashtu që të përkujtojë të gjithë:

Këto janë disa nga lajmet e vendeve që po t’i rrëfejme ty; disa prej tyre ekzistojnë ende, e disa janë shkatërruar.(Hud:100)

Zbulimi i fshehtësive të Pompejit nuk ishte i mundur deri pas shumë shekujve. Më shumë se vetëm informacion i thjeshtë, gërmimet arkeologjike të këtij qyteti antik tregojnë tregime të qarta për jetën e tyre të përditshme. Forma e shumë viktimave në agoni ishin të ruajtura dhe të padëmtuara. Ajeti në vijim tregon:

Ja, kështu është ndëshkimi i Zotit tënd, kur dënon vendet që janë zullumqare. Vërtet, ndëshkimi i Tij është i dhembshëm e i ashpër. (Hud:102)

Sot, mbeturinat e shumta janë fakte të thjeshta të qytetërimeve komplekse që njëherë ishin në lulëzim të vetin para qindra apo mijëra vjetësh. Shumë nga ndërtuesit e metropoleve të mëdha nga epokat e



**Pompei, një vend i begatisë
dhe madhësisë, shkatërrohet
së bashku me njëzet mijë
banorët e vet.**

ndryshme të historisë janë të panjohur. Pasuria, teknologjia apo puna e tyre nuk i kishte mbrojtur nga fundi i hidhur. Nuk ishin ata por gjeneratat e ardhshme që kishin përfitime nga trashëgimia e tyre e pasur. Me disa informata të shkurtra për të na udhëzuar, origjina dhe fatet e këtyre qytetërimeve të lashta janë misterioze edhe sot. Sidoqoftë dy gjëra janë



Gjendja e agonisë së shumë banorëve të Pompeit janë ruajtur si paralajmërim për gjeneratat e ardhshme.

evidente: ata mendonin se kurrë nuk do të vdesin dhe ishin të dhënë pas kënaqësive të kësaj bote. Ata lënë prapa monumente madhështore duke besuar se ashtu do të arrihet përjetësia. Jo më pak se këto civilizime, shumë grupe njerëzish sot kanë të njëjtën mendësi. Duke pritur që të bëjnë emrat e tyre të përjetshëm, shumica e njerëzve të shoqërive moderne janë të përkushtuar ndaj asaj që të akumulojnë sa më shumë pasuri apo që të lënë vepra prapa sa më të mëdha. Bile, duket se ata më shumë bëjnë jetë ekstravagante sesa gjeneratat e mëhershme dhe mbesin të shkujdesur ndaj shpalljeve të Allahut. Ka shumë mësim që mund të nxirren nga qëndrimi social dhe përvojat e popujve të lashtë. Asnjëra nga këto bashkësi të hershme nuk kanë mbijetuar. Punimet artistike dhe monumentet që ata kanë lënë prapa mund tu kenë ndihmuar atyre që të përkujtohen nga gjeneratat e ardhshme, por nuk kanë mundur që t'i shpëtojnë nga dënimi hyjnor apo që të ndalojnë trupat e tyre të mos kalben. Mbetjet e tyre mbeten aty vetëm që të mbesin si përkujtues dhe vërejtje për zemërimin e Allahut ndaj atyre që ishin kryeneç dhe jofalënderues për pasuritë që u kishte dhuruar nga Ai.

Padyshim mësimet e nxjerra nga këto ngjarje historike duhet që të na japin mend. Vetëm atëherë dikush mund të kuptojë se çfarë u ka ndodhur shoqërive të hershme nuk ishte e paqëllimshme. Dikush mund të kuptojë më tutje se vetëm Allahu Fuqiplotë ka fuqi që të krijon fatkeqësi të çfarëdoshme në çdo çast. Bota është vend ku njerëzit janë vënë në sprovë. Ata që i binden Allahut do të fitojnë shpëtimin. Ata që janë të kënaqur me këtë botë, në anën tjetër, do të jenë të privuar nga amshimi i bekuar. Padyshim, fundi i tyre do të jetë sipas veprave të tyre dhe ata do të gjykohen sipas punëve të tyre të kryera. Sigurisht, Allahu është Gjyqtari më i Mirë.

VENDBANIMI I VËRTETË I NJERIUT: AHIRETI



Shumë njerëz mendojnë se është e mundur që të jetohet një jetë e përsosur në këtë botë. Duke u bazuar në këtë pikëpamje, jeta e kënaqshme në këtë botë mund të arrihet përmes përparimit material, që së bashku me përmbushjet e obligimeve në shtëpi si dhe arritja e një statuti të lartë shoqëror në përgjithësi konsiderohen si gjërat fundamentale të një jete të përsosur.

Sidoqoftë sipas pikëpamjeve të Kur'anit, “jeta e përsosur” – dmth, jeta pa asnjë problem – nuk është e mundur në këtë botë. Kjo është ashtu sepse jeta në këtë botë është e dizajnuar në atë mënyrë që të jetë jo e përsosur.

Origjina e fjalës arabe për botën – dynja – ka kuptim të rëndësishëm. Etimologjikisht, rrjedh nga rrënja e fjalës danji, që dmth. “i thjeshtë”, “inferior”, “i poshtëm” dhe “i pavlerë”. Prandaj, fjala “botë” në arabishtë trashëgimish përmban këto cilësi.

Parëndësia e kësaj jete është theksuar shumë herë më herët në këtë libër. Në të vërtetë, të gjithë faktorët që besohet se e bëjnë jetën të mrekullueshme – pasuria, sukcesi personal dhe afarist, martesë, fëmijët etj, – nuk janë gjë tjetër vetëm mashtrime të kota. Këtë e tregon edhe ajeti vijues:

Ju njerëz dinie se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por

edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga All-llahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues. (Hadid: 20)

Në ajetin tjetër, Allahu jep shpjegim për animin e njeriut më shumë për këtë botë se sa për ahiret:

Po ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote, e dihet se jeta e botës tjetër është më e dobishme dhe e përjetshme. (A'la: 16-17)

Problemet shfaqen vetëm për shkak se njerëzit e vlerësojnë shumë lartë këtë botë, në vend se të vlerësojnë ahiretin. Ata janë të kënaqur me atë se çfarë kanë në këtë botë. Qëndrim i tillë nuk do të thotë asgjë tjetër përpos largimit nga premtimi i Allahut dhe si rrjedhim nga e vërteta për ekzistimin e Tij. Allahu thotë se përfundim i hidhur do t'i pret ata:

Ata që nuk presin takimin Tonë, që janë të kënaqur me jetën e dynjasë dhe kanë gjetur prehje në të, dhe ata që janë indiferentë ndaj argumenteve tona. (Junus: 7)

Natyrisht, pa-përsosmëria e kësaj jete nuk do të thotë se nuk ka gjëra të bukura në tokë. Por këtu në tokë, çfarë mendohet të jetë e bukur, mahnitëse, e kënaqshme dhe tërheqëse qëndron shumë afër me imperfektin, të shëmtuarën dhe të çalën. Në këtë botë, e mira dhe e keqja janë të përziera. Kjo nuk është gjë tjetër vetëm sikur përkujtues për xhennetin dhe xhehennemin. Në të vërtetë, nëse vështrohet me një mendje të pastër dhe të arsyeshme, këto fakte mund të bëjnë që njeriu të kuptojë të vërtetën e ahiretit. Sipas Allahut, jeta e cila menduar si e mira dhe e dobishme në të vërtetë është jeta e ahiretit.

Allahu i urdhëron shërbëtorët e Tij besnikë që të bëjnë përpjekje serioze që të fitojnë xhennetin në ajetin e mëposhtëm:

Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për në një Xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. (Ali Imran:133)

Ata që nxitojnë për në Xhennet

Në Kur'an, besimtarëve u është dhënë sihariq për shpërblimin dhe kënaqësinë e amshueshme. Sidoqoftë, ajo që zakonisht shpërfilllet është fakti që lumturia dhe kënaqësia e amshueshme fillon derisa jemi ende në

këtë botë. Kjo është për shkak se, edhe në këtë botë, besimtarët nuk janë të privuar nga përkrahja dhe dashamirësia e Allahut.

Në Kur'an, Allahu thotë se besimtarët e vërtetë që angazhohen në vepra të mira në këtë botë do të gjejnë banesë të mrekullueshme në ahiret:

Kush bën veprë të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. (Nahl: 97)

E si shpërblim dhe burim i lumturisë, në këtë botë Allahu dhuron shumë të mira si dhe mundësi të rralla për besimtarët e Tij të vërtetë. Ky është ligj i pandryshueshëm i Allahut. Pasi pasuria, bukuria dhe madhështia janë karakteristikë themelore të xhennetit, Allahu u jep pasuri besimtarëve të Tij të sinqertë edhe në këtë botë. Ky sigurisht është fillimi i jetës së ndershme dhe të qetë që kurrë nuk do të përfundojë.

Vendet e bukura dhe ornamentet e kësaj bote nuk janë asgjë tjetër përpos jehona imperfekte të atyre në xhennetin e vërtetë. Ekzistenca e tyre bën që besimtarët e vërtetë të mendojnë për parajsën dhe të ndiejnë një dashuri edhe më të thellë për të. Nga ana tjetër, gjatë tërë jetës së tij, është shumë e mundur që besimtari të përjetojë shqetësime serioze dhe pikëllim, por sidoqoftë besimtarët e vërtetë vendosin besimin në Allahun dhe me durim kalojnë çdo dhimbje dhe hidhërim që mund t'iu bjerë. Bile, duke qenë të vetëdijshëm se kjo është mënyra se si të fitohet kënaqësia e Allahut, dhe ky qëndrim bën që ata të ndiejnë një lehtësi në zemrat e tyre.

Besimtar është ai që vazhdimisht është i vetëdijshëm për ekzistimin e Krijuesit të tij. Ai i bindet urdhrave të Allahut dhe është i kujdesshëm që të jetojë asi jete siç është përshkruar në Kur'an. Ai ka shpresë dhe besim real për jetën e tij pas vdekjes. Pasi besimtari vë besimin e tij në Krijuesin e tij, Allahu ia lehtëson zemrën e tij nga të gjitha mizoritë dhe vuajtjet.

Çfarë është edhe më e rëndësishme, besimtari, në çdo moment, ndien udhëzimin dhe përkrahjen nga Krijuesi i tij. Kjo në të vërtetë është gjendje e qetë shpirtërore që është si pasoj e dijës se Allahu është me të çdoherë kur falet, punon vepra të mira, apo bën diçka – të rëndësishme apo të parëndësishme – vetëm që të fitojë kënaqësinë e Allahut.

Kjo sigurisht është ndjenjë e sigurisë duke inspiruar zemrën e besimtarit i cili kupton se “ai ka përcjellës (engjëj) një pas një, para tij

dhe prapa tij, që me urdhrin e All-llahut e ruajnë atë. (Rra'd:11) dhe kjo do të jetë fitimtare në luftën e tij në emër të Allahut, dhe ai do të merr lajme të mira për shpërblimin e amshueshëm: xhennetin. Kështu, besimtarët e vërtetë kurrë nuk frikohen apo pikëllohen, sipas inspirimit nga Allahu të dhënë engjëjve “Unë jam me ju, pra, inkurajoni ata që besuan!” (Enfal:12).

Besimtarë janë ata që thonë “Zoti ynë është All-llahu, pastaj nuk u luhatën, atyre u zbresin melaiket (në prag të vdekjes dhe u thonë): “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni, keni myzhde Xhennetin që ju premtuhej!”(Fussilat: 30). Besimtarët janë të vetëdijshëm se Krijuesi i tyre “as që obligon ndoken çka nuk ka mundësi (të veprojë).“ (A’raf: 42). Ata shumë mirë e dinë se “Allahu çdo send e ka krijuar me masë të caktuar.” (Kamer: 49). Në këtë mënyrë, ata janë ata që thonë: “Thuaj: “Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga All-llahu; Ai është ndihmëtar yni”. Prandaj, vetëm All-llahut le t’i mbështeten besimtarët. “ (Teube:51). Dhe thonë “neve na mjafton që kemi All-llahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!”. (Ali Imran:173-174). Sidoqoftë, pasi bota është vend i sprovës për njeriun, besimtarët gjithsesi duhet që të ballafaqohen me disa vështirësi. Uria, etja, humbja e pasurisë, sëmundja, fatkeqësitë etj, gjithashtu mund t’i godasin në çdo kohë. Varfëria si dhe vuajtje tjera mund t’u bien atyre. Në Kur’an përshkruhet lloji i sprovës nëpër të cilin mund të që kalojë besimtari:

Po ju menduat se do të hyni në Xhennet, pa u sprovuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i dërguari thoshte, e me te edhe ata që kishin besuar: “Kur do të jetë ndihma e All-llahut?!” Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e All-llahut është afër!” (Bekare: 214)

Natyrisht, fatkeqësitë kurrë nuk e kanë ndryshuar respektin dhe frikën e profetit dhe ashabëve të tij që kishin për Allahun. Kurrfarë ndryshimi në qëndrimin e tyre kurrë nuk ka ndodhur kur ballafaqoheshin me hallet e tyre. Allahu, gjithashtu, u jep besimtarëve lajm të gëzuar për përkrahjen e Tij në ajetin: “Me të vërtetë, ndihma e Allahut (gjithmonë) është afër”. Si rrjedhim, “All-llahu do t’i shpëtojë me atë suksesin e tyre ata, që kishin qenë të ruajtur. Ata nuk do t’i kapë e keqja e as nuk do të jenë të shqetësuar. “ (Zumer: 61)

Besimtarët e dinë se kohërat e vështira janë të krijuara posaçërisht dhe

përgjegjësi e tyre është që të reagojnë me durim dhe qëndrueshmëri në to. Bile këto janë mundësi të mëdha që të tregohet këmbëngulja dhe përkushtimi ndaj Allahut dhe këto janë mjete që të fitohet pjekuri personale. Në këtë mënyrë, besimtari bëhet më i lumtur, më i emocionuar dhe më shumë i angazhuar pas rasteve të tilla.

Sidoqoftë, qëndrimi i jobesimtarëve është krejtësisht tjetër. Kohërat e vështira i vejnë në pikëllim. Ndryshe nga dhimbja fizike, jobesimtari gjithashtu vuan edhe nga shqetësimi mental.

Frika, humbja e shpresës, pesimizmi, pikëllimi, brenga, shqetësimi dhe trazimi janë disa nga tiparet karakteristike të jobesimtarëve në këtë botë e që janë vetëm version i zbehtë i dhimbjes reale që ata do të vuajnë në botën e mëpastajme. Allahu “zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë.” (En’am:125).

Nga ana tjetër, ata që janë besimtarë të vërtetë që kërkojnë falje dhe pendohen tek Allahu janë pranuesit e mirëdashjes dhe përkrahjes së Allahut në këtë botë siç tregohet në ajetin e ardhshëm:

E të kërkonit falje Zotit tuaj dhe pendohuni (kthehuni) te Ai, se Ai do të ju mundësojë përjetime të mira (në këtë jetë) deri në një afat (të caktuar) dhe çdo punëmiri i jep shpërblimin e merituar. Në qoftë se refuzojnë (të kërkojnë falje), unë pra kam frikë për ju, dënimin e ditës së madhe. (Hud: 3)

Në një ajet tjetër, jeta e besimtarëve përshkruhet kështu:

A tyre që patën frikë nga (dënimi) All-llahu, u thuhet: “Ç’është ajo që shpalli Zoti juaj?” Ata thoshin: “Shpalli çdo të mirë!” Ata që bënë vepra të mira, edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshmëve. (Nahl: 30)

Ahireti është sigurisht më superiore dhe më i mirë se kjo botë. Duke krahasuar me ahiretin, kjo botë është vetëm vend i poshtër dhe krejtësisht i pavlefshëm. Prandaj, nëse dikush dëshiron që të vendos një cak për vete, ai cak do të duhej të jetë parajsja në ahiret Ai gjithashtu duhet të mbajë në mend se ata që synojnë parajsën do të kenë mirëdashje dhe përkrahje nga Krijuesi i tyre edhe në këtë botë. Por ata që synojnë këtë botë të pabindur

ndaj Allahut shpesh nuk fitojnë asgjë nga vlera e saj si dhe vendbanimin e jetës së ardhshme të tyre është ferri.

Xhenneti (parajsa)

Allahu u premtom parajsën atyre që i afrohen pranisë së Tij si besimtarë. Sigurisht, Allahu do ta mbajë premtimin. Njerëzit që e kanë besimin e sigurt, e dinë se Krijuesi i tyre do ta mbajë premtimin dhe se ata do të pranohen në parajsë pasi kanë qenë besimtarë të vërtetë në këtë botë:

Ato janë Xhennetet e Adnit, që Mëshiruesi u pat premtuar robve të vet, pa i parë ata (i besuan pa i parë), e premtimi i Tij është i kryer. (Mejrem: 61)

Çasti i hyrjes në parajsë është momenti më i rëndësishëm për ata që besuan dhe bënë vepra të mira. Gjatë tërë jetës së tyre, ata janë përpjekur për këtë gjë, janë lutur dhe kanë bërë veprat e duhura që ta fitojnë. Në prani të Allahut, është vendi më i mirë për të qëndruar dhe vend i vërtetë që të fitohet: parajsa; vend i përgatitur enkas për besimtarët. Allahu e përshkruan këtë çast të papërsëritshëm në ajetin e ardhshëm:

Përfundimi i mirë është Xhennete të Adnit (vende të përjetshme) ku do të hyjnë ata, edhe prindërit, gratë dhe fëmijët e tyre të cilët kanë qenë veprimtarë ata do t'i vizitojnë engjëjt duke hyrë në secilën derë. (u thonë) Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin; sa përfundim i lavdishëm është ky vend. (Rad: 23-24)

Bukuria e Parajsës

Shembulli (atributi) i xhennetit që u është premtuar të devotshmëve është: që nën (pallatet) të rrjedhin lumenj, që ushqimi në të dhe hija në të është e përhershme. Ai është përjetim i lumtur i atyre që ishin të ruajtur, e përfundimi i jobsimtarëve është zjarri. (Rad: 35)

Një pamje e mrekullueshme e liqeve, lumenjve dhe një gjelbërim për bukuri është një lloj parajse e imagjinuar nga njeriu i zakonshëm. Mirëpo ky përfytyrim i parajsës duhet sqaruar pasi nuk shpreh saktësisht pikëvështrimin kur'anor. Është më se e vërtetë se parajsa ka bukuri domethënëse; por ambient aq të këndshëm vetëm përshkruan aspektin e saj

estetik dhe tërheqës. Për këtë shkak në Kur'an përmenden shtëpi të mahnitshme, kopshte të bukura dhe lumenj të pasur. Mirëpo të kufizuarit e parajsës në një madhësi fizike do të del se është paraqitur në mënyrë joadekuate ndaj realitetit.

Bukuria dhe madhështia e parajsës janë përtej imagjinatës së njeriut. Fjalët në Kur'an "(të mira) plot degë me gjethe e pemë." (Rahman: 48) me të vërtetë ilustron një pamje të gjallë të natyrës së vërtetë të parajsës. Çfarë mendohet për "të mirat" janë gjërat të krijuara posaçërisht nga Allahu i Gjithëdijsmi. Këto të mira mund të jenë shpërblime apo gjëra që njeriut i japin aq kënaqësi sa që qenia njerëzore nuk ka paramenduar ndonjëherë. Premtimi i Allahut "**ata kanë te Zoti i tyre çka të dëshirojnë; e kjo është ajo dhuntia e madhe.**" (Shura:22) e thekson se si e mirë e Allahut, imagjinata e besimtarëve do të formojë një parajsë sipas dëshirave dhe shijeve të veta.

Banesa e përhershme e besimtarëve

Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhennete nën të cilët rrjedhin lumenj, në të do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhennetin e Adnit, edhe një disponim nga All-llahu që është mbi të gjitha. Ky, pra është ai shpëtimi i madh. (Teube: 72)

Në këtë botë, besimtarët jetojnë "në shtëpitë (xhamitë) që All-llahu lejoi të ngritën, e që në to të përmendet emri i Tij" (Nur: 36) Me urdhrin e Allahut, këto banesa mbahen pastër dhe me përkujdesje të veçantë.

Në mënyrë të njëjtë janë edhe banesat në parajsë; ato janë të vendosura aty ku Allahu madhërohet dhe emri i Tij gjithmonë mbahet në mend.

Gjithashtu edhe vila të mëdha në vende të bukura, banesat e besimtarëve në këtë botë mund të jenë punime nga dizajni dhe arkitektura e fundit moderne, të ndërtuara në qytete të bukura.

Banesat në parajsë që përshkruhen në Kur'an, zakonisht gjenden pranë bukurive natyrore:

Ndërkaq, ata që u ruajtën për hir të Zotit të tyre, për ta do të ketë dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën, nën të cilat rrjedhin lumenjtë (e të mirave). Premtimi i All-llahut, e All-llahu nuk e thyen premtimin. (Zumer: 20)

Dhomat e përmendura në ajetin e mësipërm, nën të cilat rrjedhin lumenj, mund të kenë dritare të gjëra apo korridore të rrethuara me mure xhami për të mundësuar shikimin e kësaj pamje të bukur. Këto janë shtëpi të dekoruara bukur me frone të dizajnuara posaçërisht për komfortin e besimtarëve. Ata do të pushojnë mbi këto frone që janë të vendosura në radhë dhe do të kënaqen në begatinë e frutave të shijshme dhe lloje të ndryshme të pijeve. Dizajni dhe dekorimi i vilave janë nga materiali dhe tekstili më kualitativ. Divane të rehatshme me brokadë mëndafshi dhe fronet janë të cekura posaçërisht në shumë ajete:

Janë në shtretër të qëndisur me ar. Të mbështetur në to përballë njëri-tjetrit. (Wakia: 15-16)

Ata janë të mbështetur në kolltukë të renditur (dhe pruar me ar dhe gurë të çmueshëm) dhe Ne u shoqëruam atyre hyri symëdha. (Tur: 20)

Siç sugjerojnë edhe ajetet, kolltukët janë simbol i dinjitetit, madhësisë dhe pasurisë. Allahu do që shërbëtorët e vet t'i vendosë në banesa të shkëlqyera në parajsë. Në ambient aq të mrekullueshëm, besimtarët vazhdimisht përmendin Allahun dhe përsërisin fjalën e Tij:

Xhennetet e Adnit janë që do të hyjnë në to, aty do të stolisen me byzylyk nga ari e margaritari, e petkat e tyre janë të mëndafshta. E ata thonë: “Falënderuar qoftë All-llahu që largoi prej nesh brengat; vërtet, Zoti ynë është që falë shumë dhe është bamirës. I cili nga mirësia e Tij na vendosi në vendin e përjetshëm, ku nuk do të na prekë ndonjë mundim fizik dhe ku nuk na prek ndonjë molisje. (Fatir: 33-35)

Materiali bazë i parajsës është “punë me shumë hijeshi” dhe “me bukuri të shquar”. Këto janë të gjitha shëmbëllimet e inteligjencës përfundimtare dhe artit të Allahut. P.sh., kolltukët janë të pruar me ar dhe me gurë të çmuar. Kolltukët nuk janë të zakonshëm por janë madhështorë. Rrobat janë nga mëndafshi dhe materiali i çmueshëm. Bile, stolitë e argjendit dhe të arit do të jenë të dorës së dytë në krahasim me veshjen e çmuar. Në Kur'an, Allahu jep shumë detaje në lidhje me parajsën, megjithëse nga këto përshkrime është e qartë se çdo besimtar do të kënaqet në kopsht të punuar sipas imagjinatës së vet. Padyshim, Allahu do të dhurojë shumë gjëra tjera mahnitëse për shërbëtorët e Vet të dashur.

Kopsht përtej imagjinatës

Atyre u shërbejnë me enë e gastare nga ari, aty do të kenë çka t'u dëshirojnë shpirti dhe t'u kënaqet syri. Ju do të jeni aty përgjithmonë.
(Zuhruf: 71)

Nga përshkrimet dhe ilustrimet që janë në Kur'an, mund të krijohet një pasqyrë e përgjithshme e të kuptuarit se si duket parajsja. Në ajetin: “Saherë që u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: **“Ky është që me te u ushqyem edhe më parë”** (Bekare: 25) Allahu thotë se të mirat në parajsë do të jenë krejtësisht të ngjashme si në këtë botë. Në pajtim me përshkrimin e ajetit **“Dhe do t'i shtie në Xhennetin, të cilin ua ka bërë të njohur atyre.”** (Muhammed: 6), kështu që ne mund të arrijmë në përfundim se Allahu do tu lejojë besimtarëve të banojnë në xhennet për të cilën kanë qenë të njoftuar më parë.

Sidoqoftë, çdo informatë që mund të mbledhim për parajsën në këtë botë duhet patjetër të jetë joadekuate; pasi ajo mund të jep vetëm disa të dhëna të përafërta për të pasqyruar pamjen e përgjithshme. **“Shembulli i Xhennetit, i cili u është premtuar atyre që janë ruajtur (të devotshëm) në të cilin ka lumenj me ujë për pije, lumenj nga qumështi me shije të paprishur, lumenj nga vera e shijshme për njerëz, lumenj nga mjalti i kulluar.”** (Muhammed: 15). Ky ajet na e bën të qartë se parajsja është një vend përtej imagjinatës sonë. Në shpirtin e njeriut, ky ajet na e bën të mendojmë se është një vend me pamje të papritur.

Nga ana tjetër, Allahu e përshkruan parajsën si “një zbavitje” apo “festë”:

Por ata që ia patën frikën Zotit të tyre, ata i kanë xhennetet nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe aty janë përgjithmonë. Ajo është pritje nga ana e All-llahut, e për të mirët më e dobishmja është ajo që është tek All-llahu. (Ali-Imran: 198)

Në këtë ajet, Allahu paraqet parajsën si një vend të kënaqësisë dhe zbavitjes. “Fundit” i kësaj jete, kënaqësia e të kaluarit “të sprovës” dhe fitimi i vendeve më të mira në të cilat do të banohen përgjithmonë, janë sigurisht çështje për besimtarët që të gëzohen. Festimi do të jetë i mrekullueshëm: që nuk i përngjanë asnjë feste në këtë botë. Është e sigurt se do të bëhet një festim ndryshe prej traditës dhe zakoneve të njohura për ne nga popujt e mëparshëm dhe ata të sotëm.

Në jetën e amshuar, fakti që besimtarët do të shijojnë kënaqësi të ndryshme dhe të pashtershme na sjell në mend një karakteristikë të rëndësishme të besimtarëve në parajsë: kurrë nuk do të ndjejnë lodhje. Në Kur'an kjo ndjenjë përshkruhet me fjalë e thëna nga besimtarët: "...I cili nga mirësia e Tij na vendosi në vendin e përjetshëm, ku nuk do të na prekë ndonjë mundim fizik dhe ku nuk na prek ndonjë molisje.“ (Fatir: 35)

Padyshim, atje besimtarët nuk do të lëngojnë nga lodhja mendore. Përndryshe nga parajsja ku **“ata aty nuk i godet kurrfarë lodhje”** (Hixhr: 48), njeriu në këtë botë ndien lodhje pasi trupi i tij nuk është krijuar i fortë. Kur dikush ndihet i lodhur, është vështirë që të koncentrohet dhe të marrë vendime racionale. Për shkak të lodhjes, perceptimet ndryshohen. Sidoqoftë, gjendja e tillë shpirtërore nuk ekziston në parajsë. Të gjitha shqisat mbeten të mprehta duke i perceptuar krijimet e Allahut në mënyrën më të mirë. Besimtarët janë plotësisht të liruar nga çdo ndjenjë e lodhjes, prandaj, ata i shijojnë dhuratat e Allahut pa pengesa. Kënaqësia dhe argëtimi janë të pakufishme dhe të amshueshme.

Në një ambient ku lodhja dhe mërzia nuk ekzistojnë, Allahu shpërblen besimtarët me krijimin e “çfarëdo që ata dëshirojnë”. Në të vërtetë, Allahu u jep lajme të mira se ai do të krijon më shumë se ata mund të marrin me mend: “Ata aty kanë çka të dëshirojnë, e te Ne ka edhe më shumë.”(Kaf: 35).

Duhet pasur në mendje se njëra ndër dhuratat e parajsës është se “ata i shpëtoi (All-llahu) prej vuajtjeve të Xhehennemit.” (Duhan: 56) dhe “ata nuk nuk do të dëgjojnë as zhurmën e tij (të Ferrit).” (Enbia: 102)

Çfarëdo që dëshirojnë, nga ana tjetër, besimtarët do të kenë mundësinë që të shohin dhe të flasin me njerëzit në ferr. Ata janë falënderues edhe për këtë kënaqësi:

(Këta) Thonë: “Ne edhe kur ishim në familjet tona, ishim ata që frikësoheshim. E All-llahu na dhuroi të mira dhe na ruajti prej dënimit të erës (flakës) së nxehtë të zjarrit. Ne më parë ishim ndër ata që lutëm Atë, e Ai është bamirës, mëshirues”. (Tur: 26-28)

Parajsja përshkruhet në Kur'an si vijon: “Dhe kur të shikosh aty, sheh begati të mëdha e zotërim (pronë, pasuri) të madh.” (Insan: 20) Këtu, sytë shijojnë dhe kënaqën nga perspektiva tjetër, në dimensione tjera. Çdo skaj

dhe pikë është stolitur me ornamente të çmuara. Kjo madhështi është vetëm për besimtarët që Allahu i ka mëshiruar me mëshirën e Tij dhe të cilëve u ka dhuruar Kopshtin e Tij. **“Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar”** (Hixhr: 47) Aty do të jenë përgjithmonë, e nuk kërkojnë të largohen nga ai (ose t'u ndryshohet). (Kehf: 108)

Dhurata më e çmuar e Allahut: Vullneti i Tij i Mirë

Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhennete nën të cilët rrjedhin lumenj, në to do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhennetin e Adnit, edhe një disponim nga All-llahu që është mbi të gjitha. Ky, pra është ai shpëtimi i madh. (Teube: 72)

Në faqet paraprijëse, i përmendëm dhuratat e çmuara që Allahu i dhuron njeriut në parajsë. Është evidente se parajsja është vend që i përmban të gjitha kënaqësitë që njeriu mund të përjetojë me pesë shqisat e tij. Mirëpo, cilësia superiore e parajsës është vullneti i mirë i Allahut. Për besimtarët, fitimi i kënaqësisë së Allahut bëhet burim i madh i kënaqësisë dhe paqes në ahiret. Bile, duke parë dhuratat e Allahut dhe duke qenë falënderues ndaj Allahut për bujarinë e Tij i bën ata të ndjehen të lumtur. Në Kur'an, besimtarët në parajsë përshkruhen si në vijim:

... All-llahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Ky është shpëtim i madh. (Maide: 119)

Të mirat e parajsës aq të vlefshme i bën kënaqësia e Allahut. Të mirat e njëjta mund të ekzistojnë edhe në këtë botë, por kënaqësia e Allahut nuk është e përfshirë këtu, besimtarët nuk mund të shijojnë këto të mira. Kjo është çështje shumë e rëndësishme me të cilën njerëzit duhet ta vrasin mendjen. Ajo që në të vërtetë i bën këto të mira të çmuara është diçka përtej kënaqësisë që jep. Ajo që me të vërtetë është e rëndësishme, është fakti se Allahu e ka dhuruar atë të mirë.

Besimtari që ka përfitim nga e mira e tillë dhe është falënderues ndaj Krijuesit të tij e nxjerr kënaqësinë kryesore të tij duke e ditur se kjo është bujari e Allahut. Kënaqësia mund të gjendet vetëm nga fakti se Allahu e mbron atë, e donë dhe se Krijuesi i Tij e mbulon me Mëshirën e Tij.

Prandaj, zemra e njeriut pranon vetëm kënaqësinë nga parajsja. Ai është krijuar që të jetë shërbëtor i Allahut dhe prandaj ai pranon vetëm kënaqësitë nga bujaria e Tij.

Për këtë shkak “Parajsja në tokë”- si utopi e jobesimtarëve- kurrë nuk mund të ekzistojë në këtë botë. Edhe nëse çdo gjë që ekziston në parajsë të mblidhej dhe të vendosej në këtë botë, prapë do të ishte e pakuptimtë pa kënaqësinë e Allahut.

Shkurtimisht, parajsja është dhuratë e Allahut për shërbëtorët e Tij të sinqertë dhe për këtë arsye kjo është e rëndësishme për ta. Pasi “... ata janë rob të ndershëm! “ (Enbia: 26) ata e arrijnë kënaqësinë dhe lumturinë a amshuar. Fjalët e besimtarëve në parajsë janë “i lartësuar është emri i Zotit tënd, të madhëruar e të nderuar!” (Rrahman: 78)

Ferri

Vendi, ku jobesimtarët do të mbesin përgjithmonë është krijuar posaçërisht që t'u shkaktojë dhimbje në trupin dhe shpirtin e njeriut. Kjo është kështu vetëm për shkak se jobesimtarët janë fajtorë për një gabim të madh dhe drejtësia e Allahut bie si dënim mbi ta.

Duke qenë jo-falënderues dhe përbuzës ndaj Krijuesit, Atij që i jep njeriut shpirt, është ndër veprat më të liga që mund të bëhen në tërë gjithësinë. Prandaj, në ahiret do të ketë dënim të hidhur për këtë gabim të tmerrshëm. Për këtë qëllim shërben ferri. Njeriu është krijuar që të jetë shërbëtor i Allahut. Nëse ai e mohon qëllimin kryesor të krijimit të tij, atëherë ai do të merr atë që e meriton. Allahu për këtë thotë në ajetin vijues:

... e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehennem. (Gafir: 60)

Pasi shumica e njerëzve do të dërgohen në xhehennem edhe dënimi është i përherëshëm dhe i amshueshëm, atëherë qëllimi kryesor, synimi themelor i njerëzimit është që t'i ikin xhehennemit. Kërcënimi më i madh ndaj njeriut është xhehennemi dhe nuk ka asgjë tjetër më të rëndësishme sesa shpëtimi i shpirtit nga xhehennemi.

Pavarësisht nga kjo, gati të gjithë njerëzit jetojnë në një gjendje të pavetëdijshme. Ata preokupohen me problemet e përditshme. Ata punojnë

me muaj, vite, bile me dekada për çështje të parëndësishme duke mos menduar kurrë për kërcënimin më të madh që u kanoset, rreziku më kërcënues ndaj ekzistencës së tyre të amshueshme. Xhehennemi është shumë afër tyre; e ata ende janë të verbër që të shohin atë:

Njerëzve u është afruar koha e llogarisë së tyre, e ata të hutuar në pakujdesi nuk përgatiten fare për të. Atyre nuk u vjen asnjë këshillë e re (në Kur'an) nga Zoti i tyre, e që ata të mos tallen me të duke e dëgjuar. Të shmangura nga e vërteta janë zemrat e tyre. (Enbia: 1-3)

Njerëzit e tillë angazhohen në punë të kota. Ata e kalojnë tërë jetën duke vrapuar pas qëllimeve imagjinare. Më së shumti caqet e tyre janë ngritja në pozitë në vendin e punës, martesë, posedimi i një “familjeje të lumtur”, fitimi i madh i të hollave apo përkrahja e ndonjë ideologjie të padobishme. Duke i bërë këto gjëra, këta njerëz janë të pavetëdijshëm për kërcënimin e madh që iu kanoset. Për këta njerëz xhehennemi është një vend i imagjinuar.

Në të vërtetë, xhehennemi është më real se kjo bota. Pas një kohe bota do të pushojë së ekzistuari, ndërsa xhehennemi do të mbes përgjithmonë. Allahu, Krijuesi i gjithësisë e botës dhe i të gjithë baraspeshave delikate në natyrë, njësoj e ka krijuar ahiretin, parajsën dhe ferrin. Dënim i hidhur iu është premtuar të gjithë jobesimtarëve dhe hipokritëve:

Por, mjaft është për ta Xhehennemi në të cilin hidhen. Sa vend i shëmtuar është ai. (Muxhadele: 8)

Xhehennemi, vend më i shëmtuar që mund të imagjinohet, është burim i mundimeve të dukshme. Ky mundim dhe dhimbje nuk është e ngjashëm me ndonjërin nga dhimbjet e kësaj bote. Është më intensive se çdo dhimbje apo mizori që dikush ka mundur ndonjëherë të përjetojë në këtë botë. Sigurisht është punë e Allahut, i Lartë në Mençuri.

E vërteta e dytë për xhehennemin është se, për çdokënd, kjo torturë është e përjetshme dhe e amshueshme. Shumica e njerëzve në këtë shoqëri injorante kanë zakonisht ide të gabuar lidhur me xhehennemin: ata mendojnë se ata do të “vuajnë dënimin e tyre” në xhehennem për një kohë të caktuar e pastaj do të falen. Ky është vetëm mendim nga dëshira e tyre. Kjo bindje është e përhapur veçanërisht tek ata që e konsiderojnë veten besimtar por që nuk i kryejnë

detyrimet e veta ndaj Allahut. Ata mendojnë se mund të kënaqen me kënaqësitë e kësaj bote sa të donë. Sipas besimit të njëjtë, ata do të fitojnë xhennetin pas dënimit të marrë në xhehennem për një kohë. Mirëpo, fundi që i pret ata është më i dhembshëm sesa ata mendojnë. Xhehennemi sigurisht është vend i torturës së përjetshme. Në Kur'an, shpesh është theksuar se dënimi për jobesimtarët është i vazhdueshëm dhe i përjetshëm. Ajeti në vazhdim e sqaron këtë fakt: “Aty do të mbesin për tërë kohën (pa mbarim).” (Nebe: 23)

Duke qenë jo-falënderues dhe mohues ndaj Krijuesit i cili “**ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues.**” (Nahl: 78) me të vërtetë e meritojnë dënimin e përjetshëm. Arsyetimet që dikush i paraqet nuk do ta shpëtojnë nga xhehennemi. Vendimi i dhënë për ata që shfaqin indiferencë – apo edhe më keq, armiqësi – ndaj religjionit të Krijuesit të Vet është i padyshimtë dhe i pandryshueshëm. Në botë, ata ishin arrogantë dhe nuk iu kanë nënshtuar Allahut të Plotfuqishëm. Ata ishin gjithashtu edhe armiq të përbetuar të besimtarëve. Në ditën e gjykimit do të dëgjojnë këtë:

Andaj, hyni në dyert e xhehennemit, aty do të jeni përjetë: sa vend i keq është ai i kryelartëve!” (Nahl: 29)

Karakteristika më trishtuese e xhehennemit është natyra e përjetshme e tij. Nëse hyrët njëherë në xhehennem, nuk ka më kthim prapa. Realiteti i vetëm është xhehennemi me shumë lloje të torturimeve. Të ballafaquarit me torturë të tillë të përjetshme, njeriu bie në një gjendje të pashpresë. Ai nuk ka shpresa më. Kjo gjendje është e përshkruar në këtë mënyrë në Kur'an:

E ata që nuk respektojnë All-llahun, skutë e tyre është zjarri. Sa herë që të tentojnë të dalin nga ai, kthehen në të dhe atyre u thuhet: “Shijoni dënimin e zjarrit që ju e konsideroni rrenë. (Sexhde: 20)

Vuajtjet në Xhehennem

Ndërsa ata që nuk i besuan argumentet Tona, ata janë të të majtës. Kundër tyre është zjarri i mbyllur. (Beled: 19-20)

Në ditën e gjykimit, aty do të jenë me miliarda njerëz, por kjo turmë e madhe nuk do t'u jap jobesimtarëve një mundësi që të ikin nga gjykimi. Pas gjykimit të jobesimtarëve në prani të Allahut, ata do të jenë të etiketuar si

“njerëzit e dorës së majtë”. Kjo është koha kur ata do të dërgohen në xhehennem. Prej këtu e më tutje ata do të kuptojnë se xhehennemi do të jetë vendbanimi i tyre i përhershëm. Ata që dërgohen në xhehennem do të vijnë me një dëshmitar dhe një vozitës:

Dhe i fryhet surit, e ajo është dita e premtuar (për dënim). E do të vijë secili njeri bashkë me të dhe grahësi edhe dëshmitari. (I thuhet) Ti ishe në një huti nga kjo (ditë) e Ne ta tërhoqëm perden tënde dhe tash ti sheh shumë mprehtë. E shoku (përcjellësi) i tij do të thotë: “Kjo që është te unë (regjistri i veprave) është gati. Ju të dy (engjëjt) hidhini në Xhehennem secilin mohues kryeneç. Secilin pengues të veprave, mizor e të dyshimtë në fe. I cili All-llahut i shoqëroi Zot tjetër, pra hidhini atë në vuajtjet më të rënda”. (Kaf: 20-26)

Jobesimtarët do të dërgohen në këtë vend të tmerrshëm “në grupe”. Sidoqoftë, rrugës për në xhehennem, frika nga ai është frymëzuar në zemrat e jobesimtarëve. Zëri i tmerrshëm dhe zhurma e zjarrit dëgjohet edhe nga largësia:

Kur të hidhen në të, ata do t’ia dëgjojnë atij ushtimën e ai vlon. Nga zemërimi, ai gati copëtohet. (Mulk: 7-8)

Nga ajetet, është e qartë se kur ata ringjallen, të gjithë jobesimtarët do të kuptojnë se çfarë do t’u ndodhë. Ata mbesin vetëm; pa miq, të afërm apo përkrahës që t’iu ndihmojnë. Jobesimtarët nuk do të kenë fuqi më që të sillen me arrogancë dhe do të humbin vetëbesimin. Ata do të shikojnë me bisht të syrit. Njëri nga ajetet e përshkruan këtë moment:

Do t’i shohësh ata duke iu afruar atij (zjarrit) të frikësuar nga nënshtrimi, se si e shikojnë me bisht të syrit tinëzisht (me një shikim të vjedhur). Ata që besuan do të thonë: “Vërtet, të humbur në ditën e kiametit janë ata që e humbën vetveten dhe familjen e vet!” Ta dini pra, se mizorët janë në dënim të përjetshëm. (Shura: 45)

Xhehennemi është përplot me urrejtje. Uria e tij për jobesimtarët kurrë nuk mund të shuhet. Pavarësisht nga numri i madh i jobesimtarëve, ai ende lyp shumë e më shumë:

(Përkujto) Ditën kur Ne Xhehennemit i themi: “A je mbushur?” E, ai thotë: “A ka ende?” (Kaf: 30)

Allahu e përshkruan Xhehennemin në Kur’an si në vijim:

E Unë atë do ta hedhë në Sekar! E, ku e di ti se çka është Sekar? Ai nuk lë send të mbetet pa e djegur. Ai është që ua prish dhe ua nxin lëkurat. (Mudeththir: 26-29)

Jeta e pafundme pas dyerve të kyçura

Sa të arrijnë në xhehennem, jobesimtarët do të ngujohen në të. Këtu, ata do të shohin pamjet më të tmerrshme. Ata menjëherë e kuptojnë se ata do t'i "prezantohen" xhehennemit, në vendin ku do të qëndrojnë gjithmonë. Dyert e mbyllura tregojnë se aty nuk do të ketë shpëtim. Allahu e shpjegon gjendjen e jobesimtarëve si vijon:

Ndërsa ata që nuk i besuan argumentet Tona, ata janë të të majtës. Kundër tyre është zjarri i mbyllur. (Beled: 19-20)

Tortura në Kur'an përshkruhet si "**dënim i madh**" (Ali-Imran: 176), "**ndëshkimi i rreptë**" (Ali-Imran: 4) dhe "**ndëshkim i dhembshëm e pikëllues**" (Ali-Imran: 21). Përshkrimi i tij është i pamjaftueshëm për kuptimin e plotë të dënimit në xhehennem. Paaftësia e rezistimit edhe djegieve të vogla në këtë botë, njeriu nuk mund të merr me mend se mund të jetë i ekspozuar zjarrit përgjithmonë. Bile, dhembja që jep zjarri në këtë botë nuk mund të krahasohet me rreptësinë e dënimit në xhehennem. Asnjë dhembje nuk mund të jetë i ngjashëm me atë të xhehennemit:

Atë ditë askush nuk mund të dënojë sikur Ai. Dhe askush si Ai nuk mund të lidhë me pranga. (Fexhr: 25-26)

Në xhehennem ka jetë. Por është një jetë ku çdo moment është i mbushur me torturë dhe vuajtje. Ekziston çdo lloj torture fizike, mentale apo psikike, lloje të ndryshme të torturës si dhe turp i madh në atë botë. Të krahasohet me ndonjë vuajtje në këtë botë është e pamundur.

Njerëzit në xhehennem i përjetojnë dhembjet nëpërmjet të pesë shqisave. Sytë e tyre do të shohin pamje të tmerrshme dhe të neveritshme; veshët e tyre do të dëgjojnë çirret, dënesat dhe ulërimat më të frikshme; hundët e tyre do të mbushen me erëra djegëse dhe të pakëndshme; gjuhët e tyre do të shijojnë shijet më të padurueshme dhe më të ndyra. Ata do ta përjetojnë xhehennemin thellë në qelizat e tyre; kjo është dhembja më e hidhur dhe më tërbuese që vështirë mund të merret me mend në këtë

botë. Lëkura e tyre, organet e tyre të brendshme dhe i tërë trupi do të jenë të torturuara dhe do të përpëlitën në dhembje.

Njerëzit e xhehennemit janë të qëndrueshëm ndaj dhembjes dhe kurrë nuk vdesin. Kështu që, kurrë nuk do të mund të shpëtojnë veten nga tortura. Në Kur'an, kjo dhembje përshkruhet kështu: **"... Sa të durueshëm qenkan ata ndaj zjarrit!"** (Bekare: 175). Lëkurat e tyre rigjenerohen pas djegies; dhe tortura e njëjtë vazhdon përgjithmonë; intensiteti i mundimit kurrë nuk zvogëlohet. Prapë, Allahu thotë në Kur'an: **"hyni në të! Për juve është njësoj, bëtë durim ose nuk bëtë."** (Tur: 16)

Sikurse dhembjet fizike, ashtu edhe ato mentale janë të ashpra në xhehennem. Njerëzit në xhehennem pendohen shumë, dhe bien në gjendje të pashpresë, pikëllohen dhe kalojnë kohë të gjatë në dëshpërim. Çdo kënd, çdo vend në xhehennem është i punuar për të shkaktuar vuajtje mentale. Vuajtja është e përrjetshme; edhe nëse do të përfundonte pas miliona e miliarda vjetëve, edhe mundësie kaq e gjatë do të mund të shpresohej dhe të mbetet arsye e fortë për lumturi dhe gëzim. Por, torturat e përrjetshme bën që të shkaktoj një lloj gjendje të pashpresë e që nuk mund të krahasohet me asnjë ndjenjë tjetër të njohur në këtë botë.

Sipas përshkrimeve në Kur'an, xhehennemi është një vend ku përjetohet dhembja e skajshme: aroma të neveritshme; është i ngushtë, i zhurmshëm, me tym dhe i zyrtë, që bën që t'ia fus njeriut në shpirt ndjenjat e pasigurisë; zjarr që ndizet thellë në zemra; ushqim dhe pije të ndyra; veshje nga zjarri dhe katran i lëngtë.

Këto janë karakteristikat themelore të xhehennemit. Mirëpo, në këtë ambient të tmerrshëm jetohet. Njerëzit e xhehennemit kanë shqisa të mprehta. Ata dëgjojnë, flasin dhe grinden, dhe përpiqen që të dalin nga aty. Ata digjen në zjarr, eten dhe uriten si dhe pendohen. Ata torturohen me ndjenjën e fajësisë. Çfarë është më e rëndësishmja, ata dëshirojnë që të lehtësohet dhembja.

Njerëzit e xhehennemit në këtë ambient të ndytë dhe të neveritshme jetojnë një jetë shumë më të ultë sesa kafshët. Të vetmi freskim që e kanë janë frytet e gjembave të ithtë dhe druri i zakumit. Ata pinë, nga ana tjetër, gjak dhe qelb. Ndërkohë, zjarri i gllabëron nga të gjitha anët. Ankthi në xhehennem paraqitet kështu:

Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t'i hedhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurat e tyre, Ne ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin. All-llahu është i plotfuqishëm, i drejtë. (Nisa:56)

Me ndërrimin e lëkurës, mishin e djegur, si dhe me gjakun që stërpik përreth, ata janë të lidhur me zinxhirë dhe të rrahur me kamxhik. Me duar të lidhura në qafë, ata hedhen në qendër të xhehennemit. Engjëjt e dënimit, ndërkohë, i vendosin fajtorët në krevate të zjarra dhe me mbulesa gjithashtu nga zjarri. Edhe arkivoli i tyre është i mbuluar me zjarr.

Jobesimtarët vazhdimisht çirren që të shpëtohen nga torturat e tilla. E shpesh si përgjigje ata marrin vetëm më shumë torturë dhe poshtërim. Ata janë lënë vetëm në ankthin e tyre. Ata që ishin të njohur për arrogancën e tyre në botë tani lutet kokulur për mëshirë. Bile, ditët në xhehennem nuk janë të ngjashme me ditët në këtë botë, por sa i gjatë është minuta në vuajtjen e përjetshme, sa e gjatë është dita, java, muaji apo viti i kësaj dhembje të pafund?

Këto skena do të përjetësohen. Ato janë të vërteta. Ato janë më të vërteta sesa ditët e sotme që jemi duke i jetuar.

“Ka nga njerëzit që adhuron All-llahun me mëdyshe (luhatshëm).” (Haxh:11); dhe asi që thonë **“Neve nuk do të na djegë zjarri vetëm për pak ditë të numëruara.”** (Ali-Imran: 24); asi që kanë për qëllim paratë, statusin, dhe karrierën si caqe kryesore në jetën e tyre dhe prandaj edhe e kanë shpërfill kënaqësinë e Allahut; ata që ndryshojnë urdhrat e Allahut sipas dëshirave dhe qejfeve të tyre; ata që e interpretojnë Kur'anin sipas interesave të veta; ata që humbasin rrugën e vërtetë – shkurtimisht – të gjithë jobesimtarët dhe hipokritët do të banojnë në xhehennem, përpos atyre që Allahu me mëshirën e Tij i ka falë dhe i ka shpëtuar. Kjo është fjala përfundimtare e Allahut dhe sigurisht do të ndodhë:

Sikur të kishim dëshiruar Ne, secilit do t'i jepnim udhëzimin, por fjala (vendimi) Ime ka marrë fund (definitiv) se do ta mbushë Xhehennemin së bashku me xhinë e njerëz. (Sexhde: 13)

Ekziston edhe një fakt tjetër për xhehennemin; këta njerëz janë krijuar posaçërisht për xhehennem, siç sugjeron edhe ajeti në vazhdim:

Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehennem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata

kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët. (Ar'af: 179)

Pavarësisht nga vuajtjet që ata do të kalojnë, nuk do të mundet as një shpirt i vetëm që t'iu ndihmojë njerëzve të xhehennemit. Asnjë shpirt nuk do të jetë në gjendje që t'iu ndihmojë. Duke mbetur të braktisur ata do ta ndiejnë ndjenjën e hidhur të vetmisë. **“Prandaj, ai sot nuk ka këtu ndonjë mik.”** (Hakka: 35). Përreth tyre, do të jenë vetëm “Engjëjt e Dënimit” të cilit marrin urdhra nga Allahu. Ata janë skajshmërisht të ashpër, të pamëshirshëm, roje të tmerrshme, duke bartur të vetmen përgjegjësi për shkaktimin e torturimeve të ashpra njerëzve të xhehennemit. Ndjenja e mëshirës është plotësisht e zhdukur nga shpirti i këtyre engjëjve. Përveç torturimeve të tyre, ata kanë edhe pamje, zë dhe gje të tmerrshme. Qëllimi i ekzistimit të tyre është që të hakmerren kundër atyre që ishin rebel ndaj Allahut, dhe ata e kryejnë punën e tyre me përgjegjësi të plotë. Shumë vështirë është që ata do të bëjnë “lëshime favorizuese” ndaj dikujt.

Kjo është, në të vërtetë, rreziku i vërtetë që i kanoset çdo shpirti në këtë botë. Njeriu, duke qenë përbuzës dhe jo-falënderues ndaj Krijuesit të Tij, prandaj duke bërë veprën më të gabueshme të tij, padyshim se meriton dënim të tillë. Prandaj, Allahu u tërheq vëmendjen njerëzve në lidhje me këtë:

O ju që besuat, ruane veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruara. (Tahrim: 6)

Jo, Jo! Nëse nuk tërhiqet, vërtet do ta kapim për flokësh mbi ballin. Floku rrenacak, mëkatarë. E ai le t'i thërret ata të vetët. Ne do t'i thërrasim zebanitë. (Elak: 15-18)

Lutjet e dëshpërimit dhe pafuqisë

Njerëzit e xhehennemit gjenden në gjendje të pashpresë. Torturat që ata i përjetojnë janë jashtëzakonisht të vrazhda dhe të pafundme. Shpresa e vetme e tyre është vajtimi dhe lutja për shpëtim. Ata i shohin njerëzit e Xhennetit dhe i lusin për ujë dhe ushqim. Ata përpiqen që të pendohen dhe të kërkojnë falje nga Allahu. Sidoqoftë, të gjitha këto janë të kota.

Ata i lusin rojet e xhehennemit. Ata bile kërkojnë nga ata që bëhen ndërmjetësues mes tyre dhe Allahut dhe kërkojnë mëshirë. Dhimbja e tyre është e padurueshme sa që ata kërkojnë që të shpëtojnë nga ajo bile vetëm për një ditë:

Dhe ata, që janë në zjarr, rojës së Xhehennemit i thonë: “Lutnie Zotin tuaj të na e lehtësoj dënimin, bile një ditë!” Ata u thonë: “A nuk u patën arritur juve të dërguar tuaj me argumente të qarta? Ata përgjigjen: “Po (na kanë ardhur)!” E pra, (u thotë roja) lutnu ju vetë, po lutja e jobesimtarëve është asgjë!” (Gafir: 49-50)

Jobesimtarët më tutje kërkojnë të gjejnë shteg për falje, por ata repretësisht kthehen prapa:

Ata thonë: “O Zoti ynë, ne na patën mundur të këqijat (u dhamë pas epsheve të dynjasë) dhe si të tillë ishim popull i humbur! Zoti ynë, na nxjerr prej tij, e nëse gabojmë përsëri, atëherë vërtet, jemi mizor!” Ai thotë: “Heshtni aty e mos më folni!” Pse një grup prej robëve të Mi thanë: “O Zoti ynë, ne besuam, prandaj na falë dhe na mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!” E ju i patët tallur ata, sa që ajo tallje bëri që të harronin përkujtimin ndaj Meje, madje edhe qeshnit me ta. E Unë sot i shpërbleva ata për atë që ishin të durueshëm atë janë fitimtarët. (Mu’minun: 106-111)

Kjo në të vërtetë është drejtimi i fundit që Allahu e bën njerëzve të xhehennemit. Fjalët e Tij “Heshtni aty e mos më folni” janë përfundimtare. Prej aty e tutje, Allahu nuk do t’i ketë parasysh njerëzit e xhehennemit. Kurrkush nuk do të dëshironte bile as të mendonte për këtë situatë.

Derisa njerëzit e xhehennemit digjen në të, ata që fitojnë “kënaqësinë dhe lumturinë”, me fjalë të tjera besimtarët; janë në xhennet duke i shijuar të mirat e dhuratave të pafundme. Vuajtjet e njerëzve të xhehennemit bëhen edhe më të theksuara kur ata shohin dhe vëzhgojnë jetën e besimtarëve në xhennet. Në të vërtetë, derisa iu nënshtrohen torturave të padurueshme, ata mund të “shikojnë” të mirat e mrekullueshme të xhennetit.

Besimtarët, me të cilët jobesimtarët kanë bërë shaka në botë, tani jetojnë jetë të lumtur, duke jetuar në vende të shkëlqyeshme, shtëpi të mrekullueshme me femra të bukura, dhe duke shijuar ushqim dhe pije të

(Ata) Që janë në xhennete e i bëjnë pyetje njëri-tjetrit, përkitazi me kriminelët (e u thonë): "Çka u solli juve në xhehennem?" Ata thonë: "Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënin namaz); Nuk kemi qenë ata që ushqyenim të varfërit; dhe kemi qenë që përziheshim me të tjerët në punë të kota. Dhe kemi qenë që nuk e besonim ditën e gjykimit. Derisa na erdhi e vërteta (vdekja)!" E tanimë, atyre nuk u bën dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve.
(Mudethir: 40-48)

shijshme. Pamja e besimtarëve në paqe dhe bollëk duke e shtuar turpin e të qenurit në xhehennem. Këto skena u shtojnë edhe më tepër dhimbje dhe vuajtje mjerimit të tyre.

Pendimi bëhet çdoherë e më i thellë. Mos respektimi i urdhrave të Allahut në botë bën që t'i bren edhe më thellë ndërgjegjja. Ata iu drejtohen besimtarëve në xhennet dhe përpiqen që të komunikojnë me ta. Ata lutën për ndihmë dhe keqardhje nga ata. Por, këto janë përpjekje të kota. Edhe njerëzit e xhennetit i shohin ata. Pamja dhe jeta e tyre e shkëlqyeshme i bën ata që të ndihen edhe më falënderues ndaj Allahut. Shkëmbimi i fjalëve në mes të njerëzve të xhehennemit dhe xhennetit është si vijon:

Që janë në Xhennete e i bëjnë pyetje njëri-tjetrit, Përkitazi me kriminelët (e u thonë): “Çka u sollti juve në Sekar?” Ata thonë: “Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënë namaz); Nuk kemi qenë që ushqenim të varfrit; Dhe kemi qenë që përziheshim me të tjerët në punë të kota. Dhe kemi qenë që nuk e besonim ditën e gjykimit. Derisa na erdhi e vërteta (vdekja)!” E tanimë, atyre nuk u bën dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve, (Mudeththir: 40-48)

Një përkujtues i rëndësishëm që të shmangët torturimi

Në këtë kapitull, folëm për dy lloje njerëzish; ata që kanë besuar Allahun dhe ata që e kanë mohuar ekzistencën e Tij. Në gjithashtu kemi sjellë një përskrim të përgjithshëm mbi xhehennemit dhe xhennetin, duke u bazuar krejtësisht në përskrimet nga Kur'ani. Qëllimi ynë nuk është që të jepën disa informata mbi fenë. Kjo është përkujtues dhe vërejtje për jobesimtarët se ahireti do të jetë për ta një vend i trishtueshëm dhe do të jetë fund i tmerrshëm.



Pas krejt asaj që e thamë, është e nevojshme që të theksohet se njeriu, padyshim, është i lirë që të zgjedhë. Ai mund të jetojë jetën ashtu si ai vet dëshiron. Nuk është e drejtë e askujt që të detyrojë ndokënd me forcë që të besojë. Mirëpo, si njerëz që e besojmë në ekzistencën e Allahut si dhe në drejtësinë e Tij përfundimtare, ne bartim përgjegjësinë e paralajmërimit të njerëzve për atë ditë të frikshme. Këta njerëz sigurisht janë të pavetëdijshëm për gjendjen në të cilën gjenden dhe çfarë fundi është duke i pritur. Prandaj, ne ndjejmë përgjegjësi që t'i lajmërojmë ata. Allahu na informon mbi gjendjen në të cilën gjenden këta njerëz:

A është më i mirë ai që ndërtesën e vet e themeloi në devotshmëri dhe në kënaqësi të All-llahut, apo ai që në ndërtesën e vet e themeloi buzë bregut të shembur e bashkë me të bie në zjarrin e xhehennemit? All-llahu nuk i udhëzon njerëzit zullumqarë. (Teube: 109)

Ata që nuk i zbatojnë urdhrat e Allahut në këtë botë, me apo pa vetëdije, mohojnë ekzistencën e Krijuesit të tyre nuk do të jenë të shpëtuar në ahiret. Prandaj, para se të humbet kohë, secili duhet që ta kuptojë situatën e tij para pranisë së Allahut dhe duhet që t'i dorëzohet Atij. Përndryshe, ai do të pendohet dhe do të përballlet me përfundimin e frikshëm:

Ata që nuk besuan shpeshherë do të kishin dëshiruar të kishin qenë myslimanë. Lëri (Muhammed) ata, të hanë, të dëfrehen dhe t'i preokupojë shpresa (se do të jetojnë shumë), e më vonë do të kuptojnë. (Hixhr: 2-3)

Mënyra se si t'i shmangemi dënimit të përjetshëm, e të fitohet lumturia e përhershme dhe të arrihet kënaqësia e Allahut, është e qartë:

Para se të jetë shumë vonë, duhet të kemi besim të vërtetë në Allahun.

Jetoje jetën duke bërë punë të mira që të arrish kënaqësinë e Allahut...



VËREJTJE

Kapitullin i ardhshëm që do ta lexoni zbulon fshehtësinë thelbësore të jetës suaj. Duhet që ta lexoni me shumë kujdes dhe tërësisht meqë ka të bëjë me temën e cila mund të bëjë ndryshime fundamentale në pikëpamjet tuaja për botën e jashtme. Tema e këtij kapitulli nuk është vetëm pikëpamja, qasja tjetër apo mendim tradicional apo filozofik; është fakt që të gjithë, ata që besojnë dhe ata që nuk besojnë, duhet që ta pranojnë pasi që është vërtetuar edhe nga shkenca e sotme.

ESENCA E VËRTETË E MATERIES



nerëzit që vrasin mendjen me arsye dhe mençuri për gjërat që i rrethojnë e kuptojnë se çdo gjë në gjithësi – e gjallë apo jo e gjallë - duhet jetë e krijuar. Pyetja rrjedh se: “Kush është Krijuesi i të gjitha këtyre gjërave?”

Është evidente se “fakti i krijimit”, që zbulon vetveten në çdo aspekt të gjithësisë, nuk mund të jetë si rezultat i vetë gjithësisë. P.sh., miza nuk mund të krijohet vetvetiu. Sistemi diellor nuk ka mund të krijohet dhe të organizohet vetë. As bimët, njerëzit, bakteret, eritrocitet (rruazat e kuqe të gjakut), e as fluturat nuk e kanë krijuar vetveten. Gjithashtu edhe mundësia se të gjitha këto e kanë prejardhjen “nga rasti”, as që mund të paramendohet.

Kështu që ne arritëm deri tek përfundimi si vijon: çdo send që e shohim është krijuar, por asnjërin që ne e shohim nuk mund të jetë vetë “krijues”. Krijuesi është ndryshe dhe superior ndaj të gjitha çka jemi duke parë me sytë tanë, një fuqi e superiore që është e padukshme por ekzistimin dhe cilësitë e të cilit janë të shfaqura në çdo gjë që ekziston.

Këtu është pika kundërshtuese e atyre që e mohojnë ekzistimin e Allahut. Këta njerëz janë të kushtëzuar që të mos besojnë në ekzistencën e Tij derisa nuk ta shohin Atë me sytë e tyre. Këta njerëz, që nënvlerësojnë faktin e “krijimit”, janë të shtyrë që të injorojnë realitetin e “krijimit” që manifestohet përmes gjithësisë dhe përpiqen që të dëshmojnë se gjithësia dhe qeniet e gjalla në të nuk janë të krijuara. Teoria e evolucionit është një shembull thelbësor për përpjekjet e tyre të kota për këtë qëllim.

Ky gabim fundamental i atyre që mohojnë Allahun përkrahet nga

shumë njerëz që në të vërtetë nuk e mohojnë ekzistencën e Allahut, por kanë një perceptim të gabuar për Të. Ata nuk e mohojnë krijimin por kanë besime paragjyquese se “ku” gjendet Allahu. Shumica e tyre mendojnë se Allahu është lart “në qiell”. Ata në mënyrë të heshtur paramendojnë se Allahu është pas ndonjë planeti të largët dhe ai ndërhyt në “çështjet e kësaj bote” nganjëherë, apo ndoshta nuk intervenon fare. Ata paramendojnë se Ai e ka krijuar gjithësinë dhe pastaj e ka lënë që njerëzit vetë të caktojnë fatet e tyre.

E disa besojnë se kanë dëgjuar se në Kur’an shkruan se Allahu është “gjithkund” por ata nuk mund të kuptojnë se çfarë saktësisht do të thotë kjo. Ata mendojnë se Allahu përfshinë çdo gjë sikur radio valët apo sikur gazi i padukshëm dhe i paprekshëm.

Sidoqoftë, kjo dhe besimet tjera që nuk mund ta sqarojnë se “ku” është Allahu (dhe ndoshta për këtë arsye ata e mohojnë Atë) janë të bazuara në gabimin e zakonshëm. Ata paragjykojnë pa kurrfarë baze dhe për këtë shkak kanë edhe mendime të gabuara për Allahun. Çfarë është ky paragjykim?

Ky paragjykim është për shkak të natyrës dhe karakteristikës së materies. Ne jemi aq të kufizuar në supozimet tona mbi ekzistencën e materies sa që kurrë nuk mendojmë se a me të vërtetë ekziston apo është vetëm një shëmbëllim. Shkenca bashkëkohore shkatërron këtë paragjykim dhe demaskon një realitet të rëndësishëm dhe të qartë. Në faqet në vazhdim, do të përpiqemi që t’i sqarojmë këtë realitet të madh për të cilin Kur’an tregon.

Bota e sinjaleve elektrike

Të gjitha informatat që i kemi për botën në të cilën jetojmë barten tek ne përmes pesë shqisave tona. Bota që ne e njohim përmbahet prej asaj se çfarë shohin sytë tanë, çfarë nuhasin hundët tona, shijojnë gjuhët tona dhe çfarë dëgjojnë veshët tanë. Ne kurrë nuk mendojmë se bota “e jashtme” mund të jetë çdo gjë tjetër përpos asaj se çfarë shqisat tona na e paraqesin neve, meqë ne jemi të varur që nga lindja në vetëm këto pesë shqisa.

Hulumtimet moderne në shumë fusha shkencore theksojnë për shumë kuptime të ndryshme dhe krijojnë dyshime serioze në lidhje me shqisat tona si dhe botën që e perceptojmë me to.

Pika nismëtare e kësaj qasjeje është se termi “botë e jashtme” e formuar në trurin tonë është vetëm përgjigje e krijuara në trurin tonë nga sinjalet elektrike. Ngjyra e kuqe e mollës, fortësia e drurit dhe sidomos, babai, nëna, familja jote dhe çdo gjë që ke, shtëpinë tënde, punën, si dhe rreshtat e këtij libri, janë të përbëra vetëm nga sinjalet elektrike.

Frederik Vester sqaron pikën deri ku ka arritur shkencën në lidhje me këtë çështje:


Deklaratat e disa shkencëtarëve me qëndrimin se “njeriu është një shëmbëlltysë, dhe se çdo gjë që përjetohet është e përkohshme dhe mashtruese, dhe se kjo gjithësi është një hije, duket të jetë e vërtetuar nga shkencën sot.”¹⁰

Filozofi i njohur, Xhorxh Berkli (George Berkeley) komentoi për këtë temë si vijon:


*Besojmë se ekzistenca e objekteve bëhet vetëm për shkak se ato i shohim dhe i dëgjojmë, dhe reflektohen tek ne nga shqisat tona. Sidoqoftë, shqisat tona janë vetëm ide në mendjen tonë. Prandaj, objektet që i marrim me shqisat tona nuk janë asgjë tjetër përpos ide, dhe këto ide nuk janë esenciale përpos në trurin tonë...Meqë çdo gjë ekziston në mendje, dmth. se **ne jemi të mashtruar me dinakëri kur paramendojmë gjithësinë dhe gjërat të ekzistojnë jashtë mendjes sonë**. Prandaj, asnjë nga gjërat që na rrethojnë nuk ekzistojnë askund përpos në mendjen tonë.”¹¹*



Stimulimet duke ardhur nga një objekt konvertohen në sinjale elektrike dhe shkaktojnë efekte në tru. Kur “shohim”, në fakt ne shohim vetëm efektet e atyre sinjale në mendjen tonë.



Bile edhe çasti kur ndiejmë dritën apo nxehtësinë e zjarrit, brenda në trurin tonë është terr “burg” dhe ka një temperaturë të pandryshueshme.



Tufat e dritës duke ardhur nga një objekt bien në retinë kokëposhtë. Këtu, imazhi konvertohet në sinjale elektrike dhe transmetohet në qendrën për shikim në pjesën e prapme të trurit. Pasiqë truri është i izoluar nga drita, është e pamundur që drita të arrijë në qendrën e shikimit. Kjo dmth., se ne shohim botën e pafund të dritës dhe thellësisë në një pikë të vogël që është e izoluar nga drita.

Në mënyrë që të sqarojmë çështjen, të marrim shqisën e të pamurit, e cila na furnizon me më së shumti informata nga bota e jashtme.

Si shohim, dëgjojmë dhe shijojmë?


Procesi i të pamurit zhvillohet vazhdimisht. Grimcat e dritës (fotonet) udhëtojnë nga objekti për në sy dhe kalojnë nëpër thjerrëzën që gjendet në pjesën e përparme të syrit ku thyhen dhe bien kokëposhtë në retinë në

pjesën e prapme të syrit. Kështu, goditja e fotoneve shndërrohet në sinjale elektrike dhe transmetohen nga neutronet në një pikë të vogël që quhet qendra e shikimit në pjesën e prapme të trurit. Ky sinjal elektrik perceptohet si një shëmbëlltjërë në këtë qendër në tru pas një seri procesesh. Procesi i shikimit në të vërtetë përfshinë këtë pikë të vogël në pjesën e prapme të trurit, e që është “terr-burg” dhe plotësisht i izoluar nga drita.

Tani, le të rishqyrtojmë këtë proces që duket i zakonshëm dhe i thjeshtë. Kur ne themi, “shohim”, ne në të vërtetë shohim efektin e impulseve që arrijnë në sytë tanë dhe transferohet në trurin tonë, pas transformimit në sinjale elektrike. Kjo është, ajo, që kur themi “shohim”, në të vërtetë ne jemi duke i parë sinjalet elektrike në mendjen tonë.

Të gjitha imazhet që ne i shohim gjatë jetës sonë formohen në qendrën tonë të shikimit, e që përbëhet prej vetëm disa cm kub të vëllimit të trurit. Të dyja, kjo libër që je duke e lexuar momentalisht dhe panorama e paskajshme që e sheh në horizont i zë në këtë hapësirë të vogël. Një çështje tjetër që duhet ta kemi në mendje është se, siç theksuam edhe më parë, truri është i izoluar nga drita; dhe se brenda është errësirë absolute. Truri nuk ka kontakt fare me dritën.

Këtë situatë interesante mund të shpjegojmë me ndihmën e një shembulli. Të supozojmë se para nesh është një qiri i ndezur. Ne jemi



Krejt çfarë ne shohim në jetën tonë formohet në pjesën e trurit tonë të quajtur “qendra e shikimit” që është e vendosur në pjesën e prapme të trurit tonë, dhe që është me madhësi me vëllim prej disa centimetrave kub. Libri që tani jeni duke e lexuar dhe pamja e mahnitshme që e sheh duke vrotur në horizont vendoset në këtë hapësirë të vogël. Prandaj, ne i shohim objektet jo në madhësinë e tyre aktuale që ekzistojnë përjashta, por në madhësinë që e perceptojmë nga truri ynë.

përballë këtij qiriu dhe e shikojmë atë gjerësisht. Sidoqoftë, gjatë kësaj kohe, truri ynë kurrë nuk ka pasur kontakt direkt me dritën originale të qiririt. Edhe pse ne e shohim dritën e qiririt, brendësia e trurit tonë është plotësisht e errtë. Ne shohim botën e ngjyrshme dhe të ndryshme brenda trurit tonë të errët.

R.L. Gregory jap një sqarim rreth aspektit të shikimit, që ne e marrim si të gatshme:

*Ne jemi aq të njoftuar për shikimin, saqë nevojitet vetëm një çast imagjinate që të kuptojmë se aty ka probleme që duhet zgjidhur. Por duhet ta kesh një gjë në konsideratë. Na janë dhënë shëmbëlltyra kokëposhtë në sy, e ndërsa ne shohim objekte të ngurta të ndara në hapësirën që na rrethon. Nga mostrat e stimulimeve në retinë ne perceptojmë botën e objekteve, dhe **kjo nuk është më pak se një mrekulli.**¹²*

Gjendje e njëjtë vlen edhe për shqisat tjera. Zëri, prekja, shija dhe aroma të gjitha transmetohen në tru si sinjale elektrike dhe perceptohen në qendrat relevante në tru.

Shqisa e të dëgjuarit punon ngjashëm me atë të pamurit. Veshi i jashtëm mbledh zërat dhe i drejton ato në veshin e mesëm. Veshi i mesëm i transmeton vibrimet e zërit në veshin e brendshëm dhe i intensifikon ato. Veshi i brendshëm i përkthen vibrimet në sinjale elektrike, të cilat dërgohen në tru. Sikurse me syrin, procesi i dëgjimit përfundimisht zë vend në qendrën për dëgjim në tru. Truri është i izoluar nga zëri ashtu si nga drita. Kështu që, pa marrë parasysh se sa zhurmshëm është jashtë, brendia e trurit është plotësisht e heshtur.

Megjithatë, edhe zërat më të lehtë perceptohen nga truri. Kjo është aq precize saqë veshi i një personi të shëndoshë dëgjon të gjitha pa ndonjë zhurmë apo interferencë atmosferike. Në trurin tuaj, që është i izoluar nga zëri, mund të dëgjosh simfoni nga orkestra, të gjitha zërat nga vendi me turmë dhe t'i pranosh të gjitha zërat me një diapazon të gjerë të frekuencave, që nga shushurima e fletëve e deri tek oshtima e madhe e aeroplanit të udhëtarëve. Sidoqoftë, nëse niveli i zërit në trurin tuaj do të mund të matej me ndonjë aparat të ndjeshëm, do të mund të vërehej se në brendinë e trurit mbizotëron një qetësi absolute.


Perceptimi i aromës formohet në mënyrë të ngjashme. Molekulat e avullta të lëshuara nga gjërat si vanilja apo trëndafili arrin deri tek receptorët në qimet delikate në regjionin e epitelit të hundës dhe përfshihet në bashkëveprim. Bashkëveprimi transmetohet në tru si sinjal elektrik dhe perceptohet aroma. Çdo gjë që ka aromë apo erë, e këndshme apo e pakëndshme, nuk është asgjë tjetër përpos perceptim i trurit me bashkëveprim me molekulat e avullta pas transformimit të tyre në sinjale elektrike. Në këtë mënyrë pranohet aroma e parfumit, lules, ushqimit të preferuar, detit apo aromave që iu pëlqejnë apo jo, në trurin tuaj. Molekulat vetvetiu kurrë nuk arrijnë në tru. Njëjtë sikur me zërin dhe pamjen, ato që arrin në tru janë thjeshtë sinjale elektrike. Me fjalë të tjera, të gjitha erërat që ke pranuar – prej se keni lindur – që kanë arritur nga objektet nga jashtë janë vetëm sinjale elektrike që i ke ndier përmes organeve shqisore.

Ngjashëm, ekzistojnë katër lloj receptorësh (pranues) kimikë në pjesën e përparme të gjuhës së njeriut, dhe përbëhen nga katër lloj të shijeve: njelmët, ëmbël, hidhur dhe thartë. Receptorët tanë të shijes i shndërrojnë këto perceptime në sinjale elektrike përmes një zinxhiri të proceseve kimike dhe i transmetojnë në tru. Këto sinjale perceptohen nga truri si shije. Shija që e përjeton kur han çokollatën apo pemën që preferoni është një interpretim i sinjaleve elektrike nga truri yt. Kurrë nuk do të mund që të arrish objektin në botën e jashtme; kurrë nuk mund ta shohësh; nuhasësh apo të shijosh vetë çokollatën. P.sh. nëse nervat e shijes që udhëtojnë për në tru prehen, shija e gjërave që i han nuk do të arrijnë në tru; dhe plotësisht do të humbësh ndjenjën tuaj për shije.

Nga ky pikëvështrim, arritëm edhe deri tek një fakt. Kurrë nuk do të jemi të sigurt se çfarë përjetojmë kur e shijojmë ushqimin dhe çfarë përjeton tjetërkush kur e shijon ushqimin e njëjtë, apo çfarë ne perceptojmë kur dëgjojmë një zë dhe çfarë tjetërkush percepton kur ai dëgjon zërin e njëjtë, se do të jetë e njëjtë. Lincoln Barnett thotë se askush nuk e di se a e percepton tjetri ngjyrën e kuqe apo e ndien notën C ashtu si e percepton vet.¹³

Shqisa jonë e të prekurit nuk ndryshon nga të tjerët. Kur e prekim një objekt, të gjitha informatat që do të mund ta njohim botën e jashtme dhe

Si rezultat i stimulimit artificial, bota fizike e vërtetë dhe reale si jeta reale mund të formohet në trurin tonë edhe pa ekzistimin e botës fizike. Si rezultat i stimulimit artificial, dikush mund të mendojë se është duke vozitur auton e tij, e në të vërtetë ai është ulur në shtëpi të vet.



objektet transmetohen në tru përmes nervave të të prekurit që gjenden në lëkurë. Ndjenja e të prekurit formohet në trurin tonë. Përkundër njohurisë së përgjithshme, vendi ku ne i pranojmë shqisën e të prekurit nuk është në maje e gishtërinjve, por në qendrën e të prekurit në trurin tonë. Pasi që interpretimi i stimulimit nga truri i sinjaleve elektrike vjen nga objektet, ne i përfetojmë këto objekte në mënyra të ndryshme, siç, a janë të forta apo të buta, të nxehta apo të ftohta. Ne i përfetojmë të gjitha hollësitë që na ndihmojnë që të njohim ndonjë objekt nga këto stimule. Sa i përket kësaj, mendimet e dy filozofëve të famshëm, B. Russell dhe L. Wittgenstein, janë si vijon:

Për shembull, pa marrë parasysh se a ekziston me të vërtetë limoni apo jo dhe si është bërë që të ekzistojë nuk do të mund të diskutohet apo hulumtohet. Limoni përbëhet vetëm nga shija që e ndiejmë me gjuhë, aroma e nuhatur me hundë, forma dhe ngjyra e parë me sy; dhe këto janë të vetmet tipare që çështja të studiohet dhe vlerësohet. Shkenca kurrë nuk do ta njoh botën fizike.¹⁴

Është e pamundur që ta arrijmë botën fizike. Të gjitha objektet rreth nesh janë koleksion i perceptimeve siç janë shikimi, dëgjimi dhe prekje.

Duke proceduar të dhënat në qendrën e shikimit dhe në qendrat tjera të shqisave, truri ynë, gjatë jetës, nuk ballafaqohet me “origjinalin” e materies që ekziston jashtë nesh, por më saktë, me kopjen e formuar brenda trurit tonë. Në këtë pikë jemi të mashtruar duke menduar se këto kopje janë vetë materie jashtë nesh.

“Bota e jashtme” brenda në trurin tonë

Nga faktet fizike që janë shpjeguar deri më tani, mund të konkludojmë si vijon. Çdo gjë që ne e shohim, prekim, dëgjojmë dhe e perceptojmë si “materie” apo “gjithësi” është vetëm sinjal elektrik që shkaktohen në trurin tonë.

Dikush që është duke ngrënë një frut nuk ballafaqohet me frutin por me perceptimin e frutit në tru. Objekti i konsideruar nga njeriu si “frut” në të vërtetë përbëhet nga gjurmët elektrike të formës, shijes, aromës dhe ndërtimit të frutit në tru. Nëse nervat e shikimit që shkojnë në tru lëndohen papritmas, shëmbëlltyra e frutit papritmas do të zhduket. Ndërrerja në rrugën nga shqisat e hundës për në tru do të ndërpresë komplet shqisën e të nuhaturit. Thjeshtë, fruti nuk është asgjë tjetër përpos interpretim i sinjaleve elektrike.

Një pikë tjetër që duhet marrë në konsideratë është edhe ndjenja për largësi. Largësia, për shembull mes teje dhe këtij libri, është vetëm një ndjenë e hapësirës e formuar në trurin tënd. Objektet që duken të jenë të largëta nga pikëvështrimi i dikujt gjithashtu ekzistojnë në tru. Për shembull, dikush që është duke shikuar yjet në qiell mendon se ata janë me miliona vjet drite larg nga ai. Por, çfarë ai “sheh” në të vërtetë janë yjet brenda në të, në qendrën e tij të shikimit. Derisa je duke i lexuar këta rreshta, në të vërtetë ti nuk je brenda në dhomë, por përkundrazi, dhoma është brenda teje. Duke e shikuar



Zbulimet e fizikës moderne tregojnë se universi është një grumbull perceptimesh. Pyetja e ardhshme del në faqen e parë të revistës shkencore të njohur amerikane New Scientist, e cila merret me këtë çështje në numrin e saj të 30 janarit 1999: “Përtej realitetit: A është me të vërtetë universi një rreng (lojë) e informacionit themelor dhe se materia është vetëm një vegim (mirazh)?”

trupin tënd bën që të mendosh se je brenda trupit tënd. Sidoqoftë, duhet pasur në mendje se trupi yt, gjithashtu, është një shëmbëlltysë brenda në trurin tënd.

E njëjta gjë ndodh me të gjitha shqisat tjera. Për shembull, kur mendon se ke dëgjuar zërin e televizionit nga dhoma tjetër, në të vërtetë jeni duke përjetuar zërin brenda në trurin tuaj. Nuk mund të dëshmosh se ekziston një dhomë afër tëndes apo që zëri vjen nga televizioni nga ajo dhomë. Zëri që mendon se je duke e dëgjuar disa metra larg teje dhe biseda e dikujt afër teje perceptohet në qendrën e dëgjimit me vëllim prej disa cm kub në trurin tënd. Përndryshe nga kjo qendër e perceptimit, nuk ekzistojnë konceptet si majtas, djathtas, përpara dhe prapa. Kështu pra, zëri nuk vjen tek ti nga djathtë, majtë apo nga ajri; nuk ka drejtim të caktuar se nga vjen zëri.

Aromat që i percepton janë të ngjashme; asnjë aromë nuk arrin nga distanca e madhe. Mund të supozosh se efektet fundore të formuara në qendrën tënde të të nuhaturit janë aroma të objekteve në botën e jashtme. Sidoqoftë, ashtu siç formohet shëmbëllimi i trëndafilin në qendrën tënde të shikimit, ashtu formohet edhe aroma e trëndafilin është në qendrën tënde të të nuhaturit; prandaj nuk ka as trëndafil e as aromë që i përket botës së jashtme.

“Bota e jashtme” që neve na paraqitet me anë të perceptimeve tona është vetëm një koleksion i sinjaleve elektrike që arrijnë në trurin tonë. Gjatë jetës sonë, truri ynë përpunon këto sinjale dhe ne jetojmë pa e ditur se ne jemi duke gabuar që supozojmë se të gjitha këto janë versione origjinale të gjërave që ekzistojnë në “botën e jashtme”. Ne jemi të mashtruar vetëm për shkak se nuk mund të arrijmë vetë materien me anë të shqisave tona.

Përveç kësaj, truri ynë i interpreton dhe u jep kuptimin sinjaleve që ne i paramendojmë si “botë e jashtme”. Për shembull, të shqyrtojmë shqisën e dëgjimit. Truri ynë shndërron valët e zërit nga “bota e jashtme” në një simfoni. Mund të thuhet se muzika gjithashtu është perceptim i krijuar nga truri ynë. Në të njëjtën mënyrë, kur shohim ngjyrat, çfarë kap syri ynë janë vetëm sinjalet elektrike të gjatësive të ndryshme valore. Prapë truri ynë i transformon këto sinjale në ngjyra. Nuk ka ngjyra në “botën e jashtme”. As

molla nuk është e kuqe e as qielli nuk është i kaltër apo bari i gjelbër. Ato janë asisoj, për shkak se ne i perceptojmë ashtu. “Bota e jashtme” plotësisht varet nga perceptuesi.

Bile edhe defekti më i vogël në retinën e syrit mund të shkaktojë verbësinë e ngjyrave. Disa njerëz perceptojnë të kaltrën si të gjelbër, disa të kuqën sikur të kaltër, ndërsa dikush i percepton të gjitha ngjyrat si nuanca të ndryshme të të përhiturës. Nga kjo pikë, nuk është e rëndësishme nëse objekti i jashtëm ka ngjyrë apo jo.

Mendimtari i spikatur Berkeley thekson për këtë fakt:

*Në fillim, është besuar se **ngjyrat, aromat**, etj., “me të vërtetë ekzistojë”, por më pas pikëpamje të tilla ishin refuzuar, dhe është parë se **ato ekzistojnë në varësi nga ndjenjat tona.***¹⁵

Si përfundim, arsyeja se si i shohim objektet të ngjyrosura nuk është për shkak se ato janë të ngjyrosura apo pse kanë ekzistencë materiale të pavarur jashtë nesh. E vërteta mbi materien është më saktë se të gjitha cilësitë që i atribuojmë objekteve janë brenda nesh e jo në “botën e jashtme”.

Pra çfarë mbetet nga “bota e jashtme”?

A është ekzistimi i “botës së jashtme” i domosdoshëm?

Deri më tani, kemi folur pandërprerë për një “botë të jashtme” dhe një botë të perceptimeve të formuar në trurin tonë, që është çfarë ne shohim. Sidoqoftë, pasi ne në të vërtetë nuk mundemi që të prekim “botën e jashtme”, si do të mund të jemi të sigurt se një botë e tillë me të vërtetë ekziston?

Në të vërtetë nuk mundemi. Pasi që çdo objekt është vetëm një koleksion i perceptimeve dhe ato perceptime ekzistojnë vetëm në mendjen tonë, është më e udhës që të themi se bota e vetëm që me të vërtetë ekziston është bota e perceptimeve. Bota e vetme që ne e njohim si botë është ajo që ekziston në mendjen tonë: ajo që është e dizajnuar, regjistruar, dhe e gjallëruar atje; ajo botë që, thënë shkurt, e krijuar brenda mendjes sonë. Kjo është e vetmja botë në të cilën mund të jemi të sigurt.


Kurrë nuk do të mund që të dëshmojmë se perceptimet që ne i studiojmë në trurin tonë kanë lidhje me materien. Këto perceptime mund të vijnë besnikërisht nga ndonjë burim “artificial”.

Është e mundur që të observohet kjo. Stimulimet e rreme mund të prodhojnë "një botë materiale" krejtësisht imagjinare në trurin tonë. Për shembull, le të paramendojmë ndonjë instrument shumë të zhvilluar që mund të regjistroj të gjitha llojet e sinjaleve elektrike. Së pari, le t'i transmetojmë të gjitha të dhënat mbi ambientin (edhe imazhin e trupit) në këtë instrument duke i transformuar ato në sinjale elektrike. E dyta, të paramendojmë se truri mund të ekzistojë jashtë trupit. Dhe në fund, ta lidhim me instrumentin regjistruar në tru me elektroda që do të funksiononin sikur nerva që dërgojnë të dhënat e para-regjistruara në tru. Në këtë mënyrë, mund të përjetoni veten duke jetuar në një ambient të krijuar artificialisht. Për shembull, shumë lehtë mund të besosh se je duke vozitur shpejt në autostradë. Mundet që kurrë mos të jetë e mundur që të kuptohet se ti përbëhesh vetëm nga truri. Kjo është kështu pasi që me krijimin e një botë brenda trurit tënd nuk është e nevojshme ekzistenca e një bote të vërtetë, por më mirë me thënë, stimulim. Është krejtësisht e vërtetë se këto stimulime mund të vijnë edhe nga burim artificial, siç është një magnetofon.

Në lidhje me këtë, filozofi i shquar Bertrand Russell shkruan:

Pasi që shqisa e të prekurit kur e shtypim tavolinën me majat e gishtërinjve tonë, shkaktohet një çrregullim elektrik në elektronet dhe protonet e majave gishtërinjve tonë, që prodhohen, sipas fizikës moderne, nga afërsia e elektroneve dhe protoneve në tavolinë. Nëse çrregullimi i njëjtë në majat e gishtërinjve tonë bëhet ndryshe, ne duhet që të kemi ndjenjat, pavarësisht se a ka apo jo tavolinë.¹⁶

Me të vërtetë është shumë lehtë për ne që të mashtrohemi nga perceptimet që besojmë, pa kurrfarë lidhje me materien, që të jetë e vërtetë. Shpesh përjetojmë këtë ndjenjë kur ëndërrojmë, ku përjetojmë ngjarje, shohim njerëz, objekte dhe ambient që duket krejtësisht të vërtetë. Mirëpo, të gjitha këto janë vetëm perceptime. Nuk ka ndonjë ndryshim themelor në mes të ëndrrës dhe "botës reale"; që të dyja janë përjetime në tru.



Truri është një grumbull i qelizave të përbëra nga proteinet dhe molekulat yndyrore. Është formuar nga qelizat nervore të quajtur neurone. Nuk ka fuqi që një copë mishi të vëzhgojë imazhet, të përbëjë vetëdijën, apo të krijojë qenien që ne e quajmë “vetvete”.

Kush është perceptuesi?

Siç kemi treguar deri më tani, nuk ka dyshim se bota që ne mendojmë se jetojmë në të që e quajmë “botë e jashtme” perceptohet brenda në trurin tonë. Sidoqoftë, këtu lind një pyetje e dorës së parë. Nëse ngjarjet fizike që ne i njohim si perceptime të brendshme, çfarë është çështja e trurit tonë? Pasi truri ynë është pjesë e botës fizike sikur duart, këmbët tona apo çdo objekt tjetër, gjithashtu duhet që të jetë perceptues sikurse të gjitha objektet tjera.

Shembulli i ëndrrës do ta ndriçojë më tutje këtë çështje. Të paramendojmë se jemi duke ëndërruar në trurin tonë sipas asaj se çfarë kemi thënë deri më tani. Në ëndërr, do të kemi një trup të imagjinuar, një dorë të imagjinuar, një sy të imagjinuar dhe një tru të imagjinuar. Nëse gjatë ëndërrimit, do të pyeteshim, “ku sheh?” ne do të përgjigjeshim “në trurin tim”. Sidoqoftë, nuk ekziston truri që të mund të flasim për të, por një kokë dhe një tru i imagjinuar. Shikuesi i imazheve nuk është truri i imagjinuar në ëndërr por një “qenie” që është shumë më “superiore” se ai.

E dimë se nuk ka ndryshim fizik në mes të ambientit në ëndërr dhe ambientit që ne e quajmë jetë reale. Prandaj po të pyeteshim në ambientin që ne e quajmë jetë reale me pyetjen e mësipërme “ku sheh”, do të ishte shumë e pakuptimtë po të përgjigjej “në trurin tim” si në shembullin e mësipërm. Në të dyja rastet, entiteti që sheh dhe percepton nuk është në truri, që sipas të gjithave nuk është gjë tjetër pos një copë mishi.

Kur të analizojmë trurin, ne nuk shohim tjetër pos molekula të lipoideve dhe proteinave, që gjithashtu ekzistojnë edhe në organizmat tjerë të gjallë. Kjo nënkupton se brenda një cope mishi që ne e quajmë “tru”, nuk ka asgjë për t’i observuar imazhet, që përbën vetëdijen, apo që të krijojë qenien që ne e quajmë “vetvete”.

R.L. Gregory i referohet gabimit që njerëzit e bëjnë në lidhje me perceptimin e imazheve në tru:

Kjo është një joshje, që duhet t’i shmangemi, që të thuhet se sytë prodhojnë pamjet në tru. Pamja në tru sugjeron nevojën për një lloj syri të brendshëm që të sheh – por kjo do të ketë nevojë edhe për një sy tjetër që të shoh këtë pamje... etj., etj. në një nevojë të pafund të syve dhe të pamjeve. Kjo është absurde.¹⁷

Kjo është ajo pikëpamja që i ven materialistët, që nuk mbajnë asgjë tjetër pos materies që të jetë e vërtetë, në mëdyshje; kujt i takon “syri brenda” që sheh, që percepton çfarë sheh dhe reagon?

Karl Pribram gjithashtu fokusohet në këtë çështje të rëndësishme, se kush është perceptues, në botën e shkencës dhe filozofisë:

*Që nga grekët, filozofët kanë menduar rreth “shpirtit” në makinë, “njeriu i vogël brenda njeriut të vogël”, etj. **Ku është “uni”, qenia që e përdorë trurin? Kush e bën të diturit e vërtetë? Ose, si Shën Francis nga Assisi thotë: “Ne po kërkojmë atë që sheh”.**¹⁸*

Tani, mendo për këtë gjë: libri që e ke në duar, dhoma në të cilën gjendesh, shkurtimisht, të gjitha imazhet përpara teje shihen brenda trurit tënd. A janë atomet ato që i shohin këto imazhe? Atomt e verbëta, të shurdhëta dhe të pavetëdijshme? Pse disa atome e kanë këtë cilësi derisa të tjerat nuk e kanë? A përbëhen veprimet tona të të menduarit, të kuptuarit, të mbajturit mend, të gëzuarit, të hidhëruarit dhe çdo gjë tjetër prej reaksioneve elektrokimike në mes të këtyre atomeve?

Kur e vrasim mendjen me kësi lloj pyetjesh, shohim se nuk ka kuptim që të shikohet në vullnetin e atomeve. Është e qartë se qenia që sheh, dëgjon, dhe ndien është një qenie mbi-materiale. Kjo qenie është “e gjallë” dhe as nuk është materie apo shëmbëlltyrë e materies. Kjo qenie lidhet me perceptimet përpara saj duke përdorur imazhin e trupit tonë.

Kjo qenie është **“shpirti”**.

Bashkësia e perceptimeve që e quajmë “botë materiale” është një ëndërr e shikuar nga ky shpirt. Sikurse trupi që e kemi dhe bota materiale që ne e shohim në ëndrrat tona nuk kanë realitet, gjithashtu edhe gjithësia që ne e okupojmë dhe trupin që e kemi nuk kanë realitet material.

Qenia e vërtetë është shpirti. Materia përmban vetëm perceptimet e shikuar nga shpirti. Qeniet inteligjente që i shkruajnë dhe i lexojnë këta rreshta nuk janë grumbuj atomeash apo molekulash si dhe reaksione kimike në mes tyre, por është “shpirt”.

Qenia absolute e vërtetë

Të gjitha këto fakte na sjellin përballë një çështje shumë të rëndësishme. Nëse gjëja që ne e njohim si botë materiale përbëhet vetëm nga perceptimet të para nga shpirti ynë, atëherë ku është burimi i këtyre perceptimeve?

Në të përgjigjurit e kësaj pyetjeje, duhet pasur parasysh çështjen në vazhdim: materia vetvetiu nuk ka ekzistencë të vetëqeverisje. Pasi materia është perceptim, është diçka “artificiale”. Dmth, ky perceptim duhet të jetë i shkaktuar nga një fuqi tjetër, që dmth duhet të jetë i krijuar. Përveç kësaj, ky krijim duhet të jetë i vazhdueshëm. Nëse nuk ka krijim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, atëherë krejt çka ne e quajmë materie do të zhdukej dhe humbej. Kjo mund të lidhet me televizionin në të cilin piktura shfaqet derisa sinjali të transmetohet. Pra, kush bën që shpirti ynë t'i shoh yjet, tokën, bimët, njerëzit, trupat tonë dhe çdo gjë tjetër që shohim?

Është shumë evidente se është një Krijues, i Cili e ka krijuar tërë gjithësinë materiale, e kjo është, shumica e perceptimeve, dhe vazhdon krijimin e Tij pandërprerë. Pasi ky Krijues paraqet aq krijim të mrekullueshëm, Ai sigurisht ka fuqi të madhe dhe të përhershme.

Ky Krijues na prezantohet. Ai e ka shpallur Librin dhe përmes këtij Libri e ka përshkruar Vetën, gjithësinë dhe arsyen pse ne ekzistojmë.

Ky Krijues është Allahu dhe emri i Librit të Tij është Kur'ani.

*Përse, pra kur arrin shpirti në fytyrë, e ju në atë moment shikoni (se ç'po i ngjet). E Ne jemi më afër tek ai se ju, por ju nuk shihni.
(Wakia: 83-85)*



Nëse dikush mendon thellë në atë se çfarë po thuhet këtu, së shpejti vetvetiu do të kuptojë këtë gjendje të jashtëzakonshme dhe të mrekullueshme: se të gjitha ngjarjet në botë janë vetëm imagjinatë..

Faktet se qiejt dhe toka, dmth, gjithësia nuk është e qëndrueshme, dhe se prania e tyre është bërë e mundur me krijimin e tyre nga Allahu dhe se ato do të zhduken kur Ai përfundon këtë krijim, shpjegohen në këtë ajet:

All-llahu i mban qiejt dhe tokën që të mos zhduken, e nëse zhduken, s'ka askush pos Tij që mund t'i mbajë; Ai është që nuk ngutet, është që falë. (Fatir: 41)

Siç përmendëm në fillim, disa njerëz nuk kanë kuptim të vërtetë mbi Allahun ashtu që Atë e paramendojnë si qenie që është i pranishëm diku në qiejt dhe që nuk ndërhyr në çështjet e kësaj bote. Themeli i kësaj logjike në të vërtetë gjendet në mendimin se gjithësia është një ndërtim nga materia dhe Allahu është “jashtë” kësaj bote materiale, në një vend shumë të largët. Në disa fë të rreme, besimi në Allahun është i kufizuar në këtë kuptim.

Mirëpo, siç konsideruam deri më tani, materia përbëhet vetëm nga ndjenjat. Dhe se qenia e vetme absolute e vërtetë është Allahu. Kjo nënkupton. se ekziston vetëm Allahu; dhe të gjitha gjërat përpos Tij janë qenie nën hije. Si pasojë, është e pamundur që të përfytyrohet Allahu i ndarë dhe jashtë masës së materies. Allahu sigurisht është “gjithkah” dhe i përfshinë të gjithat. Ky realitet shpjegohet në Kur’an si vijon:

All-llahu - s’ka zot pos Tij. I Gjalli, Vigjiluesi. Nuk e zë të koturit, e as gjumi. E Tija është ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë te Ai, pos me lejen e Tij? Ai e di se ç’po u ndodhë dhe ç’do t’u ndodhë. Dhe asgjë nga dija e Tij nuk mund të përvetësojnë, pos sa të dojë Ai. Ndërsa pushteti i Tij përfshin qiejt dhe tokën. E nuk lodhet duke i ruajtur (mirëmbajtur), ngase Ai është i Larti, Madhështori. (Bekare: 255)

Që Allahu nuk kufizohet me hapësirë dhe që Ai përfshinë çdo gjë tregohet në ajetin si vijon:

Të All-llahut janë edhe (anët nga) lindja edhe nga perëndimi, **dhe kahëdo që të ktheheni, aty është anë e All-llahut.** Vërtetë, All-llahu është i gjerë (në bujari) e i dijshtëm. (Bekare: 115)

Pasi qeniet materiale janë vetëm perceptime, ato nuk mund ta shohin Allahun; por Allahu e sheh materien dhe Ai e ka krijuar atë në të gjitha format. Në Kur’an, kjo tregohet kështu: “Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai i përfshinë të parët.”(En’am: 103)

Pra, ne nuk mund ta përfshijmë (kuptojmë, shohim) qenien e Allahut me sytë tanë, por Allahu plotësisht neve na ka përfshirë brendësinë tonë, pjesën e jashtme, shikimet dhe mendimet tona. Nuk mund ta shqiptojmë asnjë fjalë pa e ditur Ai, bile pa dijen e Tij as frymë nuk mund të marrim.

Derisa jemi duke i parë këto perceptime shqisore gjatë jetës sonë, qenia më e afërt e jona nuk është asnjëra nga këto ndjenja, por Vetë Allahu. Fshehtësia e ajetit në vazhdim në Kur’an zbulon këtë realitet: “Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç’pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (që rrah) i qafës së tij. “(Kaf: 16) Kur dikush mendon se trupi i tij është i përbërë vetëm nga “materia”, ai nuk mund që të kuptojë këtë fakt të rëndësishëm. Nëse e merr trurin e tij që të jetë “vetvetja”, atëherë vendi ku ai pranon të jetë është 20-30 cm larg tij. Mirëpo, kur të kuptojë se nuk ka asgjë nga ajo që quhet materie, dhe se çdo gjë është vetëm një

imagjinatë, nocionet si jashtë, brenda, larg apo afër humbin kuptimin e tyre. Allahu e ka përfshirë atë dhe Ai është “skajshmërisht afër” tij.

Allahu e informon njeriun se Ai është “skajshmërisht afër” tyre me ajetin “E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër...” (Bekare: 186). Ajeti tjetër tregon për faktin e njëjtë: “Përkujto, kur Ne të thamë: “Zoti yt ka përfshirë (me dijen e Vet) të gjithë njerëzit...” (Isra: 60).

Njeriu mashtrohet duke menduar se qenia më e afërt e tij është vetvetja. Allahu, në të vërtetë, është më afër bile edhe se vetë ne. Ai na e ka tërheqë vëmendjen për këtë gjë në ajetin: **“Përse, pra kur arrin shpirti në fyt, E ju në atë moment shikoni (se ç’po i ngjet). E Ne jemi më afër tek ai se ju, por ju nuk shihni.** (Wakia: 83-85). Siç na tregon ajeti, njerëzit janë të pavetëdijshëm për këtë fakt të jashtëzakonshëm pasi nuk e shohin me sytë e tyre.

Nga ana tjetër, është e pamundur për njeriun, që nuk është gjë tjetër përpos një qenie nga hija që të ketë fuqi dhe vullnet të pavarur nga Allahu. Ajeti **“E All-llahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni.”** (Saffat: 96) tregon se çdo gjë që e përjetojmë bëhet nën kontrollin e Allahut. Në Kur’an, ky realitet qëndron në ajetin: **“... ti nuk i gjuajte, (në të vërtetë) kur i gjuajte ata, por All-llahu (të ndihmoi) i gjuajti”** (Enfal: 17) ku theksohet se asnjë vepër nuk është e pavarur nga Allahu. Pasi qenia njerëzore është qenie nga hija, ai vetë nuk e bën aktin e gjuajtjes. Por, Allahu i jep kësaj qenie nga hija ndjenjën e vetvetes. Në realitet, Allahu i bën të gjitha veprimet. Nëse dikush i merr veprimet që i bën si te vetët, ai qartë e mashtron vetveten.

Ky është realiteti. Dikush mund të mos dëshiroj që të pranoj këtë dhe mund ta paramendojë vetveten si qenie të pavarur nga Allahu; por kjo nuk do të ndryshojë ndonjë gjë. Natyrisht mohimi i tij i pamatur është prapë brenda vullnetit dhe dëshirës së Allahut.

Çdo gjë që posedon është iluzion i brendshëm

Siç po shihet qartë, është fakt logjik shkencor se “bota e jashtme” nuk ka realitet material dhe që është koleksion i imazheve përherë të shfaqura shpirtit tonë nga Allahu. Megjithatë, njerëzit nuk e përfshijnë, apo më saktë nuk dëshirojnë që t’i përfshijnë, të gjitha në konceptin e “botës së jashtme”.

Mendo për këtë çështje sinqerisht dhe me guxim. Do të kuptosh se shtëpia juaj, mobilet, vetura – që ndoshta janë blerë para ca kohe, zyra, stolitë, llogaria bankare, gardëroba, bashkëshortja, fëmijët, kolegët dhe çdo gjë që i ke në fakt përfshihen në këtë botë të jashtme të imagjinuar që projektohet tek ti. Çdo gjë që sheh, dëgjon, apo nuhat – shkurtimisht – i pranon me pesë shqisat tuaja rreth teje si pjesë e kësaj “bote të imagjinuar”: zëri i këngëtarit të preferuar, fortësia e karriges që je ulur mbi të, era e parfumit që të pëlqen, dielli që të mban ngrohtë, lulja me ngjyra të bukura, zogu duke fluturuar përkaj dritares sate, barka motorike duke lëvizur me shpejtësi mbi ujë, kopshti juaj i pëlleshëm, kompjuteri i juaj që e përdorni në zyre, apo pajisja hi-fi në shtëpi që është punuar me një teknologji moderne...

Ky është realiteti, pasi bota është vetëm koleksion i imazheve të krijuara për ta sprovuar njeriun. Njerëzit sprovohen gjatë gjithë jetës së tyre të kufizuar me perceptime duke mos pasur realitet. Këto perceptime janë shfaqur me qëllim si tërheqëse dhe joshëse. Ky fakt përmendet edhe në Kur'an:

Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po te All-llahu është e ardhmja më e mirë. (Ali-Imran: 14)

Shumica e njerëzve largohen nga feja e tyre për shkak të lakmisë ndaj pasurisë, grumbullimit të arit dhe argjendit, dollarëve, stolive, llogarive bankare, kartelave të kredisë, gardërobës së shumtë, veturave të modeleve të fundit, shkurtimisht pas të gjitha formave të prosperitetit që ata i kanë apo përpiqen që t'i kenë. Ata përqendrohen vetëm në këtë botë duke e harruar ahiretin. Ata janë të mashtruar nga pamja “tërheqëse dhe e bukura” e jetës së kësaj bote, e harrojnë të falin namazin, të japin lëmoshë për të varfrit, dhe të bëjnë ibadet që të jenë të suksesshëm në ahiret. Përkundrazi ata thonë “Kam gjëra për të bërë”, “kam ideale”, “kam përgjegjësi”, “nuk kam mjaft kohë”, “më duhet t'i kryej disa punë” dhe “do ta kryej më vonë”. Ata e jetojnë jetën e tyre duke kërkuar prosperitetet vetëm në këtë botë. Në ajetin, **“Edhe atë që dinë nga jeta e kësaj bote, është dije e cekët, por ndaj jetës së përjetshme (ndaj Ahiretit) ata janë plotësisht të verbëruar (të pa-interesuar)”** (Rum:7), shpjegohet ky botëkuptim i gabuar.

Faktin që e kemi shpjeguar në këtë kapitull, dmth se çdo gjë është imazh, është shumë i rëndësishëm për nënkuptimin e tij se i paraqet të gjitha epshet dhe kufizimet të pakuptimta. Vërtetimi i këtij fakti e bën të qartë se çdo gjë që njerëzit kanë apo përpiqen që ta kenë – pasurinë të fituar me lakmi, fëmijë me të cilët krenohen, gratë që ata i konsiderojnë si më të afërtat, miqtë, trupi i tyre i dashur, statuti shoqëror që ata besojnë të jetë superior, shkollat që i kanë kryer, pushimet në të cilat kanë kaluar – nuk janë tjetër përveçse iluzion i thjeshtë. Prandaj, e gjithë përpjekja, koha e kaluar dhe lakmia, dëshmon kotësinë.

Për këtë disa njerëz padashur bëhen të marrë kur krenohen me pasurinë dhe pronën apo për “jahtet, helikopterët, kompanitë, fabrikat, çifligjet, aksionet dhe tokat” e tyre sikur ato të ekzistojnë në të vërtetë. Këta njerëz të pasur që mburren sa për t’u dukur udhëtojnë me jahte, tregojnë veturat e tyre, flasin pandërprerë për pasurinë e tyre, mendojnë se postet e tyre i vënë ata më lartë se të tjerët dhe mendojnë se ata janë të suksesshëm për tëra këto gjëra, në të vërtetë duhet që të mendojnë se në çfarë gjendje do ta gjejnë veten kur të kuptojnë se suksesi nuk është asgjë tjetër përpos një iluzion.

Këto pamje janë parë shumë shpesh edhe nëpër ëndërr. Në ëndrrat e tyre, ata gjithashtu kanë shtëpi, vetura të shpejta, stoli shumë të çmuara, tufa dollarësh, dhe sasi të mëdha të arit dhe të argjendit. Në ëndrrat e tyre, ata gjithashtu janë në pozita të larta, kanë fabrika me mijëra punëtorë, kanë fuqi për të sundojnë mbi shumë njerëz dhe veshën për lakmi të gjithëve. Sikurse do të ishte qesharake që dikush, duke u zgjuar, të mburret me pasurinë e tij në ëndërr, ai do të jetë po ashtu qesharak për mburrjen me imazhet që ai i sheh në këtë botë. Që të dyja atë që e ka parë në ëndërr edhe atë që e ka parë në këtë botë janë vetëm imazhe në mendjen e tij.

Në të njëjtën mënyrë, njerëzit që reagojnë ndaj ngjarjeve që ata përjetojnë në botë do të turpërohen kur të kuptojnë këtë realitet. Ata që pamëshirshëm luftojnë me njëri tjetrin, tërbohohet shpejt, mashtron, merr mito, falsifikon, gënjen, me lakmi e mban paranë e vet, i bën keq njerëzve, i rrah dhe i mallkon të tjerët, sillet agresivisht, janë plot lakmi për zyrë dhe pozitë, janë ziliqarë dhe tregohen, do të jenë të turpshëm kur të kuptojnë se krejt çfarë kanë bërë ka qenë vetëm një ëndërr.

Pasi Allahu i krijon të gjitha këto imazhe, Poseduesi Përfundimtar i të gjithave do të jetë vetëm Allahu. Edhe ky fakt theksohet në Kur'an:

Vetëm të All-llahut janë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. All-llahu ka përfshirë çdo send. (Nisa: 126)

Është gabim i madh të hedhet poshtë feja për hir të pasioneve imagjinare e prandaj të humbet jeta e përjetshme.

Në këtë fazë, një gjë duhet të kuptohet. Nuk është thënë këtu se “pasuria, fëmijët, prona, bashkëshortet, miqtë, pozita që e keni arritur do të zhduket herët a vonë, e prandaj ato nuk kanë kurrfarë kuptimi”, por se “të gjitha pasuritë që iu duken se i keni nuk ekzistojnë, por janë vetëm ëndrra që përbëhen nga imazhet që Allahu t'i tregon që t'iu sprovonë”. Siç po shihet, është ndryshim i madh ndërmjet këtyre dy thënieve.

Edhe pse dikush nuk dëshiron që të pranojë këtë menjëherë dhe i duket se është më mirë që të mashtrohet duke menduar se çdo gjë me të vërtetë ekziston, në fund do të vdesim e çdo gjë do të bëhet e qartë në ahiret kur të ringjallemi. Në atë ditë “sheh shumë mprehtë. “ (Kaf: 22) dhe do të shohim çdo gjë shumë më qartë. Sidoqoftë, nëse kemi jetuar duke vrapuar pas qëllimeve imagjinare, ne do të dëshironim pastaj që mos të kishim jetuar kurrë në këtë jetë dhe duke thënë “Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja e parë) mbarim i amshueshëm për mua. Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja. “ (Hakka: 27-29).

Çfarë duhet të bëj njeriu i mençur, nga ana tjetër, është që të përpiqet që të kuptojë realitetin më të madh të gjithësisë këtu në këtë botë, derisa ende ka kohë. Përndryshe, ai do të jetojë duke vrapuar pas ëndrrave dhe do të përballet me dënimin e hidhur në fund. Në Kur'an, gjendja përfundimtare e këtyre njerëzve të cilët vrapojnë pas iluzioneve (imazheve) në këtë botë dhe e harrojnë Krijuesin e tyre, tregohet kështu:

E veprat e atyre që nuk besuan janë si fatamorganë (nga rrezet e diellit) në një shkretinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t'i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty e gjen All-llahun dhe Ai do t'ia japë llogarinë e tij. All-llahu është i shpejtë në llogaritje. (Nur: 39)

Për ty, realitet është çdo gjë që mund të preket me dorë dhe shihet me sy. Në ëndrra gjithashtu mund “të prekësh me dorë dhe të shikosh me sy”, por në të vërtetë, nuk ke as dorë e as sy prandaj nuk ka asgjë që mund të preket apo shikohet. Nuk ka realitet material që bën që këto gjëra të ndodhin përpos në trurin tënd. Thjeshtë, je i mashtruar.

Çfarë është ajo që e ndan jetën e vërtetë dhe ëndrrat? Përfundimisht, të dy format e jetës lindin brenda në tru. Nëse jemi të aftë që të jetojmë qetë në një botë të pavërtetë gjatë ëndrrës, nuk ka arsye logjike të mos mendohet se kemi hyrë në një ëndërr më të gjatë të quajtur “jetë e vërtetë”. Arsyeja që ne ëndrën e konsiderojmë si fantazi ndërsa botën “reale” është vetëm një produkt i natyrës dhe paragjyqimeve tona. Kjo sugjeron se ne mund të zgjohemi nga kjo jetë në tokë, të cilën jemi duke menduar se jemi duke e jetuar mu tani, sikurse të ishim zgjuar nga ëndrra.



Defektet logjike të materialistëve

Prej fillimit të këtij kapitulli, është thënë qartë se materia nuk është genie absolute, siç pohojnë materialistët, por më saktë është një koleksion i përshtypjeve të shqisave të krijuara nga Allahu. Materialistët i rezistojnë këtij realitet evident, që e shkatërron filozofinë e tyre në mënyrë ekstreme dogmatike dhe i paraqet si të pabaza antitezat.

Për shembull, njëra ndër përkrahësit më të mëdhenj të filozofisë materialiste në shek. 20, një marksist i flaktë, George Polizer, e dha “shembullin e autobusit” si “dëshminë më të madhe“ mbi ekzistencën e materies. Sipas Polizerit, filozofët që mendojnë se materia është vetëm perceptim gjithashtu ikin kur ta vërejnë autobusin që do t’i shkelë ata dhe kjo është dëshmi e ekzistimit fizik të materies.¹⁹

Kur materialisti tjetër i famshëm, Johnson, i është thënë se materia është koleksion i perceptimeve, ai “u përpoq” që të dëshmojë ekzistimin fizik të gurëve duke i shqelmuar.²⁰

Shembull i ngjashëm është dhënë edhe nga Friedrich Engels, mentor Politzerit dhe themelues së bashku me Marksins i materializmin dialektik. Ai shkroi, “nëse ëmbëlsira që e hamë është vetëm perceptim, atëherë ajo nuk do të na e ndalonte urinë tonë.”²¹

Ka edhe shembuj të ngjashëm si dhe fjalë fyese si “do ta kuptosh ekzistencën e materies kur ta hash shuplakën në faqe” në librat e materialistëve të njohur si Marks, Engelsi, Lenini e tjerë.

Çrregullimi në të kuptuarit që lejon të depërtojnë shembujt e tillë të materialistëve është interpretimin e shpjegimit i tyre i “materies është perceptim” sikur “materia është mashtrim me dritë”. Ata mendojnë se perceptimi është i kufizuar me shikim dhe të gjitha aftësitë tjera si prekja kanë lidhje fizike. Autobusi e godet njeriun i bën ata të thonë “shiko, autobusi e rroku, pra nuk është perceptim”. Ata fare nuk e kuptojnë se perceptimet gjatë goditjes, si fortësia, ndeshja dhe dhimbja, gjithashtu janë të formuara në tru.

Shembulli i ëndrrave

Shembulli më i mirë për të shpjeguar këtë realitet është ëndrra. Personi mund të përjetojë ngjarje shumë reale në ëndërr. Ai mund të rrokulliset poshtë shkallëve dhe ta thyej këmbën, të përjetoj fatkeqësi trafiku, të goditet nga autobusi, apo që të han ëmbëlsirë e të ngopet. Ngjarje të ngjashme me ato që i përjetojmë në jetën tonë të përditshme përjetoohen edhe në ëndrra me ndjenjë të njëjtë bindëse për realitetin e tyre, dhe ngjallin ndjenja të njëjta në ne.

Ai që ëndërron se është goditur nga autobusi mund t’i hap sytë në spital dhe të jetë prapë në ëndërr dhe mund të kuptojë se është mbetur i

palëvizshëm, por krejt kjo është vetëm ëndërr. Ai gjithashtu mund të ëndërrojë se ka vdekur në ndeshje komunikacioni, se engjëjt e vdekjes ia marrin shpirtin dhe se jeta në ahiret fillon. (Kjo ngjarje e fundit është përjetuar në të njëjtën mënyrë në këtë jetë, e që sikurse në ëndërr, është një perceptim.)

Ky person percepton imazhe e zëra shumë të qarta, ndjenjën e fortësisë, dritën, ngjyrat dhe ndjenjat tjera që i përngjan përjetimit në ëndërr. Perceptimet që ai i pranon në ëndërr janë aq natyrale si ato në jetën e “vërtetë”. Ëmbëlsira që ai e han e ngop atë edhe pse është vetëm një perceptim i ndjesisë së ëndrrës, pasi ngopja është perceptim i ndjesisë së ëndrrës. Sidoqoftë në realitet, ky person gjendet i shtrirë në atë çast. Aty nuk ka as shkallë, komunikacion apo autobus që të merren parasysht. Personi që ëndërron, e përjeton ëndrrën dhe i sheh perceptimet dhe ndjenjat që nuk ekzistojnë në botën e jashtme. Fakti se në ëndrrat tona, përjetojmë, shohim dhe ndjejmë ngjarjet pa lidhje fizike me “botën e jashtme” tregon qartë se “bota e jashtme” e jetës sonë zgjuar gjithashtu përbëhet absolutisht vetëm nga perceptimet.

Ata që besojnë në materializëm, posaçërisht marksistët, janë tërbuar kur iu është treguar ky realitet, esenca e materies. Ata citojnë shembuj nga arsyetimet sipërfaqësore të Marksit, Engelsit apo Leninit dhe bëjnë deklaratat emocionale.

Sidoqoftë, këta njerëz duhet pasur në mend se ata mund të japin asi lloj deklaratash edhe në ëndrrat e tyre. Në ëndrrat e tyre, gjithashtu mund ta lexojnë “*Kapitalin*”, të marrin pjesë në mbledhje, të përlëshen me policinë, të goditën në kokë, të ndjejnë dhimbje në plagët e tyre. Kur të pyetën në ëndërr, ata mendojnë se çfarë kanë ëndërruar gjithashtu përbëhet nga “materia absolute”, ashtu siç supozojnë se gjërat që i shohin kur janë zgjuar janë “materie absolute”. Sidoqoftë, në ëndërr apo zhgëndërr, krejt çfarë shohim, përjetojmë apo ndjejmë janë vetëm perceptime.

Shembulli i lidhjes së nervave në mënyrë paralele

Të paramendojmë ndeshjen me automobil të dhënë nga Politzer në të cilën ai foli për dikë që e kishte goditur vetura. Nëse nervat e personit të goditur nga vetura që lëvizin nga pesë shqisat e tij deri tek truri, do t'i

lidheshim me një person tjetër, p.sh. trurin e Politzerit, me lidhje paralele, në momentin kur vetura e godit personin, do ta godiste po në të njëjtën kohë edhe Politzerin duke ndenjtur në shtëpi. Të gjithat çfarë e ka ndier personi gjatë aksidentit do të përjetonte edhe Politzeri, sikurse kënga e njëjtë e dëgjuar nga dy altoparlantë të ndryshëm të lidhur me magnetofonin e njëjtë. Politzeri do të ndjente, shihte dhe përjetonte frenimin e autobusit, prekjen e autobusit në trupin e tij, imazhet e krahut të thyer dhe gjakun, thyerjet, imazhet e hyrjes së tij në dhomën e operacionit, fortësinë e gipsit si dhe pafuqinë e krahut të tij.

Çdo njeri tjetër i lidhur paralel me nervat e këtij njeriu do të përjetonte aksidentin sikurse Politzeri që nga fillimi gjer në fund. Nëse i aksidentuari do të binte në komë, të gjithë do të binin në komë. Përveç kësaj, nëse të gjitha perceptimet që kanë lidhje me aksident të regjistroheshin në ndonjë aparat dhe nëse të gjitha këto perceptime do t'i transmetoheshin një personi duke e përsëritur, atëherë edhe autobusi do të godiste këtë person shumë herë.

Pra, cili nga autobusët që kanë goditur këta njerëz është i vërtetë? Filozofia materialiste nuk ka përgjigje të qëndrueshme për këtë pyetje. Përgjigja e drejtë është se ata të gjithë kanë përjetuar aksidentin me të gjitha detajet vetëm në mendjen e tyre.

Principi i njëjtë aplikohet edhe tek shembujt me ëmbëlsirën dhe gurin. Nëse nervat e organeve shqisore të Engelsit, i cili do të ndjente ngopjen dhe plotësinë e ëmbëlsirës në barkun e tij pas ngrënies së ëmbëlsirës, do të ishin të lidhur me trurin e personit tjetër në mënyrë paralele, edhe ai person do të ndihej i ngopur kur Engeli do të hante ëmbëlsirën dhe të ngopej. Nëse nervat e Johnsonit, i cili ndien dhembjen në këmbën e tij nëse e shqelmon gurin, të ishin të lidhur paralelisht me personin tjetër, ai person do ta ndiente dhembjen e njëjtë.

Pra, cila ëmbëlsirë apo cili gur është i vërtetë? Filozofia materialiste prapë është e mangët që të jap përgjigje të duhura në këtë pyetje. Përgjigja korrekte dhe e duhur e kësaj pyetje është: të dy, Engeli dhe personi i tjetër që ka ngrënë ëmbëlsirën në mendjen e tyre dhe janë ngopur; të dy, Johnsoni dhe personi tjetër kanë përjetuar njëjtë shkëlqimin e gurit në mendjen e tyre.

Ta bëjmë një ndryshim në shembullin që e dhamë për Politzer: t'i lidhim nervat e njeriut të goditur nga autobusi në trurin e Politzerit dhe nervat e Politzerit që është ulur në shtëpinë e tij në trurin e njeriut që është goditur me autobus. Në këtë rast, Politzeri do të mendonte se është goditur nga autobusi edhe pse është duke ndenjur në shtëpinë e tij. Njeriu që në të vërtetë është goditur nga autobusi kurrë nuk do ta ndjejë efektin e aksidentit dhe do të mendonte se ai është duke ndenjur në shtëpinë e Politzerit. Logjika e njëjtë mund të aplikohet edhe me shembujt e ëmbëlsirës dhe gurit.

Siç po shohim, nuk është e mundur që njeriu të çlirohet nga shqisat e tij dhe të lirohet plotësisht. Nga ky këndvështrim, shpirti i njeriut mund t'u ekspozohet të gjitha llojeve të paraqitjeve të ngjarjeve fizike edhe pse nuk ka trup fizik dhe ekzistim material dhe i mungon pesha materiale. Nuk është e mundur për një njeri që të kuptojë këtë pasi ai mendon se imazhet tri-dimensionale janë të vërteta dhe është i sigurt në ekzistimin e tyre pasi, si çdonjëri, varet nga perceptimet që i përjeton përmes organeve të veta shqisore.

Filozofi i njohur britanik David Hume i shpreh mendimet e veta në lidhje me këtë fakt:

*Të flasim sinqerisht, kur përfshijë veten në atë që unë e quaj “vetja”, çdoherë has me një perceptim të veçantë që i përket të nxehtës apo të ftohtës, dritës apo hijes, dashurisë apo urrejtjes, të hidhurës apo të ëmblës apo ndonjë përfytyrim tjetër. kurrë nuk mund ta kap veten pa ndonjë perceptimit, **dhe kurrë nuk mund të vërej ndonjë gjë përveç perceptimit.** ²²*

Formimi i perceptimeve në tru nuk është filozofi, por fakt shkencor

Materialistët pohojnë se çfarë thamë deri më tani është një pikëpamje filozofike. Sidoqoftë, konsiderimi se “bota e jashtme”, siç e quajtëm ne, është një koleksion i perceptimeve nuk është çështje filozofike por thjeshtë një fakt shkencor. Se si formohen imazhet dhe ndjenjat në tru në detaje mësohet në shkollat e medicinës. Këto fakte, të dëshmuara në shek. 20-të nga shkenca e në veçanti nga fizika, qartë tregon se materia nuk ka realitet

absolut dhe kështu, në njëfarë mënyre, çdonjëri është duke e shikuar “monitorin në trurin e vet”.

Çdokush që beson në shkencë, pavarësisht se a është ateist, budist apo dikush që mban ndonjë pikëpamje tjetër, duhet që të pranojë këtë fakt. Materialistët mund të mohojë ekzistencën e Krijuesit por nuk mund të mohojnë këtë fakt shkencor.

Paafhtësia e Karl Marxit, Friederich Engelsit, Georges Politzerit dhe të tjerëve që të kuptojnë këtë fakt aq të thjeshtë dhe evident është befasues ende, edhe pse niveli i njohurive shkencore nga koha e tyre ishte ndoshta e pamjaftueshme. Në kohën tonë, shkenca dhe teknologjia kanë përparuar shumë dhe zbulimet e kohëve të fundit bënë që ky fakt të kuptohet shumë më lehtë. Materialistët, nga ana tjetër, janë të mbushur me frikë nga mundësia e kuptimit të këtij fakti, bile edhe pjesërisht, dhe duke e kuptuar se kjo në mënyrë definitive e shkatërron filozofinë e tyre.

Frika e madhe e materialistëve

Për pak kohë, asnjë përgjigje substanciale nuk ka ardhur nga qarqet materialiste turke në lidhje me këtë temë që është shtjelluar në këtë libër, dmth, faktin se materia është vetëm një perceptim. Kjo na jap një përshtypje se qëllimi ynë nuk është bërë tërësisht i qartë dhe se nevojitet sqarim i mëtutjeshëm. Sidoqoftë, edhe më përpara, është zbuluar se materialistët ndihen mjaft të shqetësuar për popullaritetin e kësaj teme dhe ndiejnë frikë të madhe për këtë gjë.


Për një kohë, materialistët me të madhe shfaqnin frikën dhe panikun e tyre në publikimet, konferencat dhe panelet e tyre. Fjalimet e tyre të pashpresa dhe shqetësuese bënë të kuptohet se ata lëngojnë nga kriza të rënda intelektuale. Rrënimi shkencor i teorisë së evolucionit, që ishte e ashtuquajtura bazë e filozofisë së tyre, u kishte ardhur si goditje e madhe. Tani, ata e kuptojnë se kanë filluar ta humbin vetë materien, që është shtyllë më kryesore për ta sesa darvinizmi, dhe se janë duke përjetuar goditje edhe më të madhe. Ata deklaruan se kjo çështje është “kërcënimi më i madh” për ta dhe se kjo krejtësisht e “shkatërron fabrikën e tyre kulturore”.

Njëri prej atyre që e shprehu më haptazi frikën dhe panikun që ndjehet

në qarqet materialiste ishte Renan Pekunlu, një akademik dhe shkrimtar i revistës *Bilim ve Utopya* (Shkenca dhe utopia) që është menduar se e ka detyrën për ta mbrojtur materializmin. Në artikujt e tij në “Shkenca dhe Utopia” dhe në panelet që ai ka marrë pjesë, ai prezantoi librin “*Gjunjëzimi i evolucionit*” nga Harun Yahya si kërcënim numër një ndaj materializmit. Çfarë e shqetësoi Pekunlun bile edhe më shumë sesa kapitujt që zhvlerësojnë darvinizmi, ishte pjesa që jeni duke e lexuar tani. Për lexuesit dhe publikun e vet, që së fundi ishin shumë të paktë, Pekunlu solli porosinë “mos e leni vetveten që të entuziazmoheni me sugjerimin e idealizmit por mbani besimin në materializëm”. Ai e citoi Leninin, udhëheqësin e revolucionit të përgjakshëm komunist në Rusi, si referim. Duke këshilluar çdonjërin që të lexojnë librin e tij të para një shekulli “*Materializmi dhe empiriokriticizmi*”, Pekunlu përsëriti këshillat e Leninit, “mos mendoni për këtë çështje, ose përndryshe do të humbni rrugën e materializmit dhe do të merreni pastaj me religjion”. Në një artikull që shkroi për revistën e lartshënuar, ai citoi Leninin:

*Nëse njëherë e mohoni realitetin objektiv, që na jepet me anën e shqisave, menjëherë do të humbni armën kundër fideistëve (mbrojtësve të fesë), ngase keni rrëshqitur në agnosticizëm apo subjektivizëm – dhe kjo është e tëra që fideizmi kërkon. **Vetëm një herë po të biesh në grackë, më nuk ka rrugëdalje.** Dhe mashistët tanë të gjithë janë rënë në grackën e idealizmit, në një fideizëm të dobësuar dhe të holluar; janë zënë në grackën që nga momenti kur morën “shqisat” jo sikur një imazh i botës së jashtme por një “element” special. Janë shqisa të askujt, mendje e askujt, shpirt i askujt, vullnet i askujt.²³*

Këto fjalë qartë tregojnë se fakti të cilin, Lenini, në panik, e kuptoi dhe dëshironte që t’ua largonte nga mendja e tij dhe të “shokëve” të tij, gjithashtu në të njëjtën mënyrë i shqetëson edhe materialistët e sotëm. Sidoqoftë, Pekunlu dhe materialistët tjerë vuajnë nga ankthi edhe më i madh; pasi ata



Shkrimtari materialist turk Renan Pekunlu thotë se “teoria e evolucionit nuk është aq e rëndësishme, kërcnimi i vërtetë është kjo çështje”, pasi që është i vetëdijshëm se kjo çështje anulon materien, të vetmin koncept që ai beson.

e dinë se ky fakt tani është duke ardhur më shumë në shprehje, më sigurt dhe më bindës sesa para 100 vjetësh. Për herë të parë në historinë botërore kjo temë është shpjeguar në mënyrë aq të pafrenueshme.

Megjithatë, piktura e përgjithshme është se numër i madh i shkencëtarëve materialistë ende marrin qëndrim sipërfaqësor kundër këtij fakti se "materia nuk është asgjë tjetër përpos një iluzion". Çështja e shpjeguar në këtë kapitull është njëra ndër temat më të rëndësishme dhe më ngacmuese që dikush mund të ndeshet në jetën e vet. Nuk ka shans që më përpara të jenë përballur me temë kaq kritike. Ende, reagimet e këtyre shkencëtarëve apo sjelljet e tyre filozofike në fjalimet dhe artikujt e tyre lënë të kuptohet se sa i cektë dhe sipërfaqësor është të kuptuarit e tyre.

Reagimet e disa materialistëve në lidhje me çështjen e debatuar këtu tregojnë se besnikëria e tyre ndaj materializmit ka shkaktuar një lloj dëmtimi të logjikës së tyre. Për këtë arsye, ata janë shumë larg të kuptuarit të çështjes. P.sh., Alaattin Senel, gjithashtu një akademik dhe shkrimtar për revistën periodike "*Shkenca dhe Utopia*", shfaq mendim të ngjashëm sikurse Pekunlu duke thënë: "Harroje gjuhëzimin e darvinizmit, kjo është temë që vërtetë kërcënon". Duke kuptuar se filozofia e vet nuk ka bazë, ai bëri kërkesa si "dëshmo se çfarë je duke folur!". Çfarë është më interesant, ky shkrimtar duke shkruar ka zbuluar se ai nuk mund ta kuptojë këtë fakt, çfarë ai e konsideron si rrezik.

P.sh., në artikullin që ai foli ekskluzivisht për këtë çështje, Seneli pranon se bota e jashtme perceptohet në tru si imazh. Sidoqoftë, ai pastaj vazhdon me pohimin se imazhet ndahen në dy pjesë: ato që kanë lidhje fizike dhe ato që nuk kanë, e se imazhet që janë të lidhura me botën e jashtme kanë lidhje fizike. Për të mbështetur këtë pohim, ai jep "shembullin e telefonit". Në përmbledhje ai shkruan: "Nuk e di se imazhet në trurin tim a kanë apo jo lidhje me botën e jashtme, por e njëjta gjë vlen kur flas me telefon. Kur të flas në telefon, nuk e shoh fytyrën e bashkëbiseduesit por kjo bisedë konfirmohet kur më vonë e shoh sy më sy."²⁴

Me këto fjalë, autori në të vërtetë mendon: "Nëse kemi dyshim në perceptimet tona, ne mund të shikojmë në vetë materien dhe të verifikojmë realitetin e saj." Sidoqoftë, kjo është ide e gabuar e evidente pasi është e pamundur që ne të arrijmë vetë materien. Ne kurrë nuk do të mund të dalim

nga mendja jonë dhe të dimë se çfarë është “përjashta”. Edhe nëse zëri në telefon ka apo jo lidhje me materien mund të konfirmohet nga personi nga skaji tjetër. Sidoqoftë, ky konfirmim është gjithashtu imazh, që përjetohet në mendje.

Këta njerëz edhe në ëndrrat e tyre përjetojnë gjëra të ngjashme. P.sh., Senel mund të shoh edhe në ëndërr që është duke biseduar në telefon dhe mandej të konfirmohet nga bashkëbiseduesi. Pekunlu mundet që në ëndrën e vet të ndiej veten “të kërcënuar” dhe t’i këshillojë njerëzit e vet që të lexojnë libra të vjetër të Leninit. Megjithatë, pavarësisht se çfarë bëjnë, këta materialistët kurrë nuk mund të mohojnë se ngjarjet që kanë përjetuar dhe njerëzit me të cilët kanë biseduar në ëndërr nuk janë asgjë pos perceptime.

Kush, pra, do të konfirmojë se imazhet në tru kanë korrelacion apo jo? Qeniet hije në tru? Padyshim, është e pamundur për materialistët që të gjejnë burim të informatave që mund të japin të dhëna në lidhje me botën e jashtme jashtë trurit dhe që t’i konfirmojë ato.

Të pranuarit se të gjitha perceptimet formohen në tru, por edhe supozimi se mund “të dilet” nga kjo dhe të konfirmuarit e perceptimeve nga bota e jashtme reale zbulon se kapaciteti intelektual i personi është i kufizuar dhe se arsyeja e tij është e shtrembëruar.

Sidoqoftë, çdo njeri me nivel normal të të kuptuarit dhe të arsyetimit shumë lehtë mund t’i kuptoj këto fakte. Çdo njeri i paanshëm e di, në lidhje me atë çfarë thamë deri më tani, se është e pamundur për të që me shqisat e tij të testojë ekzistimin e botës së jashtme. Por, siç duket bindja e verbër ndaj materializmit e shtrembëron kapacitetin racional të njerëzve. Për këtë arsye, materialistët e sotëm shfaqin disa të metat logjike në gjykimin e tyre sikurse mentorët e tyre që u munduan që të “dëshmojnë” ekzistimin e materies me shkëllim e gurit apo me ngrënien e ëmbëlsirave.

Gjithashtu duhet thënë se kjo nuk është situatë mahnitëse, pasi paaftësia për të kuptuar është tipar i zakonshëm i të gjithë jobesimtarëve. Në Kur’an, Allahu veçanërisht thotë se ata janë “popull që nuk kupton.” (Maide:58)

Materialistët kanë rënë në kurthin më të madhe në histori

Atmosfera e panikut që qëndron nëpër qarqet materialiste në Turqi, që ne i kemi përmendur vetëm disa shembuj, tregon se materialistët përballohen me një disfatë të plotë, që kurrë më parë nuk e kanë përjetuar në histori. Që materia është vetëm një perceptim është dëshmuar nga shkencat moderne dhe është parashtruar në mënyrë shumë të qartë, të hapur dhe efektive. Mbetet vetëm që materialistët të shohin dhe të pranojnë shembjen e tërë botës materiale në të cilët ata besojnë verbërisht dhe në të cilën mbështeten.

Mendimi materialist ka ekzistuar çdoherë gjatë rrjedhës historike të njerëzimit. Duke qenë shumë të sigurt në vetvete dhe në filozofinë që besojnë, ata u ngritën kundër Allahut i Cili i ka krijuar. Skenari që ata formuluan thotë që materia nuk ka as fillim e as fund, dhe e gjithë kjo nuk ka mundësi të ketë Krijues. Për shkak të arrogancës së tyre, ata mohuan Allahun dhe u strehuan tek materia, që ata besojnë se ka ekzistencë reale. Ata ishin aq të bindur në filozofinë e tyre sa që kurrë nuk menduan se ndonjëherë do të jetë mundshme të shtrohet një shpjegim që dëshmon të kundërtën.

Kjo është arsyeja pse faktet e treguara në këtë libër në lidhje me natyrën e vërtetë të materies i befasoi aq shumë këta njerëz. Ajo që është treguar këtu ka shkatërruar bazën e themelit të filozofisë së tyre dhe nuk ka lënë vend për diskutime të mëtutjeshme. Materia, në të cilën ata i bazojnë tërë mendimet, jetët, arrogancën dhe mohimin u zhdukën përnjëherësh. Si mund të ekzistojë materializmi kurse materia jo?

Njëra prej cilësive të Allahut është planifikimi i Tij kundër jobesimtarëve. Kjo thuhet në ajetin “Ata bënë plane, e All-llahu i asgjësonte, se All-llahu është më i miri planifikues.” (Enfal: 30)

Allahu i ka vënë në kurth materialistët duke i bërë që të mendojnë se materia ekziston dhe, duke e bërë këtë, i poshtëroj ata në mënyrë të paparë. Materialistët mendonin se pasuria, statusi e posti i tyre, shoqëria që i takonin, e tërë bota dhe çdo gjë tjetër ekziston me të vërtetë dhe u bënë arrogantë ndaj Allahut duke u mbështetur në këto. Ata e kundërshtuan Allahun duke qenë mburracak dhe me mosbesim të shtuar. Derisa e bënë këtë ata krejtësisht mbështeteshin në materie. Prandaj, ata kanë mungesë të të kuptuarit sa që nuk menduan se Allahu është gjithkrah rreth tyre.

Allahu tregon gjendjen në të cilën jobesimtarët janë drejtuar si rezultat i mendje-trashësisë së tyre:

A mos po të kurdisin ndonjë kurth, po ata që nuk besuan bijnë vetë në kurth. (Tur: 42)

Kjo sigurisht është edhe humbja më e madhe e tyre në histori. Duke u bërë arrogant, materialistët kanë qenë të mashtruar dhe kanë vuajtur humbje serioze në luftën që ata kryenin kundër Allahut duke sjellë diçka monstrooze kundër Tij. Ajeti “**Dhe ashtu (sikurse në Mekë) në çdo qytet kemi bërë kriminelët e tij pari, në mënyrë që të bëjnë dredhi në të, por nuk mashtrojnë tjetër kë pos veten e tyre dhe prapëseprapë nuk kuptojnë.**” (En’am: 123) tregon se sa të pavetëdijshëm janë këta njerëz që u ngritën kundër Krijuesit të tyre, dhe si do të përfundojnë. Në ajetin tjetër fakti i njëjtë tregohet kështu:

Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë. (Bekare: 9)

Derisa jobesimtarët përpiqen të mashtrojnë, ata nuk e kuptojnë një fakt shumë të rëndësishëm që është theksuar me fjalët “po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë” në këtë ajet. Ky është fakti se çdo gjë që ata përjetojnë është një fantazim i dizajnuar që të perceptohet nga ata, dhe të gjitha mashtrimet që ata shpikin janë vetëm imazhe të formuara në trurin e tyre sikurse çdo lloj veprimi që ata e bëjnë. Marrëzia e tyre i ka bërë që të harrojnë se ata janë vetëm me Allahun, e prandaj, ata janë zënë në kurth në planet e tyre tinëzare.

Jo më pak se jobesimtarët që jetuan më parë, ata që jetojnë sot përballen me një realitet që do të shkatërrojë planet e tyre tinëzare në themel. Me këtë ajet “**... s’ka dyshim se intriga e djallit është e dobët**” (Nisa: 76), Allahu thotë se këto mashtrime janë të dënuara që të mbarojnë ditën që janë kurdisur. Ai u jap lajme të mira besimtarëve me këtë ajet “**... dinakëria e tyre nuk do t’u dëmtojë aspak.**” (Ali Imran: 120)

Në një ajet tjetër Allahu thotë: “**E veprat e atyre që nuk besuan janë si mirazh** në një shkretinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t’i

Në të vërtetë ju na erdhët një nga një (të vetmuar), ashtu si ju krijuam së pari; keni lënë prapa shpinës atë që u patëm dhënë... (En’am: 94)

afrohet atij nuk gjen asgjë.” (Nur: 39). Edhe materializmi, bëhet një “mirazh” për mohuesit sikurse qëndron në këtë ajet; kur kërkojnë mbështetje nga ajo, ata do të shohin se kjo krejt ka qenë iluzion. Allahu mund t’i mashtrojë ata me gjëra të tilla si mirazhi, dhe t’i çorientoj në perceptimin e tërë këtij koleksion të imazheve si të vërtetë. Të gjithë ata njerëz “eminentë”, profesorë, astronomë, biologë, fizikanët dhe të gjithë të tjerët pa marrë parasysh postin e tyre janë të mashtruar thjeshtë sikur fëmijët, dhe janë të poshtëruar pasi morën materien si zot të tyrin. Duke supozuar koleksionin e imazheve si absolute, ata e bazuan filozofinë dhe ideologjinë e tyre në të, duke u përfshirë në debate serioze, dhe adoptuan të ashtuquajturën ligjëratë “intelektuale”. Ata bindën vetveten se janë mjaft të mençur që të ofrojë një argument mbi të vërtetën e gjithësisë dhe çka është më e rëndësishme, të polemizojnë për Allahun me inteligjencën e tyre të kufizuar. Allahu shpjegon gjendjen e tyre në ajetin e mëposhtëm:

E, ata (jobesimtarët) i kurdisën një dredhi, All-llahu iu kundërvu dredhisë së tyre, All-llahu është asgjësuesi më i fuqishëm kundër atyre që bëjnë dredhi. (Ali Imran: 54)

Ndoshta mund t’i iket disa dredhive; sidoqoftë, ky plan i Allahut kundër jobesimtarëve është aq i vendosur saqë është e pamundur që t’i iket. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë apo kujt i kërkojnë ndihmë, ata nuk mund të gjejnë ndihmues tjetër pos Allahut. Siç na informon Allahu në Kur’an, **“... dhe pos All-llahut nuk do t’i gjejnë vetes as mbrojtës as ndihmës.”** (Nisa: 173)

Materialistët kurrë nuk pritën që të bien në kurth të tillë. Duke i pasur të gjitha mjetet e shek. 20-të në kontroll, ata menduan se mund të bëhen kokëfortë në mohimin e tyre dhe t’i tërheqin njerëzit në mosbesim. Allahu në Kur’an e shpjegon këtë mendësi të përhershme të jobesimtarëve dhe përfundimin e tyre:

Ata përgatiten një kurth e Ne ua shpërblyem kurthin duke mos e hetuar ata. Pra, vështro se çfarë ishte përfundimi i dredhisë së tyre. Në të vërtetë, Ne zhdukëm të gjithë ata dhe popullin e tyre. (Neml: 50-51)

Kjo, në nivel tjetër, është çfarë ajetet nënkuptojnë: materialistët janë bërë që të kuptojnë se çdo gjë që posedojnë nuk është asgjë tjetër veçse një iluzion, e prandaj çdo gjë që kanë është shkatërruar. Derisa ata i

vëzhgojnë pasuritë, fabrikat, arin, dollarët, fëmijët, gratë, shokët, pozitën dhe statusin dhe trupin e tyre, të cilat i besojnë se ekzistojë, duke u rëshqitur nga duart, ata janë të “shkatërruar”, siç thuhet në ajetin e 51-të të sures Neml. Në këtë pikë ata nuk janë më entitete materiale por vetëm shpirtra.

Padyshim, të kuptuarit e kësaj të vërtetën është gjendja më e vështirë për materialistët. Fakti që çdo gjë që kanë është vetëm një iluzion është i barasvlershëm, siç thonë ata, me “vdekjen para vdekjes” në këtë botë.

Ky fakt i lë vetëm me Allahun. Me ajetin **“Ti, më le Mua dhe atë që e krijova të vetmuar.” (Mudeththir: 11)** Allahu na përkujton që të kemi në mendje faktin se çdo njeri, në të vërtetë, është i vetmuar në praninë e Tij. Ky fakt i mrekullueshëm përsëritet në shumë ajete tjera:

**Në të vërtetë ju na erdhët një nga një (të vetmuar), ashtu si ju krijuam së pari; keni lënë prapa shpinës atë që u patëm dhënë... (En’am: 94)
Dhe në ditën e kiametit secili do t’i paraqitet Atij i vetmuar. (Merjem: 95)**

Kjo, në nivel tjetër, është çfarë tregojnë ajetet: ata që marrin materien si zot të tyrin rrjedhin nga Allahu dhe do t’i kthehen Atij. Ata do t’i nënshtrajnë vullnetin e tyre Allahut me apo pa dëshirën e tyre. Tani presin Ditën e Gjykimit kur çdokush do të thirret për të dhënë llogarinë e vet, pa marrë parasysh se a janë të gatshëm që ta kuptojnë.

Konkluzioni

Tema që e sqaruam deri më tani është njëra ndër të vërtetat më të mëdha që ndonjë herë do të dëgjosh në jetën tënde. Dëshmia se e gjithë bota materiale në të vërtetë është një **“imazh”**, kjo çështje është çelës për të kuptuar ekzistencën e Allahut dhe krijimin e Tij si dhe të kuptuarit se Ai është qenie e vetme absolute.

Njeriu që e kupton këtë çështje vëren se bota nuk është një vend ku shumica e njerëzve mendojnë se është. Bota nuk është një vend absolut me ekzistencë të vërtetë siç supozohej nga ata që bredhin pa qëllim të caktuar nëpër rrugë, rrahën nëpër kafene, tregohen nëpër kafene luksoze, mburren me pasurinë që kanë apo ata që ia kushtojnë jetën e tyre qëllimeve boshe. Bota është vetëm një koleksion i perceptimeve, një iluzion. Të gjithë njerëzit që i kemi cituar më lart janë vetëm hije që i

shikojnë këto perceptime në mendjen e tyre; e akoma, nuk janë të vetëdijshëm për këtë.

Ky koncept është shumë i rëndësishëm pasi minon **filozofinë materialiste** e cila mohon ekzistencën e Allahut dhe bën atë që të dështojë. Kjo është arsyeja pse materialistët si **Marxi, Engelsi** dhe **Lenini** ndjen panikun, u zemëruan dhe i paralajmëruan përkrahësit e tyre “që mos të mendojnë” në lidhje me këtë koncept kur të flitet për të. Këta njerëz janë me aq të meta mentale që nuk mundën as të kuptojnë se perceptimet formohen brenda trurit. Ata mendojnë se bota që e shohin në trurin e tyre është “bota e jashtme” e nuk mund të kuptojnë dëshminë e qartë që tregon të kundërtën.

Kjo pavetëdije është rezultat i mençurisë së pakët që Allahu iu ka dhënë jobesimtarëve. Siç thotë Allahu në Kur'an jobesimtarët “**kanë zemra që me to nuk kuptojnë**, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët.” (A'raf: 179)

Mund të hulumtosh pas kësaj pike duke përdorur të menduarit tuaj personal. Për këtë gjë, duhet që të koncentrohesh, përkushto vëmendjen dhe mendo thellë për mënyrën se si i sheh objektet rreth teje dhe mënyrën se si i ndjen kur t'i prekësh. Nëse mendon me plotë kujdes, do të ndjesh se qenia inteligjente që sheh, dëgjon, prek, mendon dhe lexon këtë libër mu në këtë çast është vetëm shpirti dhe shikon perceptimet e quajtura “materie” në ekran. Ai që e kupton këtë konsiderohet se është larguar nga fusha e botës materiale që mashtron pjesën më të madhe të njerëzve dhe ka hyrë në fushën e ekzistencës së vërtetë.

Ky realitet është kuptuar edhe nga një numër i madh i teistëve apo filozofëve gjatë historisë. Intelektualët islamikë si Imam Rabanni, Muhyddin Ibn al-'Arabi dhe Mawlana Jami kanë kuptuar këtë nga shenjat e Kur'anit dhe duke përdorur arsyen e tyre. Disa filozofë perëndimorë si George Berkley e kanë kuptuar realitetin e njëjtë përmes arsyes. Imam Rabbani në maktubatet (letrat) e tij ka shkruar se e tërë gjithësia është një “iluzion dhe supozim (perceptim)” dhe se Allahu është qenie e vetme absolute:

Allah...Substanca e këtyre qenieve që Ai krijoi është një asgjë hiç... Ai i krijoi të gjitha në sferën e shqisave dhe iluzioneve ... Ekzistimi i

gjithësisë është në sferën e shqisave dhe iluzioneve, dhe nuk është materiale... Në realitet, asgjë nuk është përjashta përpos Qenies Lavdiplotë, (e që është Allahu).²⁵

Imam Rabbani qartësisht ka thënë se të gjitha imazhet që i paraqiten njeriut janë veç iluzione, dhe se nuk ka gjëra origjinale në “botën e jashtme”.

*Ky qark i imagjinuar është i paraqitur në imagjinatë. Shihet deri në gjerësinë që është e paraqitur, sidoqoftë, **me syrin e mendjes**. Përjashta, duket sikur të shihet me syrin e kokës. Por, nuk është kështu. Nuk ka as paraqitje apo gjurmë të së jashtmes. As që ekzistojnë kushtet që të shihet. Është e njëjtë sikurse fytyra e dikuajt e reflektuar nga pasqyra. Nuk ka qëndrueshmëri përjashta. Padyshim, si qëndrueshmëria si imazhi janë në **IMAGJINATË**. Allahu e di më së miri.²⁶*

Mawlana Jami ka theksuar faktin e njëjtë, që e ka zbuluar prej shenjave të Kur’anit dhe duke përdorur mendjen e vet: **“Çfarëdo që ekziston në gjithësi janë shqisa dhe iluzione**. Më mirë të themi janë sikurse reflektimi nga pasqyra apo hijet”.

Sidoqoftë, numri i atyre që kanë e kuptuar këtë fakt gjatë historisë gjithmonë ka qenë i kufizuar. Dijetarët e mëdhenj si Imam Rabbani ka shkruar se ndoshta nuk do të ishte mençuri që t’u tregohet ky fakt masës njerëzore pasi shumica e njerëzve nuk janë në gjendje që ta kuptojnë.

Në kohën e sotme, kjo ka bërë një fakt empirik me dëshmitë e dhëna nga shkenca. Fakti që gjithësia është një hije, është përshkruar mënyrë aq konkrete, të qartë dhe të hollësishme për herë të parë në histori.

Për këtë shkak, shek. 21-të do të jetë pikë kthese historike ku njerëzit në përgjithësi do të kuptojnë realitetin hyjnor dhe do të drejtohet me turma tek Allahu, Qenia e vetme Absolute. Besimet materialiste të shek. 19-të do të vendosen në grumbujt e mbeturinave të historisë, ekzistenca e Allahut dhe krijimtaria e Tij do të kapet nga mendja, do të kuptohet mosekzistimi i hapësirës dhe kohës, njerëzimi do të çlirohet nga velloja e vjetër shekullore e mashtrimeve dhe paragjykimeve që i kishte hutuar.

Nuk është e mundur që këtë rrjedhë të pandalshme ta pengojë ndonjë qenie nga hija.

RELATIVITETI I KOHËS DHE REALITIVITETI I FATIT



do gjë që është përmendur më lart demonstroi se “hapësira tredimensionale” nuk ekziston në realitet, që është paragjykim i bazuar krejtësisht në perceptime dhe që njeriu tërë jetën e jeton në këtë “mosekzistim të hapësirës”. Që të pohohet e kundërta duhet që të mbajmë besimet paragjyquese larg nga arsyeja dhe e vërteta shkencore, pasi nuk ka dëshmi vlefshëm për ekzistimin e botës materiale tredimensionale.

Kjo përgënjeshtroi supozimin kryesor të filozofisë materialiste që nënvizon teorinë e evolucionit, supozimin se materia është absolute dhe e përjetshme. Supozimi i dytë në të cilin qëndron filozofia materialiste është se koha është absolute dhe e përhershme. Edhe ky është aq paragjyques sa i pari.

Perceptimi i kohës

Atë që e perceptojmë si kohë, në të vërtetë, është metoda me të cilën një moment krahasohet me tjetrin. Mund ta shpjegojmë këtë me një shembull. Për shembull, kur një njeri troket në një objekt, ai e dëgjon një zë të caktuar. Kur të troket objektin e njëjtë pas pesë minutash, ai dëgjon edhe një zë. Personi percepton se ka qenë një interval në mes të zërit të parë dhe të dytë që ai e quan interval “i kohës”. Sidoqoftë kur ai dëgjon zërin e dytë, zëri i parë nuk është më shumë se imagjinatë në mendjen e tij. Është vetëm një pjesë e informatës në kujtesën e tij. Personi formulon konceptin e “kohës” duke krahasuar momentin në të cilin jeton me atë

çfarë ka në kujtesën e vet. Nëse nuk bëhet ky krahasim, nuk do të ekzistonte koncepti i kohës.

Në të njëjtën mënyrë, personi bën krahasimin kur e sheh dikë duke hyrë në dhomë përmes derës dhe duke u ulur në kolltuk në mes të dhomës. Në kohën kur ky person ulet në kolltuk, imazhet që kanë të bëjnë me momentin kur ai hap derën, hyn në dhomë, dhe ulja e tij në kolltuk janë të përpiluar si pjesë të informatës në tru. Perceptimi i kohës ndodh kur dikush krahason njeriun e ulur në kolltuk me ato pjesë të informatës.

Shkurtimisht, koha ekziston si rezultat i krahasimit të bërë në mes të disa iluzioneve të ruajtura në tru. Nëse njeriu nuk do të kishte kujtesë, atëherë edhe truri nuk do të bënte interpretime të tilla e prandaj kurrë nuk do të mund të formohej koncepti i kohës. E vetmja arsye që dikush përcakton vetveten se i ka 30 vjet është për shkak se ai ka akumuluar informata që i përkasin atyre 30 vjetëve në mendjen e tij. Nëse kujtesa e tij nuk do të ekzistonte, atëherë edhe ai nuk do të mund të mendonte për ekzistimin e periudhës së kaluar dhe ai do të përjetonte vetëm “çastin” në të cilin jeton.

Shpjegimi shkencor i mosekzistimit të kohës

Le të mundohemi që të sqarojmë temën duke cituar shpjegimet e shkencëtarëve dhe dijetarëve të ndryshëm në lidhje me këtë temë. Sa i përket çështjes së rrjedhjes së kohës prapa, profesori i famshëm i gjenetikës dhe fituesi i çmimit Nobel, François Jacob, thotë në librin e tij *Le Jeu des Possibles* (E mundshmja dhe aktualja):

*Filmat e lëshuar prapazi na e bëjnë të mundur që të imagjinojmë **botën në të cilën koha shkon së prapthi**. Botën ku qumështi ndahet nga kaffja dhe kërcen nga filxhani dhe kthehet prapë në enën e qumështit; botën në të cilën rrezet e dritës lëshohen nga muri që grumbullohen në një vend (qendër graviteti) në vend se të shpërthejnë nga burimi i dritës; botën në të cilën guri kthehet nga uji në shuplakën e njeriut në bashkëpunim të çuditshëm me pikat e panumërta të ujit. Prandaj, në botën e tillë ku koha ka veçori të kundërta, **proceset në trurin tonë dhe mënyra se si kujtesa jonë e përpilon informatën, do të mund***

të funksiononin së prapështi. E njëjta vlen edhe për të kaluarën dhe të ardhmen dhe bota do të dukej njëjtë siç duket tani.²⁷

Pasi truri ynë është i mësuar me një renditje të caktuar të ngjarjeve, bota nuk funksionon siç është treguar më lartë dhe neve na duket se koha çdoherë ecën përpara. Por, ky është vendim i arritur në tru dhe është relativ. Në realitet, kurrë nuk do të mund të dimë se si ecën koha dhe a është duke ecur apo jo. Kjo tregon faktin se **koha nuk është fakt absolut por vetëm një lloj perceptimi.**

Relativiteti i kohës është fakt që është vërtetuar edhe nga njëri ndër fizikanët më të rëndësishëm të shek. 20-të, Albert Einsteinit. Lincoln Barnett, shkruan në librin e tij *Gjithësia dhe dr.Einsteini*:

Së bashku me hapësirën absolute, Einsteini hodhi poshtë konceptin e kohës absolute – ku rrjedhja e kohës universale është e njëtrajtshme, e pandryshueshme dhe e vazhdueshme, duke rrjedh nga e kaluara e pafund në të ardhmen e pafund. Shumë paqartësi që e kanë rrethuar teorinë e relativitetit dalin nga ngurrimi i njeriut që të pranoj se domethënia e kohës, sikurse domethënia i ngjyrës, është një formë e perceptimit. Sikurse hapësira që është radhitje e mundshme e objekteve materiale, ashtu edhe koha është një radhitje e mundshme e ngjarjeve. Subjektiviteti i kohës më së miri është shpjeguar nga Einsteini. “Përjetimet e një personi”, thotë ai, “na shfaqet si seri e rregulluar e ngjarjeve; në këtë seri ngjarjet e vetme që ne i mbajmë në mend radhiten asisoj sipas kriterit të konceptit “më herët apo “më vonë”. Prandaj ekziston, për një person një kohë – personale, apo kohë subjektive. Kjo në vetvete nuk është e matshme. Mundem, në të vërtetë, që të lidh numrat me ngjarjet, ashtu që numri më i madh i përket ngjarjes më të vonshme sesa me të parën.”²⁸

Vet Einsteini theksoi, siç citohet në librin e Barnettit se: “hapësira dhe koha janë formë e intuitës, që nuk mund më të ndahen nga vetëdija sikurse konceptet tona të dallimit të ngjyrës, formës dhe madhësisë.” Sipas teorisë së përgjithshme të relativitetit: “koha nuk ka ekzistencë të pavarur nga radhitja e ngjarjeve me të cilën i masim.”²⁹

Pasi që koha përbëhet nga perceptimet, krejtësisht varet nga perceptuesi dhe për këtë arsye është relative.

Shpejtësia me të cilën koha kalon ndryshon sipas referencave që ne e masim pasi nuk ka orë natyrale në trupin e njeriut që të tregojë në mënyrë precize se sa shpejt kalon koha. Siç shkruan Lincoln Barnett: “Sikurse që nuk ka gjë me ngjyrë që mund të dallohet pa sy, gjithashtu një çast, orë apo ditë nuk mund të shënohet pa ngjarje.”³⁰

Relativiteti i kohës më së thjeshti përjetohet në ëndrra. Edhe pse atë që shohim në ëndërr duket se ndodhë me orë të tëra, në të vërtetë, kjo ndodhë për vetëm disa minuta, e bile edhe disa sekonda.

Të shqyrtojmë një shembull ashtu që të sqarojmë çështjen më tutje. Të paramendojmë se jemi në një dhomë me vetëm një dritare që është e punuar në mënyrë të veçantë dhe do të jemi të ngujuar për një kohë të caktuar. Le të jetë një orë në dhomë për të matur kohën e kaluar. Në të njëjtën kohë, le të jetë që mund të shohim nga dritarja e dhomës lindjen e diellit dhe perëndimin në intervale të caktuara. Pas disa ditësh, përgjigja që ne mund të japim për pyetjen se sa kohë kemi kaluar në dhomë do të jetë në bazë të informatave që kemi mbledhur duke shikuar orën kohë pas kohe dhe llogaritjen që kemi bërë duke iu referuar faktit se sa herë ka lindë dhe perënduar dielli. Për shembull, ne vlerësojmë se kemi kaluar tri ditë në atë dhomë. Por, nëse personi që na ka vendosur në atë dhomë të thoshte se ne kemi qëndruar vetëm dy ditë në dhomë dhe se dielli që ne e kemi parë nga dritarja është prodhuar artificialisht nga një makinë simuluese si dhe ora në dhomë është punuar që të punojë më shpejt se zakonisht, atëherë llogaritjet tona nuk do të kenë kurrfarë kuptimi.

Ky shembull konfirmon se informata që ne kemi për shpejtësinë e kalimit të kohës bazohet në referencat relative. Relativiteti i kohës është fakt shkencor i dëshmuar nga metodologjia shkencore. Teoria e përgjithshme e relativitetit të Einsteinit pohon se shpejtësia e kohës ndërron varësisht nga shpejtësia e objektit dhe pozitës së tij në fushën e gravitacionit. Me rritjen e shpejtësisë, koha shkurtohet dhe ngjeshët; ajo ngadalësohet deri sa të vjen tek pika e “ndaljes”.

Të shpjegojmë këtë me një shembull të dhënë nga Einstein. Paramendojmë dy binjak, njëri mbetet në tokë derisa tjetri udhëton në gjithësi me një shpejtësi afër shpejtësisë së dritës. Kur kthehet në tokë, ai që ka udhëtuar do të shoh se vëllai i tij që ka qëndruar në tokë është

plakur shumë më shumë se ai. Arsyeja është se koha rrjedh shumë më ngadalë për personin që udhëton me shpejtësi të afërt me atë të dritës. Le të marrim me mend një babë udhëtues nëpër gjithësi dhe djalin e tij në tokë. Nëse babai ishte 27 vjeç kur është nisur ndërsa djali i tij tre vjeçar; kur babai të kthehet në tokë pas 30 viteve (tokësore), djali do të jetë 33 vjeçar ndërsa babai i tij do të jetë vetëm 30 vjeçar.³¹ Ky relativitet i kohës nuk shkaktohet nga ngadalësimi apo përshpejtimi i orës, apo ngadalësimi i pranverës mekanike. Më parë është rezultat i dallimit të periudhave të punës të tërë sistemit të ekzistencës materiale, që shkon thellë deri në grimcat sub-atomike. Me fjalë tjera, për personin që e përjeton këtë, shkurtimi i kohës nuk përjetohet si film i ngadalësuar. Në ato raste kur shkurohet koha, të rrahurat e zemrës, shumimi i qelizave dhe funksioni i trurit etj., të gjitha punojnë më ngadalë se tek personi në tokë. Pa marrë parasysh, personi vazhdon me jetën e tij të përditshme dhe fare nuk e vëren shkurtimin e kohës. Në të vërtetë shkurtimi nuk është i dukshëm derisa nuk bëhet krahasimi.

Relativiteti në Kur'an

Përfundimi që arritëm me ndihmën e zbulimeve shkencore thotë se koha nuk është absolute siç supozonin materialistët, por një perceptim relativ. Ajo që është më interesante është se ky fakt që ka mbetur pa u zbuluar deri në shek. 20-të nga shkenca, është zbuluar në Kur'an para 14 shekujsh. Ka referime të ndryshme në Kur'an për relativitetin e kohës.

Është e mundur të shihet në shumë ajete të Kur'anit fakti i dëshmuar shkencërisht se koha është perceptim psikologjik që varet nga ngjarjet, mjedisi dhe kushtet. Për shembull, tërë jeta e një njeriu është kohë shumë e shkurtë siç informohemi në Kur'an:

Atë ditë kur Ai ju thërret, kurse ju i përgjigjeni të përlulur e duke lavdëruar Atë, e ju duket se nuk qëndruat (në dynja) vetëm pak kohë. (Isra: 52)

(Përkujto) Ditën kur i tubojnë ata, (atyre u duket) sikur nuk qëndruan (në dynja) vetëm një moment të ditës, atëherë njihen mes vete. (Junus: 45)

Disa ajete tregojnë se njerëzit perceptojnë kohën në mënyra të ndryshme dhe se ndonjëherë mund perceptojnë një periudhë të shkurtë

kohore si shumë të gjatë. Biseda vijuese e njerëzve gjatë gjykimit në Ahiret është shembull i mirë për këtë:

Ai thotë: “E sa vjet keni kaluar në tokë?” Ata thonë: “Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës, pyeti ata që dinë numërimin!” Ai thotë: “Mirë e keni, sikur ta dishit njëmend pak keni qëndruar!” (Mu’minun: 112-114)

Në ajetet tjera Allahu thotë se koha mund të rrjedhë në shpejtësi të ndryshme në mjedise të ndryshme:

Ata kërkojnë prej teje t’ua ngutësh dënimin, po All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti yt, është sa njëmijë vjet, si llogaritni ju. (Haxhixh: 47)

Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) në një ditë që zgjatë pesëdhjetë mijë vjet (ose lartësia e atyre shkallëve është pesëdhjetë mijë vjet). (Me’arixh: 4)

Ai është që udhëheq çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë, pastaj ajo (çështja) ngritët te Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa njëmijë vjet. (Sexhde: 5)

Këto ajete shprehje të qarta për relativitetin e kohës. Që ky rezultat, e që është kuptuar së voni nga shkencëtarët e shek. 20-të, i është komunikuar njerëzimit para 1.400 vjetëve në Kur’an, është tregues i shpalljes së Kur’anit nga Allahut, i Cili rrethon tërë kohën dhe hapësirën.

Shumë ajete tjera në Kur’an zbulojnë se koha është perceptim. Kjo është posaçërisht evidente në tregime. Për shembull, Allahu ka mbajtur shokët e shpellës, një grup të besimtarëve që përmendet në Kur’an, në gjumë të thellë për tre shekuj. Kur janë zgjuar, kanë menduar se kanë qëndruar në atë gjendje për pak kohë, dhe nuk kanë mundur që të supozojnë sa gjatë kanë fjetur:

Ne u vumë mbulojë mbi veshët e tyre (i vumë në gjumë) në shpellë për disa vite me radhë. Pastaj ata i zgjuam (prej gjumit) për të parë se cili prej tyre dy grupeve është më preciz në njehsimin e kohës sa qëndruan gjatë. (Kehf: 11-12)

Ashtu (sikurse i vumë në gjumë) i zgjuam ata që të pyesin njëri-tjetrin (se sa kanë fjetur). Njëri prej tyre foli e tha: “Sa keni ndejur?” Ata thanë:”Kemi ndejur një ditë ose një pjesë të ditës!” Disa thanë: “Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndejur, prandaj dërgoni njërin prej jush

me këtë argjend (monedhë argjendi) në qytet, e të zgjedhë ushqim më të mirë, e t'ju sjellë atë juve dhe le të ketë shumë kujdes e të mos i japë të kuptojë askujt për ju". (Kehf: 19)

Gjendja e treguar në ajetin e mëposhtëm është gjithashtu dëshmi se koha në të vërtetë është perceptim psikologjik.

Ose (nuk je i njohur) me shembullin e atij që kaloi pranë një fshati që ishte rrënuar në kulmet e tij, e tha: "Si e ngjallë All-llahu këtë pas shkatërrimit të tij?" e All-llahu e bëri të vdekur atë (pyetësin - Uzejrën) njëqind vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: "Sa qëndrove (i vdekur)?" Ai tha: "Një ditë, ose një pjesë të ditës!" Ai (All-llahu) Tha: "Jo, por ke ndejur (i vdekur) njëqind vjet, shikoje ushqimin dhe pijen tënde si nuk është prishur, e shikoje edhe gomarin tënd (si i janë shkapërderdhur eshtrat). E për të bërë ty argument për njerëzit (bëmë këtë sprovë), shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish. E kur iu bë e qartë atij tha: "U binda se me të vërtetë All-llahu ka mundësi për çdo send!" (Bekare: 259)

Ky ajet qartë thekson se Allahu i Cili ka krijuar kohën është i pavarur nga ajo. Njeriu, nga ana tjetër, është i varur nga koha, që është paracaktuar nga Allahu. Siç theksohet në ajet, njeriu nuk ka aftësi të dijë as sa gjatë ka fjetur. Në këtë gjendje, të pohohet se koha është absolute (sikurse materialistët e bëjnë, në mendimin e tyre të shtrembëruar) është shumë e paarsyeshme.

Fati

Relativiteti i kohës sqaron një çështje shumë të rëndësishme. Relativiteti është aq i ndryshueshëm që koha prej miliarda vjetësh mund të zgjasë vetëm një sekondë nga një perspektivë tjetër. Përveç kësaj, koha e pamasë që shtrihet prej fillimit të kësaj bote deri në fund të saj ndoshta nuk është zgjatë bile as një sekondë por vetëm një çast në dimensionin tjetër.

Kjo është esenca e konceptit të fatit – një koncept që nuk kuptohet mirë nga shumica e njerëzve, posaçërisht materialistëve që e mohojnë plotësisht. Fati është dituri e përsosur e Allahut për të gjitha ngjarjet në të kaluarën dhe të ardhmen. Shumica e njerëzve pyesin se si Allahu mund të dijë paraprakisht ngjarjet që ende nuk kanë ndodhur dhe kjo dërgon në

mosnjohje e vërtetësisë së fatit. Sidoqoftë, “ngjarjet që ende nuk janë përjetuar” janë vetëm për ne. Allahu nuk është i varur nga koha dhe hapësira pasi që Ai i ka krijuar ato. Për këtë shkak, e kaluara, e ardhmja dhe e tashmja janë të njëjta për Allahun; për Të çdo gjë ka ndodhë dhe ka përfunduar.

Në librin *Gjithësia dhe Dr. Einsteini*, Lincol Barnett shpjegon se si Teoria e përgjithshme e relativitetit dërgon deri në këtë përfundim. Sipas Barnettit, gjithësia mund të jetë “e rrethuar me tërë madhësinë e tij vetëm nga një mendje kozmike”.³² Vullnetin që Barnetti e quan “mendje kozmike” është mençuria dhe dijenia e Allahut, i Cili sundon tërë gjithësinë. Siç mund të shohim lehtë fillimin, mesin dhe fundin e zotëruesit dhe të gjitha pjesët në mes si një tërësi, Allahu e di se koha të cilës i jemi nënshtruar është sa vetëm një çast prej fillimit të saj e deri në fund. Njerëzit, sidoqoftë, përjetojnë incidentet vetëm kur t’i vie koha dhe shohin se fati është krijuar për ta nga Allahu.

Është e rëndësishme gjithashtu që t’i përkushtohet vëmendje cekëtinës së kuptimit të shtrembëruar të fatit që dominon në shoqërinë tonë. Ky besim i shtrembëruar i fatit është paragjykim se Allahu ka përcaktuar “fatin” për çdo njeri por disa fate ndonjëherë mund të ndryshohen nga njerëzit. Për shembull njerëzit bëjnë deklaratat sipërfaqësore për pacientin i cili është kthyer nga dyert e vdekjes si “ai mposhti fatin e tij”. Askush nuk ka mundësi të ndryshojë fatin e tij. Personi që është kthyer nga dyert e vdekjes, nuk ka vdekur pasi nuk është shkruar që të vdesë në atë kohë. Është, në mënyrë ironike, fati i atyre njerëzve që e mashtrojnë veten duke thënë “e kam mposhtur fatin tim” se duhet të thonë ashtu dhe e mbajnë atë mënyrë të shikimit të gjërave.

Fati është dituri e përjetshme e Allahut dhe për Allahun, i Cili e njeh kohën sikurse një çast të vetëm dhe i Cili sundon tërë kohën dhe hapësirën; çdo gjë është paracaktuar dhe përfunduar në fat. Ne gjithashtu kuptojmë nga çfarë Ai tregon në Kur’an se koha është një për Allahun: disa incidente që për ne do të duhej të ndodhin në të ardhmen tregohet në Kur’an në atë mënyrë sa që duket se kanë ndodhur shumë kohë më përpara. Për shembull, ajetet që shpjegojnë llogarinë që njerëzit duhet ta japin para Allahut në ahiret tregohet me ngjarjet që kanë ndodhur shumë përpara:

Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur çka ka në qiej dhe në tokë, përveç atyre që do All-llahu (të mos vdesin), pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur qe, të gjithë ata të ngritur e presin (urdhrin e Zotit). Toka është ndriçuar me dritën e Zotit të vet, libri (shënimet mbi veprat) është vënë pranë dhe sillen peygamberet e dëshmitarët, e kryhet mes tyre gjykimi me drejtësi, e atyre nuk u bëhet padrejtë... e jobesimtarët sillen në Xhehennem në grupe... E ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, sillen në grupe te Xhenneti. (Zumer: 68-73)

Disa ajete tjera në lidhje me këtë çështje janë:

E do të vijë secili njeri bashkë me të dhe grahësi edhe dëshmitari. (Kaf: 21)

E qielli çahet, pse ai atë ditë është i rraskapitur. (Hakka: 16)

Dhe për shkak se ata duran, i shpërbleu me Xhennet dhe me petka mëndafshi. Aty janë të mbështetur në kolltukë dhe aty nuk shohin as diell (vapë) e as të ftohtë. (Insan: 12-13)

E Xhehennemi shfaqet sheshazi për atë që e sheh. (Nazi'at: 36)

E sot, (në ditën e gjykimit), ata që besuan do të tallen me jobesimtarët. (Mutaffifin: 34)

Kriminelët e shohin zjarri dhe binden se do të hedhen në të, dhe se nuk do të gjejnë shtegdalje prej tij. (Kehf: 53)

Siç mund të shihet, ngjarjet që do të ndodhin pas vdekjes sonë (nga pikëvështrimi ynë) tregohen në Kur'an si ngjarje të kaluara që tashmë kanë ndodhë. Allahu nuk është i varur nga korniza relative e kohës në të cilin ne jemi të kufizuar. Allahu ka pasur dëshirë që këto gjëra të jenë në atë mosekzistim të kohës; njerëzit tashmë i kanë kryer dhe të gjitha këto ngjarje e që kanë përfunduar. Ai thotë në ajetin e mëposhtëm se çdo ngjarje e vogël apo e madhe, është brenda diturisë së Allahut dhe e shënuar në libër:

Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur'ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se Ne jemi prezentuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt. (Junus: 61)

Brenga e materialistëve

Çështjet e debatuar në këtë kapitull, dmth e vërteta mbi materien, mosekzistimi i kohës dhe hapësirës janë krejtësisht të qarta. Siç u shprehëm më parë, këto padyshim nuk janë lloj filozofisë apo mënyrë e të menduarit, por janë të rezultate shkencore që është e pamundur të mohohen. Përveç që është një realitet teknik, dëshmia gjithashtu nuk lejon alternativë tjetër logjike mbi këtë çështje: gjithësia është një entitet iluziv me tërë materien që e përbën atë dhe krijesat që jetojnë në të. Është një përmbledhje perceptimesh.

Materialistët nuk mund ta kuptojnë këtë çështje. Për shembull, nëse kthehemi tek shembulli i autobusit të Politzerit: edhe pse Politzeri teknikisht e ka ditur që nuk mund të dalë jashtë perceptimeve të tij ai mundet vetëm që të pranoj këtë në raste të caktuara. Pra, për Politzerin, ngjarjet ndodhin në tru derisa të bëhet goditja e autobusit, por posa goditja e autobusit ndodhë, gjërat dalin nga truri dhe fitojnë realitet fizik. Defekti logjik i kësaj çështjeje është shumë i qartë. Politzer ka bërë të njëjtin gabim sikurse materialisti Johnson i cili tha, “ Godita gurin, këmba më dhemb, prandaj ekzistoj”. Politzeri nuk e kuptoi se edhe goditja që e ka ndier pas goditjes së autobusit ishte vetëm një perceptim.

Arsyeja e vetëdijes që materialistët nuk mund ta kuptojnë këtë çështje është frika e tyre që ata do të ballafaqohen kur ta kuptojnë. Lincoln Barnett n'a tregon se disa shkencëtarë “dallojnë” këtë çështje:

*Së bashku me reduktimin e filozofëve për tërë realitetin objektiv deri tek bota e shëmbëlltyrave të perceptimeve, shkencëtarët janë bërë të vetëdijshëm për kufizimet **alarmante** të shqisave njerëzore.³³*

Çdo referencë e bërë nga fakti se materia dhe koha janë perceptime ndjell frikë të madhe tek materialisti, pasi këto janë të vetmet pikëpamje që ai i konsideron si qenie absolute. Ai, në një formë, i merr ato si idhuj për t'i adhruar, pasi mendon se materia dhe koha (përmes evolucionit) e ka krijuar atë.

Kur kupton se gjithësia në të cilën ai mendon se është duke jetuar, bota, trupi i tij, njerëzit tjerë, materialistët tjerë me të idetë e të cilëve është influencuar, dhe, shkurtimisht, çdo gjë është perceptim, ai ndjehet si i shastisur nga frika e të gjithë kësaj. Çdo gjë që ai varet,

beson dhe ka burim papritmas zhduket. Ai ndjen shijen e një dëshpërimi që ai me të vërtetë do ta përjetojë në Ditën e Gjykimit, siç shpjegohet në ajetin “Dhe ata (idhujtarët) i dorëzohen All-llahut, e atë çka ata e trillonin u asgjësohet.” (Nahl: 87)

Pastaj, materialisti mundohet të bind veten në realitetin e materies, dhe trillon “dëshminë” për këtë fund. Ai së pari godet murin me grusht, shqelmon gurët, bërtet, ulurin, por kurrë nuk mund të largohet nga realiteti.

Ashtu siç mundohen ta largojnë realitetin nga mendja e tyre, ata dëshirojnë që edhe njerëzit gjithashtu të heqin dorë. Ata gjithashtu janë të vetëdijsëm se nëse njerëzit në përgjithësi do të mësojnë për natyrën e vërtetë të materies, natyra primitive e filozofisë së tyre dhe injoranca e botëkuptimit do të zbulohet nga të gjithë në shesh, dhe nuk do të ketë më vend ku ata do të mund t'i gjejnë pikëpamjet e tyre. Kjo frikë është arsyeja pse ata janë aq të shqetësuar nga faktet e paraqitura këtu.

Allahu thotë se frika e jobesimtarëve do të intensifikohet në jetën e pastajme. Në Ditën e Gjykimit ata do të drejtohen kështu:

Përkujto ditën kur Ne i tubojmë të gjithë dhe u themi atyre që i shoqëruan: “Ku janë ata të shoqëruarit tuaj, që i trillonit?” (En’am: 22) Pas kësaj, jobesimtarët do të shohin pasurinë e vet, fëmijët dhe të afërmit, që mendonin se janë të vërtetë dhe i kanë përshkruar shok Allahut, se si do t’i braktisin dhe do të zhduken. Allahu na informon për këtë në ajetin: “Shih, se si bëjnë gënjeshtër kundër vetes dhe si u shkoi huq ajo që trillonin!” (En’am: 24)

Dobia e besimtarëve

Derisa fakti se materia dhe koha janë vetëm perceptime i alarmon materialistët, e kundërta është për besimtarët. Besimtarëve u erdhi mirë kur morën vesh për fshehtësinë pas materies, pasi kjo çështje është çelës i të gjitha përgjigjeve. Me këtë çelës, të gjitha fshehtësitë zbulohen. Dikush do të kuptojë më lehtë shumë çështje se sa më përpara.

Siç u tha më parë, çështjet e vdekjes, xhennetit, xhehennemit, ahireti, ndërrimi i dimensioneve dhe pyetjes si “ku është Allahu?”, “çka kishte para Allahut?”, “kush e krijoi Allahun” “Sa do të zgjasë jeta në varr?”, “ku është xhenneti dhe xhehennemi?” dhe “ku janë tani xhenneti dhe xhehennemi?”

përgjigjen më lehtë. Do të kuptohet se me çfarë rendi Allahu krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, kaq shumë vetëm se, me këtë fshehtësi, pyetjet si “kur?” dhe “ku?” bëhen të pakuptimta pasi që atje nuk ka as kohë e as hapësirë. Kur mosekzistimi i hapësirës të kuptohet, do të kuptohet se xhennemi, xhenneti dhe toka në të vërtetë gjenden në të njëjtin vend. Nëse mosekzistimi i kohës kuptohet, do të kuptohet se çdo gjë zë vend në një çast të vetëm: asgjë nuk pret për kohë dhe koha nuk ecën, për shkak se çdo gjë veçse ka ndodhur dhe ka përfunduar.

Me këtë fshehtësi të gërmuar, bota për besimtarin bëhet sikurse xhennet. Të gjitha brengat e dhembshme materiale, shqetësimet dhe frika humben. Personi e kupton se e tërë gjithësia ka një Sundues të vetëm, që Ai ndërron tërë botën fizike ashtu siç Ai dëshiron dhe krejt se çfarë duhet bërë është të mbështeturit në Të. Ai pastaj i nënshtrohet krejtësisht Allahut “...vendosa ta kushtoj thjesht vetëm për shërbimin Tënd...” (Ali Imran: 35).

Të kuptuarit e kësaj fshehtësie është dobia më e madhe në këtë botë.

Me këtë fshehtësi, një realitet tjetër i përmendur në Kur'an zbulohet: se **“Allahu është më afër tij se damari (që rrah) i qafës së tij.”** (Kaf: 16). Siç të gjithë e dimë, damari i qafës është brenda në trup. Çfarë mund të jetë më afër ndokujt sesa që është ai vetë brenda trupit të tij? Kjo situatë mund të shpjegohet lehtë me realitetin e mosekzistimit të hapësirës. Ky ajet do të mund të kuptohej edhe më mirë me të kuptuarit e kësaj fshehtësie.

Kjo është e vërteta e qartë. Nga këtu do të mund të vërehet se nuk ka ndihmëtar dhe furnizues më të madh për njeriun sesa Allahu. Nuk ka asgjë tjetër përpos Allahut; Ai është qenie absolute tek te i Cili njeriu mund të kërkojë strehim, tek të i Cili mund të thërras për ndihmë dhe të llogarisë në shpërblim.

Kahdo që të kthehem, është prania e Allahut.



MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshtat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darvinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej

punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysht rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:



Charles Darwin

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli

përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themelin e teorisë së Darwinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”³⁴

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkencë, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.³⁵

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohej se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.³⁶

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.³⁷


Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të

njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?*³⁸

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.



Molekula e quajtur ADN, përmban planin e ndërtimit komplet të trupit të njeriut.

kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njërin pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.³⁹

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.*⁴⁰

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin.

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.⁴¹

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencë e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i

prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.⁴²

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera,



Pjesët më të rëndësishme të dëshmisë së evolucionit u dëshmuar si të pasakta. Fossil i vjetër prej 410 milion vjetësh i peshkut Koelakant(poshtë). Evolucionistët pohojn se ishte një formë kaluese që dëshmon kalimin e këtij peshku nga uji në tokë. Fakti se më shumë se 40 mostra të këtij peshku janë zënë në 50 vjetët e fundit tregon se ky është një pesh i zakonshëm dhe që ende jeton. Fosili i vjetër prej 135 milion vjetësh i Archaeptoryxit, kinse paraardhës i zogjve, që thuhet se ka evoluuar nga dinosaurët (majtas). Studimet në fosile treguan të kundërtën, se ai në të vërtetë është një zog të zhdukur më parë që ka fluturuar njëherë por më vonë e ka humbur atë aftësi.



ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.



Fosil i vjetër i kacabunit prej 320 milion vjetësh (majtas).

Fosil i vjetër i trifaqëshit prej 360 milion vjetësh (poshtë).



Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

*Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.*⁴³

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.⁴⁴


Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucion, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.⁴⁵

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucion, por krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:



Vazhdimisht duke vizatuar krijesa gjysëm-njeri gjysëm majmun në librat e tyre apo publikime tjera, opinioni ka fituar bindje se njeriu ka evoluar nga majmuni apo nga ndonjë krijesë e ngjajshme. Sidoqoftë, këto vizatime janë falsifikate të qindpërqindta.

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman



Vizatimi i mëlartë është i vizatuar duke u bazuar në veëm një dhëmb dhe është i publikuar në revistën Illustrated London News më 24 korrik 1922. Sido që të jetë, evolucionistët ishin shumë të zhgënjyer kur ishte zbuluar se ky dhëmb nuk i përkiste as ndonjë krijese të ngajshme me majmunin e as njeriut, por të një lloji të zhdukur të derrit.

dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.⁴⁶

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: *“në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”*⁴⁷

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë

paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Australopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.⁴⁸

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiensi, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.⁴⁹

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrkakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhënj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.⁵⁰

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkencat e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.⁵¹

Siç shihet, evolucionin njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me

çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t'i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjeptra, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes “Si shohim ne?” Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet “qendra e shikimit”. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një

sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësi të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësi të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësi të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike.

Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më

të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si “sulm ndaj shkencës”. Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i

famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.⁵²

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstrukttoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A’raf: 179)

Edhe sikur Ne t’u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t’i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se

një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, “magjia” është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhdukoi magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia priset. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohet me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.⁵³

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

***Engjujt thanë: “Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshtëm e i Urtë.”
(Sure Bekare: 32)***

SHËNIMET

- 1-A. Maton, J. Hopkins, S. Johnson, D. LaHart, M.Quon Warner, J.D. Wright, *Human Biology and Health*, Prentice Hall, New Jersey, f. 59
2. J.A.C. Brown, *Medical and Health Encyclopaedia*, Remzi Publishing, Istanbul, f.250
- 3-H.J. de Blij, M.H. Glantz, S.L. Harris, "Restless Earth (Toka e shqetësuar)", *The National Geographic Society*, 1997, f.8
- 4- H.J. de Blij, M.H. Glantz, S.L. Harris, "Restless Earth (Toka e shqetësuar)", *The National Geographic Society*, 1997, f.8
- 5-H.J. de Blij, M.H. Glantz, S.L. Harris, "Restless Earth (Toka e shqetësuar)", *The National Geographic Society*, 1997, f.64
- 6-H.J. de Blij, M.H. Glantz, S.L. Harris, "Restless Earth (Toka e shqetësuar)", *The National Geographic Society*, 1997, f.18-19
- 7-Mesopotamia dhe Lindja e Afërme e Lashtë, *Enciklopedia e Civilizimeve të Mëdha*, Iletisim Publications, p.92
- 8-Ana Britannica, Vëllimi 20, f.592
- 9-H.J. de Blij, M.H. Glantz, S.L. Harris, *Restless Earth*, *The National Geographic Society*, 1997, f.18-19
- 10-Frederick Vester, *Denken, Lernen, Vergessen*, vga, 1978, f.6
- 11-George Politzer, *Principes Fondamentaux de Philosophie*, Editions Sociales, Paris 1954, pp.38-39-44
- 12-R.L.Gregory, *Syri dhe Truri: Psikologjia e të parit*, Oxford University Press Inc. New York, 1990, f.9
- 13-Lincoln Barnett, *The Universe and Dr.Einstein*, William Sloane Associate, New York, 1948, f.20
- 14-Orhan Hancerlioglu, *Dusunce Tarihi* (Historia e të të menduarit), Istanbul: Remzi Bookstore, bot.6, shtator 1995 , f . 447
- 15-V.I. Lenin, *Materializmi dhe Empiriokriticizmi*, Progress Publishers, Moskë, 1970, f. 14.
- 16-Bertrand Russell, *Abetarja e Relativitetit*, George Allen and Unwin, London, 1964, f. 161-162
- 17-R.L.Gregory, *Eye and Brain: The Psychology of Seeing*, Oxford University Press Inc. New York, 1990, f.9
- 18-Karl Pribram, David Bohm, Marilyn Ferguson, Fritjof Capra, *Holografik Evren 1(Holographic Universe 1)*, translated by Ali Cakiroglu, Kuraldisi Publishing, Istanbul: 1996, f. 37
- 19-George Politzer, *Principes Fondamentaux de Philosophie*, Editions Sociales, Paris 1954, pp.65
- 20-Orhan Hancerlioglu, *Dusunce Tarihi (The History of Thought)*, Istanbul: Remzi Bookstore, 6.ed., 1995 September, p. 261
- 21-George Politzer, *Principes Fondamentaux de Philosophie*, Editions Sociales, Paris 1954, pp.65
- 22- Paul Davies, *Zoti dhe fizika e re*, (God and the New Physics), f. 180-181.
- 23-Rennan Pekunlu, "Aldatmacanin Evrimsizligi", (Gjunjëzimi i joevolucionit), *Bilim ve Utopya*, dhjetor 1998, (V.I. Lenin, *Materializmi dhe Empiriokriticizmi*, Progress Publishers, Moskë, 1970, f.334-335)
- 24-Alaettin Senel, "Evrin Aldatmacasi mi? Devrin Aldatmacasi mi?", (Gjunjëzimi i joevolucionit), *Bilim ve Utopya*, dhjetor 1998
- 25-Mektubat-İ Rabbani (Letrat e Rabbanit), Vëll. II, letra e 357-të, f. 163.

- 26- Mektubat-I Rabbani (Letrat e Rabbanit), Vëll. II, letra e 357-të, f. 1432.
- 27-François Jacob, *Le Jeu des Possibles*, University of Washington Press, 1982, p. 111.
- 28-Lincoln Barnett, *The Universe and Dr. Einstein*, William Sloane Associate, New York, 1948, pp. 39-40.
- 29-Lincoln Barnett, *The Universe and Dr. Einstein*, p. 12.
- 30-Lincoln Barnett, *The Universe and Dr. Einstein*, p. 40.
- 31-Paul Strathern, *The Big Idea: Einstein and Relativity*, Arrow Books, 1997, p. 57.
- 32-Lincoln Barnett, *Gjithësia dhe Dr. Einstein*, f. 67.
- 33-Lincoln Barnett, *Gjithësia dhe dr. Einstaini*, fq.12
- 34-Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, E.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
- 35- Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, NeëYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
- 36- "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
- 37- Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
- 38- Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
- 39- Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
- 40- Charles Darëin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, Neë York, p. 127.
- 41- Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
- 42- B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
- 43- Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
- 44- Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
- 45- Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, Neë York, 1983, p. 197.
- 46- Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
- 47- "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
- 48- Alan Ëalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Antropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
- 49- Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Ëith Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
- 50- S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
- 51- Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, p. 19.
- 52- Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Ëorld," *The Neë York Revieë of Books*, January 9, 1997, p. 28.
- 53-Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43.